



Udhëzues për gratë

mbi

REFORMËN NË SEKTORIN E SIGURISË

Megan Bastick dhe Tobie Whitman

Përkthimi dhe botimi në gjuhën shqipe i këtij Udhëzuesi u ndërmorr nga Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) në kuadër të Programit të Bashkëpunimit 2012-2016 ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara të mbështetur financiarisht nga Qeveria Suedeze.

Përktheu në gjuhën shqipe: **Evis Cerga Gjikondi**

Redaktoi në gjuhën shqipe: **Majlinda Nishku**

Botimi: **PEGI sh.p.k**

Opinionet dhe këndvështrimet e shprehura në këtë Udhëzues i përkasin autorëve të saj dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të UN Women ose të Kombeve të Bashkuara.





Udhëzues për gratë

mbi

MEGAN BASTICK DHE TOBIE WHITMAN

Nga Megan Bastick dhe Tobie Whitman

 The Institute for
Inclusive Security



DCAF

a centre for security,
development and
the rule of law

Falënderime

Autoret dëshirojnë të falënderojnë anëtarët e Bordit Këshillimor që dhanë mendime dhe sugjerime tepër të vlefshme për draftet: Ruth Gibson Caesar (Pika kombëtare fokale, Rrjeti për Paqen i Grave të rajonit Mano River, në Liberi); Wazhma Frogh (Bashkëthemeluese dhe Drejtore Ekzekutive e Institutit Kërkimor për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, në Afganistan); Alaa Murabit (Themeluese e shoqatës “Zëri i grave libiane”, Libi); Jessica Nkuuhe (Zëvendës Drejtore e “Femmes Africa Solidarité”, në Senegal); Bandana Rana (Drejtore Ekzekutive, Saathi, Nepal); dhe Sonja Stojanović (Drejtore e Qendrës për Politikën e Sigurisë në Beograd, Serbi). Dëshirojmë gjithashtu të falënderojmë Mo Poole për kontributin e saj.

Autoret u janë gjithashtu mirënjohëse të gjitha atyre që pranuan të intervistohen në mbështetje të hartimit të rasteve studimore për Udhëzuesin: Zorana Antonijević (misioni i OSBE-së në Serbi), Majda Becirevic (Nisma e Atlantikut), Maja Bjelos (BCSP), Radenka Karajica (shoqata e grave “Nada”) dhe Ivana Radovic nga (Astra Anti-Trafficking Action).

Falënderime të tjera u shkojnë asistentëve kërkimorë të DCAF-it që mbështetën punën për këtë Udhëzues: Noemi Helfenstein, Caroline Pradier dhe Veerle Triquet. Autoret vlerësojnë gjithashtu kontributet e kolegëve nga ekipi për çështjet gjinore dhe sigurinë në DCAF, Daniel de Torres, Anike Doherty, Anja Ebnöther, Karin Grimm, Aiko Holvikivi, Kathrin Quesada dhe Kristin Valasek; kolegët e Institutit për Siguri Përfshirëse, Michelle Barsa, Sarah Chatellier, Shereen Hall, Jaime Horn, Jacqueline O’Neill, dhe Angelic Young; si edhe Lorelei Kelly.

Redaktuar nga Catherine Mayhew. Dizenjo grafike nga Shelli Martinez.

Gra gjyqtare duke marrë pjesë në një seminar mbi kapacitetet për avokaci në Vlačić, Bosnje-Hercegovinë, qershor 2012. Organizuar nga DCAF dhe Nisma e Atlantikut.

 **Fotografia nga: DCAF**



DCAF

Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura në Gjenevë, e njohur me shkurtimin në gjuhën angleze DCAF, është një ndër institucionet më në zë në rang botëror në fushat e reformës së sektorit të sigurisë dhe qeverisjes së tij. DCAF ofron mbështetje këshillimore në vend dhe programe praktike asistence, harton dhe nxit normat e përshtatshme demokratike në rang ndërkombëtar dhe kombëtar, promovon praktikat e shëndosha dhe kryen hulumtime mbi politikat për të siguruar qeverisje efektive demokratike të sektorit të sigurisë.

Programi i DCAF-it për çështjet gjinore dhe ato të sigurisë funksionon përmes punës kërkimore, politikave dhe këshillimit teknik, si edhe përmes projekteve rajonale për mbështetjen e zhvillimit të sektorëve të sigurisë që plotësojnë nevojat e sigurisë së burrave, grave, djemve dhe vajzave, si dhe pjesëmarrjen e plotë të burrave dhe grave në institucionet e sektorit të sigurisë dhe proceset e reformës së sektorit të sigurisë.

Na vizitoni në këtë adresë: www.dcaf.ch
Kontakttoni me ne tek: gender@dcaf.ch

Instituti për Siguri Përfshirëse

Synimi i guximshëm i Institutit për Siguri Përfshirëse është të ndryshojë paradigmen ndërkombëtare të sigurisë. Paqja e drejtë dhe e qëndrueshme është e mundur vetëm kur hartuesit e politikave përfshijnë gratë dhe palë të tjera të interesuara në parandalimin dhe transformimin e konflikteve të dhunshme. I udhëhequr nga ky besim dhe me këtë vizion, Instituti për Siguri Përfshirëse, një program i Fondit "Hunt Alternatives Fund" mbështet rolin drejtues të grave, si një instrument thelbësor për parandalimin e dhunës, pushimin e luftërave, si edhe për rimëkëmbjen e komuniteteve pas konflikteve vdekjeprurëse përmes:

1. Forcimit të vullnetit dhe kapaciteteve të individëve që i japin formë politikave të paqes dhe sigurisë;
2. Punës kërkimore mbi rëndësinë e përfshirjes dhe mbi mënyrën sesi mund të arrihet ajo; dhe
3. Ndhmës për gratë që ato të kontribuojnë me efektivitet në proceset e ndërtimit të paqes, si dhe krijimit të koalicioneve të udhëheqësve dhe drejtuesve të ndryshëm që ofrojnë zgjidhje praktike për konfliktet e vështira.

Na vizitoni në adresën: www.inclusivesecurity.org
Kontakttoni me ne, në adresën info@inclusivesecurity.org

E drejta e autorit: DCAF & Inclusive Security, 2013. Nxitet përdorimi, përshtatja dhe kopjimi i këtij Udhëzuesi. Megjithatë, kërkohet që të përmendni dhe citoni të gjitha materialet e përdorura. Në rast se dëshironi ta përktheni këtë Udhëzues, lutemi të na kontaktoni.

ISBN: 978-92-9222-226-0

Të citohet si: Bastick, Megan dhe Tobie Whitman. A Women's Guideline to Security Sector Reform. Washington, D.C.: Institute for Inclusive Security and DCAF, 2013.



Aisha është mirënjohëse që mbaroi lufta civile në vendin e saj.

Luftëtarët po çarmatosen dhe po kthehen nëpër bashkësitë e tyre me ca para dhe furnizime nga Komisioni Kombëtar i Çarmatimit. Megjithatë, ato para shumë shpejt i harxhojnë për të blerë alkool dhe asnjë nuk di si të sillet a veprojë me këta "të kthyer", sidomos me ata që mund të kenë kryer krime mizore gjatë luftës.

Maria mëson se është duke u hartuar një strategji e re kombëtare për sigurinë.

Kur kërkon të marrë vesh nëse do të debatohet në parlament, me qëllim që të marrë më tepër informacion, ajo dëgjon se një komision i zgjedhur në mënyrë sekrete, që përfaqëson forcat ushtarake, po e harton atë pa marrë mendimin e publikut..

Toviana është e indinjuar për shkallën e dhunës në familje që ekziston në komunitetin e saj,

por është edhe më e indinjuar me reagimin e policisë vendore. Fqinja e saj është ankuar shumë herë në polici për dhunën e ushtruar nga bashkëshorti i saj, por oficerët e policisë meshkuj i thonë se ata nuk ngatërrohen me çështje familjare.

ÇFARË KANË TË PËRBASHKËT KËTO GRA?

**JETA E TYRE E PËRDITSHME
SUNDOHET NGA MUNGESA E
SIGURISË.**

Hyrje

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të sigurojë përfshirjen tuaj dhe të grave të tjera nga shoqëria civile në transformimin e sektorit të sigurisë në komunitetet dhe vendet tuaja. Ky Udhëzues ju nxit të bëheni pjesë e dialogut dhe vendim-marrjes, si edhe të përfshihen në reformën e sektorit të sigurisë (SSR). Së fundmi, ju do të ndihmoni në krijimin e një sektori të sigurisë, i cili të jetë efektiv dhe t'u japë llogari njerëzve.

Ky Udhëzues është hartuar për gra, të cilat nuk e kanë studiuar në shkollë apo nuk kanë punuar në sektorin e sigurisë. Në rast se ju tashmë i njihni çështjet e reformës në sektorin e sigurisë, shpresojmë që ky Udhëzues t'ju frymëzojë dhe t'ju japë disa ide të reja. Pavarësisht nga historiku juaj, ju i kuptoni nevojat e komunitetit tuaj dhe dëshironi ta bëni sektorin e sigurisë t'ju shërbejë më mirë.

Përvojat e grave për çështjet e sigurisë shpesh janë anashkaluar apo nënvleftësuar. Komuniteti juaj mund të ketë vuajtur nga konflikti i armatosur dhe ju mund të keni organizuar lëvizje politike, si aktiviste. Ju mund ta keni mbajtur në këmbë komunitetin, duke menaxhuar shkollat dhe spitale, dhe të keni mbajtur familjen tuaj të bashkuar, si kryefamiljare. Ju mund të keni kontribuar për të sjellë paqen, duke nxitur dialogun dhe duke i dhënë fund dhunës. Edhe në rastet kur komuniteti juaj nuk ka përjetuar konflikt të armatosur, ju keni menduar për rreziqet që kanë të bëjnë me sigurinë tuaj dhe atë të familjes suaj. Ju e dini se cilat rrugë nuk janë të sigurta mbrëmjeve, ju e dini përse hyjnë në andralla djemtë e rinj me policinë apo bandat, dhe përse vajzat shfrytëzohen.

Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura në Gjenevë (DCAF) dhe Instituti për Siguri Përfshirëse kanë hartuar këtë Udhëzues për gratë, sepse janë pikërisht ato që shpesh mbeten të përjashtuara nga reforma në sektorin e sigurisë, pavarësisht nga këndvështrimet e tyre të rëndësishme, rrjetet e forta komunitare, përvoja e tyre si aktiviste dhe aftësia për të ndikuar në ndryshimin e mentalitetit. Shpesh gratë në shoqërinë civile e gjejnë veten të lëna jashtë diskutimeve për sigurinë, për shkak se nuk janë të sigurta as vetë se si të përfshihen në këto diskutime. Reformimi i sektorit të sigurisë është kthyer në një fushë gjithnjë e më të madhe fokusi për shumë vende, organizata ndërkombëtare dhe qeveri donatore. Komuniteti ndërkombëtar e njeh rolin e rëndësishëm që duhet të luajnë gratë përmes Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 1325, e cila sanksionon pjesëmarrjen e grave në të gjitha aspektet e paqes dhe sigurisë. Por duke mos pasur njohuri, gratë në shoqërinë civile rrezikojnë të humbin mundësitë për ta përkufizuar sigurinë në komunitetet e tyre dhe për të garantuar që gratë, burrat, vajzat dhe djemtë të përfitojnë nga shërbi-

met e sigurisë për të cilat kanë nevojë. Individët që ofrojnë shërbime të sigurisë humbin mundësinë për të qenë më efektivë dhe reagues.

Ky Udhëzues ofron informacion dhe mjete të rëndësishme për veprim. Ai mbështetet mbi përvojat e pasura dhe të larmishme të grave nga shoqëria civile nga e gjithë bota dhe ofron shembuj e veprime praktike dhe, hera-herës, novatore.

DCAF dhe Instituti për Siguri Përfshirëse punojnë për nxitjen e përfshirjes së shoqërisë civile dhe sidomos të grave, në sektorin e sigurisë dhe në vendim-marrjen që ka të bëjë me të. DCAF ka punuar me organizata të shoqërisë civile (CSO) nga Azia, Ballkani, Lindja e Mesme dhe Afrika Perëndimore, për nxitjen e përfshirjes së tyre në reformën e sektorit të sigurisë. Instituti për Sigurinë Përfshirëse nxit përfshirjen e grave në përgjithësi në çështjet që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë, dhe u vjen në ndihmë koalicioneve të grave për të bërë të mundur ndryshime në politika. Mendime të jashtme nga ekspertët e sigurisë së shoqërisë civile nga Afganistani, Liberia, Libia, Nepali, Serbia dhe Uganda dhanë ndihmesën e tyre për forcimin dhe konfirmimin e vlerës së këtij Udhëzuesi.

Ky Udhëzues shërben si pikënisje; ai nuk është gjithëpërfshirës. Udhëzuesi nuk mund të quhet i plotësuar pa idetë dhe veprimet e grave si ju, të cilat mund ta përshtatin përmbajtjen e tij në rrethanat e tyre specifike. Shpresojmë që ky Udhëzues t'ju frymëzojë të përfshihen në punën për sektorin e sigurisë në komunitetin, krahinën apo vendin tuaj, dhe madje të nxisni edhe të tjerat të veprojnë si ju. Pjesëmarrja juaj është tejet e nevojshme!

Ky Udhëzues përmban tri seksione:

SEKSIONI 1: TË KUPTUARIT E SIGURISË

Ky seksion hedh dritë mbi konceptet kryesore të sigurisë dhe shpjegon reformën në sektorin e sigurisë. Në këtë seksion diskutohet mbi faktin se përse kontributi i grave në shoqërinë civile është shumë i domosdoshëm për transformimin e sektorit të sigurisë.

SEKSIONI 2: PËRFSHIHUNI

Në këtë Seksion përshkruhen gjashtë mënyra konkrete se si mund të përfshihen dhe të ndikoni tek reforma në sektorin e sigurisë, që nga hulumtimi tek planifikimi dhe tek avokacia për ruajtjen e një përfshirjeje në vijimësi në këtë sektor.

SEKSIONI 3: INSTRUMENTET PËR VEPRIM

Në këtë seksion parashtrohen një sërë veprimtarish praktike dhe instrumentesh që do t'ju vijnë në ndihmë në ndërmarrjen e veprimeve.

Pasqyra e Lëndës

Seksioni I: Të kuptuarit e sigurisë

Çfarë është siguria?	4
Çfarë përfaqëson sektori i sigurisë?	5
Çfarë është reforma e sektorit të sigurisë (SSR)?	5
Cilat janë llojet e veprimtarive që mund të transformojnë sektorin e sigurisë (SSR)?	6
Roli i shoqërisë civile në reformën e sektorit të sigurisë	7
Roli i grave në reformën e sektorit të sigurisë	8
Cilat standarde ligjore parashikojnë pjesëmarrjen e grave në reformën e sektorit të sigurisë?	12
Cilat janë sfidat me të cilat përballen gratë në shoqërinë civile përsa i takon pjesëmarrjes në reformën e sektorit të sigurisë?	21

Seksioni II: Përfshihuni

Hulumtoni për çështjet e sigurisë	14
Krijoni një koalicion	18
Planifikoni veprimet	19
Hartoni rekomandime	21
Bëni avokaci për ndryshim!	22
Caktoni objektin e avokacisë	
Bashkëpunoni me sektorin e sigurisë	

Seksioni III: Instrumente për veprim

HULUMTONI ÇËSHTJET E SIGURISË

Nr.1: Llojet dhe burimet e informacionit për hulumtim literature	36
Nr. 2: Pyetje për diskutim	37
Nr. 3: Listë kursesh trajnimi falas në internet për reformën në sektorin e sigurisë dhe çështjet që lidhen me të	37
Nr. 4: Fjalorthi i sigurisë	37
Nr. 5: Çfarë roli luajnë aktorët kryesorë të sektorit të sigurisë?	38
Nr.6: Legjislacioni rajonal dhe ndërkombëtar dhe instrumentet që lidhen me reformën e sektorit të sigurisë dhe gratë	40

KRIJONI NJË KOALICION

Nr.7 Ushtrimi për hartën e aktorëve të interesit	45
Nr.8 Model i një ftese për t'u bashkuar me një koalicion të ri që është i fokusuar tek përfshirja e grave në reformën e sektorit të sigurisë	46
Nr.9 Model i një programi mbledhjeje për mbledhjen e parë të koalicionit	47

PLANIFIKONI VEPRIMET

Nr. 10 Pyetjet që duhet të bëni gjatë planifikimit të veprimeve	47
Nr.11 Model i një planveprimi	49
Nr. 12 Model për një planveprimi	50
Nr. 13 Model rendi dite për një seminar dyditor për planifikim e veprimeve për një koalicion	52
Nr.14 Ushtrim në grup për përcaktimin e përparësive	53

HARTONI REKOMANDIME

Nr. 15 model për hartimin e rekomandimeve	54
Nr.16 Shembuj rekomandimesh	55
Nr.17 Model rekomandimesh	56

KËRKONI NDRYSHIMIN

Nr. 18 Model shkrese për një zyrtar të lartë të sigurisë ku i kërkohet takim	57
Nr. 19 Ide për bashkëpunimin me median	58
Nr. 20 model deklaratë për shtyp	59
Nr. 21 Si ta formuloni mesazhin tuaj: disa pika për të folur mbi sigurinë	60
Nr. 22 Si t'u kundërvihesh skeptikëve	61

ANGAZHIMI ME SEKTORIN E SIGURISË

Nr. 23 Model rendi dite për një trajnim dyditor për çështjet gjinore dhe reformën në sektorin e sigurisë	62
Shënime	64
Shkurtesa	66
Burime shtesë	67

Seksioni I: Të kuptuarit e sigurisë

Çfarë përfaqësojnë siguria, sektori i sigurisë dhe reforma në sektorin e sigurisë

Çfarë është siguria?

Siguria i referohet gjendjes së të qenit i çliruar nga rreziku apo kanosja. Me sigurinë, të drejtat tuaja zbatohen dhe ju trajtoheni siç duhet nga institucionet shtetërore. Siguri nuk është thjesht mungesa e konfliktit të armatosur; ajo është mjedisi ku individët mund të prosperojnë. Siguria kërkon qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor, kërkon vendosjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, si edhe zhvillim ekonomik. Siguri do të thotë që të jesh i sigurt kur ecën në rrugë, të kesh ushqim të mjaftueshëm, të kesh mundësi të mbështesësh familjen tënde dhe t'i dërgosh si djemtë ashtu edhe vajzat në shkollë. Krijimi i sigurisë është një proces në vazhdim, ku qeveria, institucionet e sektorit të sigurisë dhe komunitetet, përfshirë gratë, luajnë që të gjithë një rol të rëndësishëm.

Siguria ka domethënie të ndryshme për njerëz dhe institucione të ndryshme. Qeveritë shpesh përqendrohen tek aspektet që e bëjnë shtetin të sigurt – kufijtë e fortë, ushtria e fortë – por shumica e njerëzve përqendrohen tek e përditshmja e sigurisë për veten dhe për familjet e tyre. A mund të mjekohesh në spital kur je i sëmurë? A të vjen në ndihmë policia, pa marrë rryshfet? Drejtësia është një pjesë e rëndësishme e sigurisë: Në rast se dikush kryen një krim, a del ky individ përpara drejtësisë?

Në çdo komunitet apo vend, çdo person përjeton kanosje specifike ndaj sigurisë dhe ka përparësi të ndryshme për sigurinë. Vetë përkatësia gjinore e dikujt (së bashku me karakteristika të tjera si: klasa, përkatësia etnike/klanore/fisnore/kasta dhe orientimi seksual) luan një rol të rëndësishëm në përvojën e tij/saj për sigurinë.

FARË ËSHTË GJINIA? *GJINIA U REFEROHET ROLEVE, IDENTITETEVE DHE MARRËDHËNIEVE SHOQËRORE TË BURRAVE DHE GRAVE. GJINIA—SË BASHKU ME PËRKATËSINË ETNIKE, MOSHËN, PËRKATËSINË KLASORE DHE ATË FETARE, SI EDHE FAKTORË TË TJERË SHOQËRORE PËRCAKTON ROLET, PUSHTETIN DHE BURIMET PËR FEMRAT DHE MESHKUJT NË ÇDO KULTURË, SI DHE MARRËDHËNIET E PUSHTETIT MES BURRAVE DHE GRAVE. NDËRSA “SEKSI” I REFEROHET DALLIMEVE BIOLOGJIKE MES FEMRAVE DHE MESHKUJVE, “GJINIA” NUK PËRCAKTOHET NGA BIOLOGJIA; AJO MËSOHET. QË NË MOSHË TË HERSHME, DJEMVE DHE VAJZAVE U MËSOHEN ROLE TË NDRYSHME DHE MËNYRA TË NDRYSHME SIJLLEJESH NGA FAMILJET DHE KULTURAT E TYRE. KËTO ROLE DHE IDENTITETE TË PRANUARA MUND TË JENË TË NDRYSHME NGA NJË KOMUNITETET APO VEND NË TJETRIN, DHE MUND TË NDRYSHOJNË NGA NJËRI BREZ NË TJETRIN.*

Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, shpesh kanë nevoja të ndryshme sigurie. Në mbarë botën ata kanë përvoja të ndryshme të dhunës seksuale, trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës së ushtruar nga bandat, vjedhjet, vdekjeve për pajë, rrëmbimeve, dhe vrasjeve për çështje nderi, të cilat nuk përbëjnë një listë shteruese. Për shembull, mbi 90 për qind e rasteve të vdekjeve nga armët e zjarrit janë meshkuj,¹ ndërsa në shumicën e vendeve, një e katërta deri gjysma e grave përjetojnë dhunë fizike të ushtruar nga burrat apo të dashurit e tyre.² Po kështu, në mbarë botën, gratë, burrat, vajzat dhe djemtë kanë nivele të ndryshme qasjeje në burime të tilla si toka, paratë, arsimit, kujdesi shëndetësor dhe pushteti politik. Në rang botëror, gratë kanë në pronësi më pak se 15 për qind të tokës dhe kjo shifër është vetëm 2 për qind në botën në zhvillim.³

Gjithashtu, gratë, burrat, vajzat dhe djemtë kanë perceptime të ndryshme për sigurinë dhe nivele të ndryshme besimi tek institucionet. Në Republikën Demokratike të Kongos (DRC), gratë në rajonin e Kivusit identifikojnë dhunën seksuale, përfshirë përdhunimin, si një rrezik parësor ndaj sigurisë, ndërsa burrat kërcënohen kryesisht nga dhuna me armë dhe rekrutimi i detyruar në banda e armatosura.⁴ Hulumtimet për ndikimin e armëve të vogla të zjarrit në Afrikën Perëndimore kanë treguar se ndërsa burrat ndjehen më të sigurtë kur zotërojnë armë, gratë i shohin ato si një kërcënim brenda mureve të shtëpive të tyre.⁵

Gratë dhe vajzat në Palestinë thonë se ngacmimi nga burrat në rrugë është forma më e zakonshme e pasigurisë. Rrugët publike konsiderohen si hapësira “vetëm mashkullore” dhe për rrjedhojë lidhen me frikën, frikësimin, ngacmimet seksuale dhe kriminalitetin.⁶

Shërbimet që ofrohen nga institucionet e sektorit të sigurisë, të tilla si policia dhe gjykatat, duhet të marrin parasysh nevojat, perceptimet dhe përvojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve. Kështu, fjala vjen, policia duhet të jetë e trajnuar dhe të ketë procedura për të reaguar ndaj formave të ndryshme të dhunës me të cilat përballen burrat dhe gratë, si edhe procedura të posaçme për trajtimin e fëmijëve.

Nevojat, perceptimet dhe përvojat e ndryshme të secilës gjini duhet të merren gjithashtu parasysh në proceset e reformës së sektorit të sigurisë. Institucionet e sektorit të sigurisë shpesh lënë jashtë vëmendjes pikëpamjet e popullatës vendore. Ato rrallë diskutojnë apo vlerësojnë se cila është domethënia e sigurisë në nivel komuniteti, familjeje apo individ. Pjesëmarrja e grave dhe vajzave

në reformën e sektorit të sigurisë shpesh nënvleftësohet, ndonëse ato përbëjnë 50 për qind të popullatës. Sfidat dhe mundësitë qëndrojnë në krijimin e sigurisë për të gjithë individët.

Çfarë është sektori i sigurisë?

Tani që keni një ide se çfarë mund të jetë siguria, duhet të dini se cilët janë aktorët e ndryshëm që e sigurojnë atë. Njohja e këtyre aktorëve të ndryshëm, si dhe e punës dhe përparësive të tyre, do t'ju ndihmojë të kuptoni se kush është përgjegjës për arritjen e ndryshimeve që dëshironi të shihni.

Në vija të përgjithshme, sektori i sigurisë përbëhet nga të gjitha institucionet dhe entet e tjera që luajnë rol në garantimin e sigurisë së shtetit dhe shtetasve të vet. Këtu përfshihen:

- **FORCAT SHTETËRORE TË ARMATOSURA DHE FORCAT E SIGURISË:** forcat e armatosura dhe ato të mbrojtjes; policia; xhandarmëria; forcat paraushtarake;⁷ Roja presidenciale; shërbimet e zbulimit dhe ato të sigurisë (si ushtarake ashtu edhe civile); roja bregdetare; roja kufitare; autoritetet doganore, njësitë rezervë ose vendore të sigurisë (forcat civile të mbrojtjes, milicia shtetërore).
- **ORGANET SHTETËRORE TË MBIKËQYRJES DHE MENAXHIMIT:** ekzekutivi, organet kombëtare këshillimore të sigurisë; Parlamenti; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Brendshme; Ministria e Punëve të Jashtme; organet e menaxhimit financiar (Ministria e Financave, drejtoritë e buxhetit, njësitë e kontrollit financiar dhe planifikimit); bordet civile për shqyrtimin e ankesave ndaj policisë; komisionet e ankesave publike dhe (disa) avokatë të popullit.
- **ORGANET E PAVARURA TË MBIKËQYRJES:** organizatat e shoqërisë civile (CSO), përfshirë mediat, grupet hulumtuese të politikave dhe shoqatat profesionale; komisionet e të drejtave të njeriut; (disa) avokatë të popullit.
- **INSTITUCIONET E DREJTËSISË DHE RENDIT:** gjyqësori dhe Ministria e Drejtësisë; burgjet; Shërbimi i Provës; shërbimet e hetimit dhe ndjekjes penale; sistemet e drejtësisë zakonore dhe tradicionale (si: kryeplaku, prijësit fisnorë, këshillat tradicionale). Grupet e pavarura të

armatosura, jo-shtetërore (rebelët, milicia jo-shtetërore, etj.) dhe kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë, gjithashtu konsiderohen si pjesë e sektorit të sigurisë.

Instrumenti nr. 5 në Seksionin 3 paraqet një listë të roleve të aktorëve kryesorë të sigurisë.

Që institucionet e sektorit të sigurisë t'i shërbejnë siç duhet popullatës, ata duhet të plotësojnë standardet e duhura. Duhet të ketë:

- **KONTROLL CIVIL:** mbi të gjitha institucionet të sektorit të sigurisë. Kjo do të thotë që përgjegjësia përfundimtare e vendim-marrjes në një vend është në duart e udhëheqjes politike civile, dhe jo në ato ushtrisë profesionale apo policisë;
- **LLOGARIDHËNIE:** në mënyrë që institucionet e sektorit të sigurisë të mbahen përgjegjëse për veprimet e tyre dhe të jenë në varësi të mbikëqyrjes së gjyqësorit, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile;
- **TRANSPARENÇË:** në mënyrë që parlamenti, shoqëria civile dhe popullata të kuptojnë si dhe pse ndërmerren veprimet; dhe
- **SUNDIM TË LIGJIT:** në mënyrë që asnjë institucion i sektorit të sigurisë të mos abuzojë me pushtetin e vet apo të kufizojë të drejtat e individëve.

ÇFARË ËSHTË SUNDIMI I LIGJIT? TERMI “SUNDIMI I LIGJIT” DO TË THOTË QË TË GJITHË, NË MËNYRË TË BARABARTË, DREJTOHEN DHE MBROHEN NGA TË NJËJAT LIGJE. SUNDIMI I LIGJIT KËRKON EKZISTENCËN E NJË SISTEMI TË PAVARUR GJYQËSOR QË ËSHTË I DREJTË, I PAANSHËM, DHE TRANSPARENT, QË PARANDALON QEVERINË TË ABUZOJË ME PUSHTETIN DHE E BËN ATË PËRGJEGJËSE PËRPARA LIGJIT. GJITHASHTU, SUNDIMI I LIGJIT KËRKON QË POLICIA DHE USHTRIA TË ZBATOJNË LIGJIN ME DREJTËSI DHE PAANSHMËRI DHE TË RESPEKTOJNË TË DREJTAT E NJERIUT.

Çfarë është reforma në sektorin e sigurisë (SSR)?

Reforma e sektorit të sigurisë (SSR) është procesi i reformës (apo shndërrimit) që garanton që institucionet e sektorit të sigurisë të jenë institucione tek të cilat njerëzit *drejtohen* dhe jo institucione nga të cilat njerëzit *“ia mbathin”*.

«Aspekti më i rëndësishëm është prezantimi i përkufizimit të sigurisë nga këndvështrimi i grave. Siguri nuk është një burrë me uniformë që qëndron pranë një tanku, me armë në dorë. Gratë kanë një term më të gjerë, atë të sigurisë njerëzore, që ka të bëjë me mundësinë për të shkuar në shkollë, për të marrë kujdes shëndetësor, për të punuar, dhe për të pasur qasje në drejtësi. Vetëm përmirësimi i këtyre fushave do të bënte të mundur që t'u bëhej ballë... kërcënimeve ndaj sigurisë.»

 Orzala Ashraf, Asistenca Humanitare për Gratë dhe Fëmijët në Afganistan

Reforma e sektorit të sigurisë ka për qëllim rritjen e aftësisë së vendit përkatës për plotësimin e gamës së nevojave të sigurisë së komuniteteve, në një mënyrë që është efikase, por njëkohësisht edhe në përputhje me standardet e kontrollit civil, transparencës dhe rendit publik. Gjithashtu, reforma e sektorit të sigurisë ka për qëllim të garantojë që institucionet e sektorit të sigurisë të funksionojnë në respekt të plotë të të drejtave të njeriut dhe të mos diskriminojnë askënd.

Procesi i reformës së sektorit të sigurisë është një mundësi që ju të hyni në një dialog për atë se çfarë është siguria, si mund të funksionojnë më mirë institucionet, dhe kush duhet të jetë pjesëmarrës në diskutime. Ne e dimë që ju duhet të jeni patjetër pjesë e diskutimeve! Ju duhet të bindni personat e duhur për këtë, me qëllim që fjala juaj të ketë peshë.

Reforma e sektorit të sigurisë tingëllon si term tepër teknik, por praktikisht ajo do të thotë që të sigurohet ekzistenca dhe funksionimi i sistemeve dhe personave të duhur. Procesi duhet të jetë transformues, me qëllim krijimin e qëndrimeve, sjelljeve dhe marrëdhënieve të reja midis aktorëve të ndryshëm të sektorit të sigurisë dhe publikut.

Termi reformë e sektorit të sigurisë përdoret më shpesh në kontekste post-konfliktuale, ku bashkësia ndërkombëtare përfshihet në mbështetjen e një procesi formal të rindërtimit apo reformimit të sektorit të sigurisë. Megjithatë, reforma e sektorit të sigurisë gjithashtu zhvillohet edhe në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion nga regjimet autoritare. Aty ku ka të bëjë, për shembull, vetëm me policinë apo burgjet, ajo mund të quhet reformë në polici, apo reformë e burgjeve. Në fakt, reforma e sektorit të sigurisë përfshin të gjitha përpjekjet në vazhde për reformimin e sektorit të sigurisë dhe për ta bërë atë a kryejë punën e vet më mirë, si edhe për të qenë më i përgjegjshëm dhe më transparent. Ndonjëherë, reforma e sektorit të sigurisë mund të jetë e shpejtë; herë të tjera mund të jetë e ngadaltë dhe graduale. Por pavarësisht nëse vendi juaj ka një proces zyrtar të reformës në sektorin e sigurisë apo jo, ju mund të ndërmerri masa për të bërë institucionet e sektorit të sigurisë të reagojnë ndaj nevojave tuaja.

Cilat janë llojet veprimtarive që mund ta transformojnë sektorin e sigurisë?

Ja një model:

• FORCIMI I KONTROLLIT CIVIL DHE MBIKËQYRJES SË SEKTORIT TË SIGURISË

- Organizimi i debateve publike se pse është i rëndësishëm kontrolli civil mbi ushtrinë;
- Ngritja e një bordi vendor policie civile ku marrin pjesë burra dhe gra;
- përfshirja e medias në raportimin e reformave.

• RITJIA E PROFESIONALIZMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE ATYRE TË SIGURISË

- Trajnimi i ushtrisë dhe policisë për zbatimin e të drejtave të njeriut;
- Vlerësimi i personelit të forcave të armatosura duke kërkuar mendimin e shoqërisë civile për kandidatët

• NDËRTIMI I PAQES

- Krijimi i programeve për çmobilizimin dhe ri-integrimin e ish luftëtarëve me ndihmën e komuniteteve që do të pranojnë të kthyerit;
- Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në evidentimin dhe kthimin e armëve të fshehura;
- Ofrimi i asistencës për viktimat përmes mekanizmave provizorë të drejtësisë;

• FORCIMI I SHTETIT LIGJOR

- Garantimi që gjyqtarët të veprojnë me drejtësi dhe paanshmëri, duke luftuar dhe demaskuar marrjen e ryshfetit, përmes mbulimit nga media dhe organizatat e shoqërisë civile të çështjeve gjyqësore;
- Monitorimi i rasteve të abuzimit me të drejtat e njeriut nga ana e policisë, përmes komiteteve vendore të ankesave.

Kush e planifikon dhe zbaton reformën në sektorin e sigurisë?

Nëse ka një proces zyrtar, në rang kombëtar të reformës së sektorit të sigurisë, në të përfshihen një varg aktorësh të ndryshëm. Ndonëse numri i aktorëve mund të duket shumë i madh, kjo do të thotë njëkohësisht që ka pika të ndryshme hyrjeje për përfshirje dhe ndikim nga ana juaj. Lista që vijon më poshtë, ju jep një ide të aktorëve të ndryshëm që mund të jenë pjesë e procesit.

Aktorët në rang kombëtar

Në përgjithësi qeveritë kombëtare marrin drejtimin (ose “kanë pronësinë”) e proceseve zyrtare të reformave në sektorin e sigurisë. Zakonisht Ministria e Brendshme, apo Ministria e Mbrojtjes, apo Këshilli Kombëtar i Sigurisë janë ajo pjesë e qeverisë kombëtare që bën bashkërendimin e procesit.

Çdonjëra nga agjencitë e qeverisë dhe aktorëve nacionalë të renditura në seksionin “Çfarë është sektori i sigurisë?” mund të përfshihet në reformën e sektorit të sigurisë (SSR).

Përveç këtyre, organizatat e shoqërisë civile në rang kombëtar mund të ofrojnë ekspertizë dhe lidhje me komunitetet vendore. Për shembull, në Afrikën e Jugut gjatë fundit të viteve 1990, disa organizata jo-qeveritare (OJQ) luajtën rol shumë të rëndësishëm për transformimin e sektorit të sigurisë, si për sa i takon formimit të ideve për sigurinë, ashtu edhe për organizimin e marrjes së mendimit të qytetarëve (ku u përfshinë edhe Fushata e Armëpushimit, Instituti për Politikën e Mbrojtjes, Grupi për Studime

Ushtarake dhe Black Sash).⁸ Rolet e posaçme të organizatave të shoqërisë civile diskutohen më tej në vijim.

Ndonjëherë ngrihet një komision parlamentar i përbërë nga deputetë, apo një grup pune i përbërë nga persona nga ministri të ndryshme dhe këto mund të përfshijnë edhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile.

Organet krahinore/vendore të sigurisë

Organet krahinore dhe ato vendore të sigurisë po ashtu mund të marrin pjesë në proceset e reformës së sektorit të sigurisë. Shembuj të organeve të sigurisë vendore përfshijnë: bordet vendore të ruajtjes së rendit, komitetet vendore të sigurisë dhe grupet e rojave në komunitet. Shih shembujt nr. 9 dhe 10 nga Bosnja dhe Haiti. Reformat mund të kryhen edhe në organet dhe shërbimet vendore të sigurisë. Ndonjëherë organet e sigurisë vendore i ofrojnë informacion të rëndësishëm edhe procesit kombëtar të reformës së sektorit të sigurisë.

Aktorët ndërkombëtarë

Organizatat ndërkombëtare shumëpalëshe dhe qeveritë donatore shpesh e mbështesin reformën në sektorin e sigurisë (SSR) me fonde dhe këshillim të natyrës strategjike dhe teknike. Për shembull, ato mund të përfshihen në lehtësimin e diskutimeve, hartimin e legjislacionit, këshillimin e ministrive dhe trajnimin e policisë dhe personelit ushtarak dhe të deputetëve. Hera-herës, ato kontraktjnë kompani private ushtarake dhe të sigurisë për të ofruar këshillim apo për të trajnuar forcat e armatosura dhe ato të sigurisë.

Aktorët ndërkombëtarë duhet të garantojnë “pronësinë vendore” të procesit të reformës. Reforma e politikave të sigurisë, institucioneve dhe veprimtarive duhet të hartohet, menaxhohet dhe zbatohet nga aktorët vendas më shumë, sesa nga ata të jashtëm. Ju mund të argumentoni që përfshirja e grave është një pjesë thelbësore e pronësisë vendore. Kjo mund të jetë një mundësi shumë e mirë që ju të bëheni pjesë e diskutimeve.

Gjithashtu, OJQ-të ndërkombëtare mund të mbështesin edhe organizatat shumë-palëshe, qeveritë, forcat e armatosura dhe ato të sigurisë, organet e mbikëqyrjes dhe shoqërinë civile për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e reformës së sektorit të sigurisë.

Disa nga organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe qeveritë donatore të përfshira në reformën e sektorit të sigurisë janë renditur tek seksioni mbi Burimet shtesë.

Roli i shoqërisë civile në reformën e sektorit të sigurisë

Çfarë është shoqëria civile?

Termi “shoqëri civile” përgjithësisht kuptohet të përfshijë

individë, veprimtaritë e të cilëve zhvillohen jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të shtetit. “Organizata të shoqërisë civile (CSO)” është termi kolektiv për të gjitha llojet e organizatave dhe shoqatave që nuk janë pjesë e qeverisë, por përfaqësojnë grupet interesi jo fitimprurëse, profesione dhe komunitete të ndryshme brenda një shoqërie. Ky term përfshin OJQ-të, organizatat me bazë komunitetin, grupet fetare, organizatat e grave, grupet rinore dhe studentore, sindikatat, shoqatat profesionale, shoqëritë kulturore, dhe pedagogët universitarë dhe studiuesit. Ky term gjithashtu mund të përfshijë edhe median.

Cili është roli që luan shoqëria civile?

Shoqëria civile luan një rol kyç në mbikëqyrjen e strukturave dhe praktikave të institucioneve të sektorit të sigurisë.

Ekspertiza dhe interesat e pavarura të shoqërisë civile ofrojnë një mekanizëm të rëndësishëm kontrolli dhe balance mbi pushtetin e shtetit. Ndonëse shoqëria civile zakonisht garanton mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë duke ndihmuar në kontrollin dhe monitorimin e tij, ajo mund të përfshijë të gjithë aktorët e ndryshëm të sektorit të sigurisë në mënyra nga më të ndryshmet.


Shoqëria civile mund:

- **TË MBIKËQYRË DHE MONITOROJË;**
- **TË NDIHMOJË NË FORMËSIMIN E POLITIKAVE;**
- **TË PRODHOJË IDE TË REJA PROGRAMESH;**
- **TË PËRFSHIHET NË OFRIM TRAJNIMESH;**
- **TË OFROJË INFORMACIONE TË RËNDËSISHME PËR VEPRIMTARITË;**
- **TË OFROJË SHËRBIME SIGURIE BRENDA KOMUNITETEVE; DHE TË LEHTËSOJË DIALOGUN DHE NEGOCIATAT NDËRMJET AKTORËVE TË SEKTORIT KOMBËTAR TË SIGURISË DHE KOMUNITETEVE VENDORE.**

ÇFARË ËSHTË MBIKËQYRJA NGA SHOQËRIA CIVILE? MBIKËQYRJA E SEKTORIT TË SIGURISË, PËRFSHIRË EDHE SSR, NGA SHOQËRIA CIVILE, PËRFSHIN PJESËMARRJEN AKTIVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË PËRKUFIZIMIN E POLITIKAVE DHE MBIKËQYRJEN E STRUKTURAVE DHE PRAKTIKAVE TË AKTORËVE TË SEKTORIT TË SIGURISË. ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (CSO-TË) MBIKËQYRIN SEKTORIN E SIGURISË PËR T’U SIGURUAR QË AI E ZBATON LIGJIN ME PAANSHMËRI DHE SIPAS PARIMIT TË BARAZISË DHE U SHËRMBEN INTERESAVE DHE PËRPARËSIVE TË KOMUNITETEVE.

Seksioni 2 ju udhëzon se si mund të angazhoheni me secilën pjesë të sektorit të sigurisë. Përfundimi është se ju mund t'i ndryshoni të gjitha pjesët e sistemit.

Aktorët e sektorit të sigurisë



Rolet e grave në reformën e sektorit të sigurisë

Si promovohet siguria nga gratë e shoqërisë civile?

Gratë e shoqërisë civile kanë role të rëndësishme për promovimin e një sigurie përfshirëse dhe afatgjatë. Pjesëmarrja juaj është me rëndësi të posaçme jo thjesht sepse përfaqësoni së paku 50 për qind të popullatës, por për faktin se angazhimi dhe përfshirja juaj e bën komunitetin tuaj më të sigurtë për gratë dhe burrat. Në fund të fundit, përfshirja juaj ndihmon në arritjen dhe realizimin e objektivave thelbësore të reformës së sektorit të sigurisë.

Por ndofta juve do t'ju duhet të luftoni për të garantuar pjesëmarrjen tuaj. Përfshirja e shoqërisë civile në reformën e sektorit të sigurisë nuk është garanci që gratë do të jenë pjesë e saj. Pikat e mëposhtme shpjegojnë se çfarë u ofrojnë gratë e shoqërisë civile aktorëve të sektorit të sigurisë. Këto shpjegime në vetvete mund të jenë të dobishme gjatë punës suaj në kërkim të përfshirjes.

Gratë ofrojnë njohuri për çështjet e sigurisë brenda komuniteteve ku jetojnë. Shumë shpesh proceset e reformës së sektorit të sigurisë priren të përqendrohen tek buxhetet dhe shifrat e personelit, dhe jo tek individët dhe komunitetet. Përvojat e posaçme të grave me konfliktet dhe njohja nga ana e tyre e përparësive të komuniteteve ku jetojnë, mund të ndihmojnë reformën e sektorit të sigurisë për të pasqyruar me vërtetësi nevojat vendore. Për shembull, komitetet e sigurisë së grave në zonat rurale në disa rrethe kufitare në Sierra Leone nxisin diskutimet dhe

ndajnë informacionin e komunitetit për çështjet e sigurisë. Gjithashtu ato informojnë organet e bashkërendimit të sigurisë (Zyrën e Sigurisë Kombëtare dhe komitetet e sigurisë në rang rrethi dhe krahine) për shqetësimet dhe rreziqet që percepton komuniteti. Gjithashtu, gratë mund të ngrenë ndërgjegjësimin e hartuesve të politikave për këto shqetësime të sigurisë dhe të nxisin ndryshimin e politikave. Në Libi, organizata e shoqërisë civile, e quajtur “The Voice of Libyan Women” (VLW) (Zëri i Grave Libiane), së fundmi organizoi një vlerësim për sigurinë e femrave, i cili tërhoqi vëmendjen e Ministrisë së Brendshme dhe të Mbrojtjes. Kjo Ministri vijoi punën duke ftuar gra nga të gjitha komunitetet në rang vendi në takimet planifikuese për çarmatim, çmobilizim dhe ri-integrim, si edhe pajtim në rang kombëtar.

Shih shembullin nr. 4, për vlerësimin e nevojave vendore gjinore dhe ato të sigurisë në Serbi dhe shembujt nr. 9 dhe 10 për komisionet vendore të sigurisë në Bosnje dhe Haiti.

Gratë japin siguri. Gratë mund të bashkëpunojnë me sektorin e sigurisë për ofrimin e shërbimeve të integruara. Kështu, për shembull gratë shpesh gjenden në vijën e parë të ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës, si strehim, këshillim ligjor, asistencë mjekësore dhe psikologjike. Gjithashtu, gratë mund të ndihmojnë në zbatimin e reformës në sektorin e sigurisë në komunitetet e tyre, dhe kanë qenë partnere vitale në disa lloje programesh të SSR-së, si në programin për çarmatimin, çmobilizimin dhe ri-integrimin e luftëtarëve dhe programin për kontrollin e armëve në komunitete. Në Liberi, organizata e shoqërisë civile e quajtur “Women in Peacebuilding Network” (në shqip: Gratë në Rrjetin për Ndërtimin e Paqes) (WIPNET) luajti një rol kritik në çarmatimin e rebelëve, kur sistemi i OKB-së nuk po arrinte ta bënte një gjë të tillë. Si pasojë e besimit tek gratë vendase, shumë luftëtarë vendosën t’ua dorëzonin armët atyre. Gjithashtu, WIPNET-i rekomandoi zgjatjen e periudhës së çarmatimit, gjë të cilën OKB-ja e zbatoi. Shih shembullin e Maiti Nepal, në faqen 11, si edhe shembullin nr. 11 të Zyrës për Monitorimin e të Drejtave të Grave në Kamboxhia, dhe shembullin nr.12, ku flitet se si Bashkimi i Grave të Jemenit (Yemeni Women’s Union) u ofron shërbime të burgosurave.

Gratë rrisin aktivizimin dhe mbështetjen e komunitetit për reformën e sektorit të sigurisë. Gratë ushtrojnë ndikim të fortë brenda familjeve dhe rrjeteve të komuniteteve të tyre. Përfshirja e grave në reformën e sektorit të sigurisë mund t’i vijë në ndihmë rritjes së besueshmërisë së sistemeve të reja dhe mekanizmave të mbikëqyrjes, si edhe të përmirësimit të perceptimit publik për institucionet e sektorit të sigurisë.

Shih shembullin nr. 1, ku diskutohet se si pjesëmarrja e organizatave të grave gjatë viteve 1996-1998 në procesin e Shqyrtimit të Politikave të Mbrojtjes në Afrikën e Jugut ndihmoi në krijimin e konsensusit dhe i dha legjitimitet reformës së sektorit të sigurisë.

SHEMBULLI NR. 1: ORGANIZATAT E GRAVE DHE PROCESI I SHQYRTIMIT TË POLITIKAVE TË MBROJTJES NË AFRIKËN E JUGUT

Pjesëmarrja e organizatave të grave në procesin e shqyrtimit të politikave të mbrojtjes në vitet 1996–1998 në Afrikën e Jugut është një shembull për mënyrën se si mund të ndihmojë përfshirja e grave në ndërtimin e konsensusit dhe krijimin e legjitimitetit për proceset e reformës së sigurisë. Objektivi i shqyrtimit të politikave të mbrojtjes kishte të bënte me përvijimin e detajeve operative, të tilla si doktrina, struktura e forcave të armatosur, logjistika, armatimet, burimet njerëzore dhe pajimet. Me insistimin e grave parlamentare, Komisioni i Përbashkët e i Përhershëm Parlamentar i Mbrojtjes bëri thirrje për konsultime në rang kombëtar, si pjesë e procesit të rishikimit të politikave të mbrojtjes.

U ndërmorën një sërë masash për të garantuar pjesëmarrjen e publikut, përfshirë edhe përdorimin e avionëve luftarakë dhe autobusëve për transportin e

udhëheqësve fetarë dhe të komunitetit, aktivistëve të OJQ-ve dhe përfaqësuesve të organizatave të grave në takime dhe seminare.

Organizatave bazë të grave luajtën rol kyç në fokusimin e vëmendjes tek çështje që më parë ishin shpërfillur, si vuajtjet e komuniteteve të shpronësuara, tokat e të cilave ishin sekuestruar për përdorim nga ushtria, ndikimi në mjedis i aktiviteteve ushtarake dhe ngacmimet seksuale të grave nga personeli ushtarak.

Për të trajtuar të gjitha këto çështje u ngritën dy nën-komitete brenda Sekretariatit të Mbrojtjes. Pas një procesi dyvjeçar, ky shqyrtim i politikave të mbrojtjes me pjesëmarrje të publikut, ndihmoi në krijimin e një konsensusi kombëtar për çështjet e mbrojtjes dhe krijoi legjitimitet në publik për strukturat e reja të sigurisë.

Burimi: Sanam Naraghi Anderlini dhe Camille Conaway, *Negotiating the Transition to Democracy and Reforming the Security Sector: The Vital Contributions of South African women* (Uashington, D.C.: Nisma për Siguri Përfshirëse

(tani Instituti për Siguri Përfshirëse), 2004), 23–25.

Gratë ushtrojnë mbikëqyrje. Me përvojat e tyre të papërsëritshme me konfliktet dhe rrjetet e fuqishme në të gjitha komunitetet, gratë janë të pozicionuara siç duhet për ta vënë sektorin e sigurisë përballë përgjegjësisë. Ato e bëjnë një gjë të tillë përmes hulumtimit, avokacisë dhe fushatave për ndërgjegjësimin e publikut.

Gratë mund t'u vijë në ndihmë institucioneve të sektorit të sigurisë për trajtimin e çështjeve gjinore. Shumë nga institucionet e sektorit të sigurisë po angazhohen për “përfshirjen e aspektit gjinor” në punën e tyre, në mënyrë që të gjitha programet dhe politikat të përfshijnë nevojat dhe shqetësimet e veçanta të grave, burrave, vajzave dhe djemve. Për zbatimin e procesit të përfshirjes së aspektit gjinor dhe për të garantuar që politikat e tyre reflektojnë me vërtetësi nevojat e secilit grup, institucionet duhet të konsultohen dhe të përfshijnë gratë (njësoj si edhe burrat). Organizatat e shoqërisë civile të grave mund të ofrojnë informacion shumë të rëndësishëm mbi mënyrën se si po ndikojnë programet dhe politikat tek gratë dhe familjet e tyre dhe si ndihmojnë ato në formimin dhe zbatimin

e proceseve të konsultimit me komunitetin. Kështu, për shembull gratë mund të japin sugjerime mbi mënyrën e rekrutimit dhe mbajtjes në punë të grave të kualifikuara.

Gratë mund të ofrojnë trajnime. Gratë e shoqërisë civile mund të ofrojnë trajnime dhe forma të tjera të ngritjes së kapaciteteve për personelin e sektorit të sigurisë, menaxherët e institucioneve të sektorit të sigurisë, institucionet e mbikëqyrjes, parlamentarët dhe gazetarët. Këto trajnime mund të mbulojnë aspekte gjinore, diversitetin, të drejtat e njeriut dhe çfarëdo lloj teme tjetër brenda fushës së ekspertizës së grave. Kështu për shembull në Kirgizstan, gratë e shoqërisë civile hartuan kurrikula të cilat tashmë i zhvillojnë vetë në Akademinë e Trajnimit të Policisë, në partneritet me OSBE-në. Në Nepal, një grup grash nga shoqëria civile përpiluan një manual trajnimi mbi gratë, paqen dhe sigurinë për ushtrinë nepaleze, në partneritet me organizatën UN Women.⁹ Shihni gjithashtu Shembullin nr.4, mbi vlerësimin e nevojave vendore gjinore dhe të sigurisë në Serbi dhe Shembullin nr.7, mbi programet radiofonike “Gratë në siguri” në Sierra Leone.

SHEMBULLI 2: GRATË E SHOQËRISË CIVILE PROMOVOJNË SIGURINË: RASTI I MARWOPNET NË BASHKIMIN E MANO RIVER (AFRIKA PERËNDIMORE)

Gjatë viteve 90-të, vendet e Mano River Union, Bregu i Fildishtë, Guineja, Liberia dhe Sierra Leone, u përfshinë nga konflikte të vazhdueshme të dhunshme.

Rrjeti për Paqen i grave të Lumit Mano (MARWOPNET) u krijua në vitin 2000, kur një grup grash u mbledhën në Nigeri, për nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në rikthimin e paqes në rajonin e lumit Mano. Nisma e parë e MARWOPNET filloi në verën e vitit 2001, kur Sierra Leone dhe Liberia po përjetonin luftëra civile, ndërsa në Guine mungesa e stabilitetit po bëhej gjithnjë e më e madhe. Delegacionet e MARWOPNET-it u takuan me Presidentët e secilit prej vendeve në fjalë për t'i bindur ata mbi nevojën për rritjen e dialogut dhe bashkëpunimit në nivel rajonal.

Në Liberi, MARWOPNET-i ndihmoi në pushimin e armiqësive midis Presidentit Charles Taylor dhe drejtuesve të fraksioneve rebele në Liberi. Rrjedhimisht, Komuniteti Ekonomik i Shteteve Afrikano-Perëndimore (ECOWAS), që nxiti bisedimet për paqen midis qeverisë së Liberisë dhe forcave rebele, si fillim i dha MARWOPNET-it statusin e vëzhguesit në negociatë. Me mbështetjen e organizatës ndërkombëtare të grave, “Femmes Africa Solidarité”, anëtarët e MARWOPNET-it u trajnuan për teknikat për transformimin e konfliktit, zgjidhjen e konfliktit dhe negociatat. Në muajin qershor të vitit 2003, MARWOPNET morri pjesë zyrtare në negociatë dhe ishte e vetmja organizatë e shoqërisë civile që firmosi marrëveshjen e paqes së Liberisë, si dëshmitare në emër të grave liberiane.

Veprimtaritë e MARWOPNET-it përfshijnë një sërë masash në mbështetje të angazhimit të grave në çështjet e sigurisë. Shembulli i mëposhtëm mund t'ju shërbejë për t'u dhënë organizatave tuaja të grave disa ide për t'u marrë në konsideratë:

- MARWOPNET-i projekttoi dhe zbatoi ngritjen e kapaciteteve për grupet e grave në komunitetet në kufi me Guinenë dhe Liberinë, për të përmirësuar

dhe rritur të kuptuarit e tyre për parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve, sistemet e lajmërimit të hershëm, punës në rrjet, avokacisë dhe sigurisë së komunitetit. Grave iu shtua besimi tek vetvetja për angazhimin e tyre me institucionet e sektorit të sigurisë, si edhe u ndërgjegjësuan për rolet e posaçme që mund të luajnë (si për shembull për rekrutimin në forcat e sigurisë). Gratë kërkuan përfaqësim në Komitetet e Sigurisë në Rreth, si dhe pjesëmarrje në Bordet e Partneritetit me Policinë Vendore. Për herë të parë, një grua u zgjodh prijëse e qytetit, me synimin për t'u bërë krye-prijëse, një post që ishte mbajtur tradicionalisht nga burrat.

- Shkëmbimet tregtare ndërkufitare janë pjesë e jetës së përditshme në komunitetet kufitare në rajonin e Mano River Union. Pas marrjes së ankesave nga gratë afariste se punonjësit e sigurisë u kërkonin ryshfet, MARWOPNET-i organizoi një sërë trajnimesh ndërkufitare për t'u mësuar grave për të drejtat e tyre dhe teknikat për zgjidhjen e konflikteve.
- Pas shpërthimit të dhunës zgjedhore në Bregun e Fildishtë, MARWOPNET-i organizoi veprimtari masive, ndër të cilat: agjërime, lutje dhe marshime për paqen përpara fillimit të negociatave midis Presidentit Laurent Gbagbo dhe kandidatit për President Alassane Ouattara. Ato dërguan një delegacion për një mision vlerësimi dy ditor të situatës së refugjatëve përgjatë kufirit liberian dhe hartuan një veprimtari për zgjidhje konfliktesh, për pajtimin e grave udhëheqëse dhe ndërtimin e paqes.
- MARWOPNET-i ka tre stacione radiofonike në të gjitha vendet e Mano River Union që transmetojnë programe për përfshirjen e grave në çështjet e sigurisë.¹⁰

Si ka qenë partneriteti i grave të shoqërisë civile me institucionet e sektorit të sigurisë dhe përfshirja e tyre në proceset e reformës në sektorin e sigurisë?

Me forcat e armatosura dhe ato të sigurisë. Në Nepal, organizata e shoqërisë civile "Maiti" siguron lidhjen e të mbijetuarave të trafikimit me policinë kufitare, si pjesë e ekipeve të mbikëqyrjes së kufirit që identifikojnë gratë dhe vajzat viktime të trafikimit. Bashkëpunimi i tyre me policinë e kufirit ka çuar në identifikimin e korrupsionit në radhët e policisë, në shpëtimin e grave dhe vajzave të trafikuar dhe në ngritjen e një njësie me punonjëse policie femra për të bashkëpunuar me ekipin e mbikëqyrjes së kufirit të Maiti-it. Organizata Maiti Nepal gjithashtu i bën trajnime policisë për luftën kundër trafikimit.

Me parlamentet. Në Mbretërinë e Bashkuar, organizatat e shoqërisë civile u janë bashkuar parlamentarëve dhe zyrtarëve shtetërorë për të krijuar një Grup të Asociuar Parlamentar për gratë, paqen dhe sigurinë. Grupi i Asociuar Parlamentar analizon çështje që kanë të bëjnë me UNSCR 1325 dhe përqendrohet në nxitjen e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për promovimin e këtij programi. Anëtarët e Parlamentit publikojnë pyetjet që bëjnë në parlament dhe letrat që u drejtojnë ministrave për çështje të grave, paqes dhe sigurisë, si dhe vënë në pah debatet që zhvillohen mbi këto tema në parlament. Përveç ndihmës që jep për t'i kërkuar llogari qeverisë për angazhimet e saj në kuadrin e Planit Kombëtar të Veprimit, Grupi i Asociuar Parlamentar ndihmon edhe në ruajtjen e marrëdhënieve produktive midis ministrave të linjës të përfshira në UNSCR 1325 dhe komunitetit të OJQ-ve, si edhe rrit ndërgjegjësimin e parlamentit për këtë çështje.¹¹

Me ministratë e linjës. Në Fixhi, organizatat e grave nga shoqëria civile që punojnë me Ministrinë për Çështjet e Grave, u takuan me Komisionin Qeveritar për Siguri Kombëtare dhe Shqyrtim të Politikave të Mbrojtjes, si pjesë e procesit të shqyrtimit për vitin 2003. Në takim u përfshinë diskutime për mënyrën sesi po zhvillohej procesi i shqyrtimit, kush ishte konsultuar, çështjet e evidentuara si rreziqe për sigurinë dhe mënyra se si po përfshiheshin në programet e mbrojtjes standardet dhe normat ndërkombëtare (përfshirë UNSCR 1325). Grupet e grave i bënë dy parashtrime komitetit, ku

përfshiheshin edhe rekomandime që Ministria për Çështjet e Grave të bëhej anëtare e përhershme e Këshillit Kombëtar të Sigurisë, si edhe për përfaqësimin e grave në komisionet e sigurisë në nivel krahine dhe rrethi.

Me organizatat ndërkombëtare. Në Bosnje dhe Kamboxhia, grupet e grave hynë në partneritet me organizatën UN Women, me qëllim organizimin e trajnimeve për drejtuesit e forcave të rendit në komunitet, në mënyrë që këta të fundit tu përgjigjeshin më mirë nevojave të grave, duke i bërë njësitë më efikase për përmirësimin e sigurisë në mbarë komunitetin.¹²

Çfarë ndryshimi sjellin gratë që punojnë në institucionet e sektorit të sigurisë?

Ashtu sikundër gratë nga shoqëria civile e bëjnë më efikas sektorin e sigurisë, gratë që punojnë brenda institucioneve të sektorit të sigurisë ndihmojnë që këto të bëhen më reaguese ndaj të gjithë segmenteve të komunitetit. Ju mund të frymëzoheni nga roli që luajnë disa nga gratë me uniformë. Gjithashtu gratë e institucioneve të sektorit të sigurisë mund t'i konsideroni si partnere të mundshme.

Shtimi i numrit të grave brenda radhëve të policisë mund të ndihmojë sidomos në përmirësimin e reagimeve ndaj dhunës në familje dhe asaj seksuale. Këto përfaqësojnë disa nga krimet më të përhapura si në shoqëritë që nuk kanë të përfshira në konflikte, ashtu edhe në ato post-konfliktuale. Ka prova të shumta e të pakundërshtueshme, përfshirë edhe nga vende si Republika Demokratike e Kongos, India dhe Sierra Leone, që femrat viktime të dhunës seksuale kanë shumë më tepër gjasa ta raportojnë rastin tek një punonjëse policie femër apo në një rajon policie për gratë, sesa tek një punonjës policie mashkull në një rajon policie të zakonshëm.¹³

Po ashtu, femrat e traumatizuara nga krimet gjatë konflikteve shpesh ngurrojnë të flasën me punonjës policie meshkuj, por janë të gatshme të komunikojnë me punonjëse policie femra. Kështu, për shembull në Liberi, ngritja e Seksionit për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve brenda policisë, me personel kryesisht femëror, bëri që gratë të kishin më shumë besim për raportimin e krimeve dhe çoi në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për të drejtat e grave dhe dhunën seksuale.¹⁴

«Kam përshtypjen e fortë se e ardhmja është në duart e grave të rajonit Mano River... Gratë janë ato që drejtojnë familjet, janë ato që janë shumë të angazhuara në punët e komunitetit, dhe shumë të përkushtuara për sigurimin e paqes për vendet e tyre...»

Kolonel Birame Diop, nga Partners Senegal"

Për më tepër, ka prova në rritje se gratë me uniformë kanë më shumë gjasa të ulin tensionet se sa kolegët e tyre meshkuj, dhe përsëri më pak të përdorin forcë të tepruar.¹⁵ Po kështu, punonjëset femra në polici, forcat ushtarake dhe ato kufitare, mund të kryejnë detyra kritike që mund të jenë të vështira për burrat për arsye mentaliteti, si për shembull kontrolli trupor i grave në pikat e kalimit kufitar. Burime të mëtejshme për rolet e grave brenda institucioneve të sektorit të sigurisë mund t'i gjeni në Manualin për Çështjet Gjinore dhe Sektorin e Sigurisë të DCAF, OSBE/ODIHR, UN-INSTRAW.

Cilat janë standardet ligjore që përcaktojnë pjesëmarrjen e grave në reformën e sektorit të sigurisë (SSR)?

Ka një sërë rezolutash, konventash dhe marrëveshjesh që përmbajnë referenca për barazinë gjinore dhe përfshirjen e grave në fushën e sigurisë. Këto ligje, instrumente dhe norma përcaktojnë përgjegjësi specifike për sektorin e sigurisë dhe u japin grave TË DREJTËN të marrin pjesë në proceset e reformës së sektorit të sigurisë.

Në rang kombëtar

Shumë vende kanë legjislacion kombëtar për barazinë gjinore që garanton pjesëmarrjen e grave në jetën dhe institucionet publike. Këto ligje mund të jenë instrumente të dobishme, si argumente në favor të përfshirjes në proceset e reformës së sektorit të sigurisë. Disa vende kanë plane kombëtare pune për dhunën kundër grave apo për zbatimin e UNSCR 1325, ose të dyja bashkë. Marrëveshjet e paqes dhe kushtetutat mund të përmbajnë kuota për pjesëmarrjen e grave në organe të posaçme qeveritare dhe të sektorit të sigurisë. Këto instrumente përbëjnë një kuadër për punën e institucioneve të sektorit të sigurisë për bashkëpunimin me gratë nga shoqëria civile.

Në rang rajonal dhe ndërkombëtar

Legjislacioni dhe instrumentet rajonale mund të përcaktojnë standarde për pjesëmarrjen e grave dhe për përmirësimin e reagimit të sektori të sigurisë ndaj nevojave të grave. Për shembull, gratë aktiviste afrikane shpesh i referohen *Protokollit për Kartën Afrikane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve për të Drejtat e Grave në Afrikë*. Ekzistojnë një sërë instrumentesh ndërkombëtare me rëndësi shumë të madhe për pjesëmarrjen e grave, ku ndër më të rëndësishmet mund të përmendim UNSCR 1325 dhe *Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave* (CEDAW). Ato kanë mbështetje globale dhe përfaqësojnë standarde për matjen e legjislacionit dhe politikave në nivel kombëtar dhe rajonal.

Instrumenti nr. 6 i Seksionit 3 rendit disa prej ligjeve dhe instrumenteve më të rëndësishme që lidhen me pjesëmarrjen e grave në reformën e sektorit të sigurisë.

Cilat janë vështirësitë që hasin gratë nga shoqëria civile për pjesëmarrjen e tyre në reformën e sektorit të sigurisë?

- Reforma e sektorit të sigurisë shpesh konsiderohet si një çështje “e vështirë sigurie”, e cila duhet të trajtohet (në mënyrë sekrete) nga “ekspertët” (zakonisht burra).
- Për gratë mendohet se nuk kanë ekspertizë për çështjet e sigurisë.
- Shumë politika dhe shqyrtime të sigurisë në rang kombëtar përqendrohen tek rreziqet që i vijnë shtetit nga jashtë, në vend që të përqendrohen tek siguria e komunitetit, ku gratë përsëri të jenë më të angazhuara.
- Këshilltarët ndërkombëtarë dhe kombëtarë për çështjet e reformës së sektorit të sigurisë shpesh nuk arrijnë të kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes me bazë të gjerë dhe u mungon ekspertiza për mënyrën e përfshirjes së burrave dhe grave.
- Proceset e SSR shpesh nuk kanë buxhet për të rritur pjesëmarrjen masive të burrave dhe grave.
- Shqetësimet e ndryshme për sigurinë personale mund t'i pengojnë aktivistët e shoqërisë civile të flasin hapur (diskutohet në Seksionin 2).
- Ka një ndjesi mosbesimi midis organizatave të shoqërisë civile (sidomos organizatat e grave) dhe institucioneve të sektorit të sigurisë për shkak të mentaliteteve të tyre tepër të ndryshme.



Ndonëse ende ka sfida, tashmë po pranohet gjithnjë e më shumë vlera e përfshirjes së grave në reformën e sektorit të sigurisë. Një numër gjithmonë e më i madh politikash dhe ligjesh sanksionojnë përfshirjen e grave dhe shërbejnë si pikënisjeje për ato që duan të marrin pjesë. Planet e reja kombëtare të veprimit në kuadrin e UNSCR 1325 ua kalojnë përgjegjësinë e përfshirjes qeverive kombëtare, ku gra si ju kanë shumë më tepër potencial të ushtrojnë ndikimin e tyre. Kjo do të thotë që ju jepet mundësia të angazhoheni në ri-strukturimin e ministrive tuaja të mbrojtjes, të ushtrisë dhe të policisë, si edhe në krijimin e strukturave më të mira të sigurisë në nivel vendor dhe rrethi. Keni mundësinë të përfshini në të gjitha diskutimet nevojat reale, të përditshme, të të gjitha pjesëve të komunitetit tuaj, si gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Kurrë më parë nuk ka ekzistuar një dritare e tillë mundësie që gratë nga shoqëria civile të ndihmojnë në krijimin e një sigurie me më shumë barazi dhe më tepër hapësirë për llogaridhënie. Ndonëse vendi juaj mund të mos e ketë një plan veprimi, apo mund të mos jetë dukshëm mbështetës i përfshirjes dhe angazhimit të shoqërisë civile, ndryshimin mund ta sillni ju. Seksioni në vijim ju jep disa udhëzime se si ta kapni momentin!

Kishwar Sultana diskuton rolin e grave për zbutjen e ekstremizmit të dhunshëm në Pakistan me zyrtarë të lartë të sigurisë në një tryezë të rrumbullakët në Uashington, DC në vitin 2010.

Fotografia nga: Instituti për Siguri Përfshirëse



Seksioni II: Përfshihuni

Si mund të përfshiheni në reformën e sektorit të sigurisë?

Shoqëria civile ka një rol shumë të rëndësishëm në transformimin e sektorit të sigurisë - që nga bërja thirrje për reforma, deri tek puna si këshilltore dhe eksperte. Shoqëria civile përfaqëson interesat e komuniteteve. Si individë dhe anëtare të organizatave të shoqërisë civile, gratë ofrojnë këndvështrime të ndryshme dhe me rëndësi të madhe. Ky Seksion përqendrohet tek mënyrat praktike sesi mund të jeni pjesë e proceseve të sigurisë.

Këto mund t'i shihni si gjashtë veprimtari të ndryshme, por të lidhura me njëra-tjetrën:

- **HULUMTONI ÇËSHTJET E SIGURISË:** Konstatoni se cilat janë shqetësimet dhe nevojat e sigurisë në komunitete të ndryshme, apo mënyrën se si po trajtohen probleme të veçanta të sigurisë.
- **KRIJONI NJË KOALICION:** Ndërtoni partneritete me palë të tjera të interesuara për krijimin e një sektori sigurie më reagues dhe më gjithëpërfshirës ndaj grave.
- **PLANIFIKONI VEPRIME:** përpiloni një plan veprimi për arritjen e ndryshimeve në legjislacion, politika apo praktika institucionale.
- **HARTONI REKOMANDIME:** formuloni rekomandime konkrete për veprim, që i drejtohen institucioneve specifike të sektorit të sigurisë.
- **PUNONI PËR NDRYSHIMIN:** flisni me politikanë, nëpunës civilë dhe zyrtarë të lartë në institucionet e sektorit të sigurisë për ndryshimet që kërkonin të arrini dhe mundohuni të rrisni ndërgjegjësimin për nevojën për ndryshim.
- **BASHKËPUNONI ME SEKTORIN E SIGURISË:** krijoni struktura të reja, ose përfshihuni në strukturat ekzistuese vendore të sigurisë. Monitorojini ato, u ofroni trajnime, ose bashkëpunoni me institucionet e sektorit të sigurisë për ofrimin e shërbimeve.

Ka shumë mundësi që krahas avokacisë, të bëni edhe punë kërkimore dhe për krijimin e koalicioneve, duke sjellë gjithmonë informacione të reja në angazhimet tuaja me hartuesit e politikave. Po ashtu, sa më shumë të informoheni mbi sektorin e sigurisë, aq më strategjike do të bëhen rekomandimet tuaja.



ÇFARË ËSHTË AVOKACIA? AVOKACIA ËSHTË NJË PËRPIEKJE E PLANIFIKUAR, E QËLLIMSHME DHE E VAZHDUESHME PËR TË ARRITUR NDRYSHIM. INDIVIDËT DHE ORGANIZATAT E KRYEJNË AVOKACINË PËRMES PROMOVIMIT TË NJË IDEJE PËR MËNYRËN SE SI MUND TË BËHEN MË MIRË DISA GJËRA TË CAKTUARA. KUR ËSHTË E SUKSESSHME, AVOKACIA SJELL REZULTATE KONKRETE. SI DHE KUJT IA KALONI INFORMACIONIN QË MBLIDHNI KA RËNDËSI KRITIKE.

Hulumtoni çështjet e sigurisë

Ju ndofta mund të keni një çështje të caktuar sigurie që ju shqetëson. Megjithatë, hapi i parë që duhet të ndërmerri është të mësoni më shumë për problemet e sigurisë së grave dhe burrave në komunitetin, krahinën apo vendin tuaj. Hulumtimet dhe puna kërkimore do t'ju japin mundësinë të paraqisni informacion të besueshëm. Kryerja e punës kërkimore është gjithashtu një mënyrë për të folur drejtpërsëdrejti me punonjësit e sektorit të sigurisë dhe të krijoni kontakte dhe dialog me ta. Mos u shqetësoni nëse nuk keni shumë burime dhe mjete. Mund të kryeni punë kërkimore të dobishme edhe pa pasur kompjuter, internet apo shumë fonde.

Çfarë mund të hulumtohet?

Fusha e hulumtimit tuaj mund të jetë e ngushtë dhe e gjerë. Më poshtë jepen disa nga mundësitë për t'u marrë në konsideratë:

- Hulumtoni perceptimet e grave, burrave, vajzave dhe djemve për sigurinë dhe institucionet e sektorit të sigurisë. Shihni shembullin nr. 3 për një organizatë të shoqërisë civile në Libi.
- Hetoni një problem të veçantë të sigurisë, për shembull, dhuna në rrugë, pikat e kontrollit rrugor, apo dhuna në familje.
- Shqyrtoni një institucion të caktuar të sektorit të sigurisë, për shembull mënyrën se si i trajton policia burrat dhe gratë. Mund të përdorni *Udhëzuesin e Vetë-Vlerësimit Gjinnor për Policinë, Forcat e Armatosura dhe Sektorin e Drejtësisë të DCAF-it*, si udhëzues për procesin dhe për formulimin e pyetjeve.
- Kryeni hulumtime me bazë të gjerë që shqyrtojnë rreziqet e ndryshme të sigurisë me të cilat përballen burrat dhe gratë, dhe mënyrën se si trajtohen burrat dhe gratë nga segmente të ndryshme të sektorit të sigurisë. Kjo mund të bëhet në nivel vendor, krahine apo kombëtar. Shihni shembullin nr. 4 për vlerësimin e nevojave gjinore dhe atyre të sigurisë në Serbi.

Si hulumtohet?

Mënyra se si e zhvillon punën kërkimore varet nga burimet tuaja dhe sa "rehat" ndiheni në bashkëpunimin me persona dhe institucione të veçanta (kjo diskutohet më poshtë në kontekstin e sigurisë personale). Mos harroni se mendimet e grave për çështjet e sigurisë priren të marginalizohen. Edhe një hulumtim në shkallë të vogël i fokusuar tek gratë mund të sjellë një ndihmesë të rëndësishme.

Mendoni për mënyrat e përfshirjes së grupeve të marginalizuara në punën tuaj kërkimore, si pakicat etnike, fetare dhe gjuhësore; homoseksualët, lesbiket, biseksualët dhe transgjinnorët; personat me aftësi të kufizuara; të

varfrir dhe analfabetët. Kur i kryejnë vetë hulumtimet, këto komunitete mund të ndihen shumë të fuqizuara.

Më poshtë jepen disa ide se si mund ta zhvillon hulumtimin:

Përdorni gjithçka që ekziston (studim i literaturës

ekzistuese): Së pari, kërkoni a ka hulumtime ekzistuese nga organizatat apo universitetet. Instrumenti nr. 1 në Seksionin 3 përmban një udhëzues të llojeve të burimit të informacionit për studim literature, ndërsa tek Burimet Shtesë renditen disa burime specifike informacioni për sektorin e sigurisë. Qeveria, Parlamenti, Avokaci i Popullit, apo komisione të drejtave të njeriut në vendin tuaj mund të kenë publikuar raporte apo statistika, të cilave mund t'u referoheni (për të përforcuar argumentet tuaj gjatë punës së avokacisë me qeverinë).

Intervistoni njerëz: Përpiloni një listë të personave që kanë këndvështrime të ndryshme për tematikën që po hulumtoni. Në nivelin e komunitetit, këtu mund të përfshihen organizata të tjera të shoqërisë civile, udhëheqës fetarë, të rinj, nëpunës të këshillave vendore dhe burra e gra që punojnë në sektorin e sigurisë.

Në nivel krahine apo kombëtar mund të takoheni me zyrtarë shtetërorë, parlamentarë, studiues, gazetarë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Për intervistën përgatitni një listë paraprake të temave apo pyetjeve që dëshironi të trajtoni. Merrni masa që të intervistoni si burrat, ashtu edhe gratë.

Organizoni takime me gratë dhe burrat në nivel vendor:

Gjatë bisedave me gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në komunitetin tuaj do të zbuloni se cilat janë nevojat e tyre të sigurisë dhe çfarë ndryshimesh do të donin ata të shihnin. Planifikojini takimet tuaja me kujdes, në mënyrë që gratë të gjejnë kohë për të marrë pjesë pa ndërhyrë në kujdesin për familjen dhe në angazhimet e tjera të tyre. Mendoni nëse duhet të merrni masa të posaçme, si sigurimi i transportit apo mbajtja e fëmijëve. Ndoshta mund të dëshironi të mbani takime të veçanta për secilën gjini. Krijoni hapësirë për dialog të hapur, ku pjesëmarrësit të mos kenë frikë se ajo që do të thonë do të raportohet në një mënyrë që i dëmton.

«Pa punë kërkimore nuk do të kishim qenë në gjendje të zbulonim dhe të sillnim në tryezën e negociatave palët ndërluftuese në luftën e Liberisë në vitin 2003. Në çdo hap të procesit informacioni dhe të dhënat i dhanë formë vendimeve dhe veprimeve tona».

 *Ruth Gibson Caesar, MARWOPNET, Liberi*


Organizoni grupe fokusi: Grupi i fokusit është një diskutim i drejtuar nga një moderator, me një numër (ideal) prej 7-12 pjesëmarrësish të përzgjedhur. Ai nuk duhet të zgjasë më shumë se dy orë. Grupet e fokusit kanë për qëllim mbledhjen e perceptimeve, opinioneve, besimeve dhe qëndrimeve të pjesëmarrësve për një temë të caktuar. Grupet e fokusit mund të jenë një instrument shumë i mirë për të eksploruar qëndrimet e pakicave dhe grupeve të tjera të veçanta, ose për të mbledhur informacione nga një numër komunitetesh të ndryshme. Shqyrtoni nëse është më mirë të keni grupe të veçanta fokusi për secilën gjini, me qëllim që çdo grup t'i shprehë lirisht mendimet e tij.


Kryeni një mini-anketim: Mini-anketim quhet një pyetësor me një numër të vogël pyetjesh që kërkojnë përgjigje “po/ jo” që u jepet 25 deri 75 personave. Mini-anketimet mund t'i bëni me persona që kanë qenë në një stacion policie, gjykatë, ose tek shërbimet për viktimat. Nëse personat që doni të përfshini në anketim mund të përdorin kompjuterin, instrumente anketimi në internet si *Survey Monkey* mund të jenë të dobishme dhe ndihmojnë në mbrojtjen e identitetit të pjesëmarrësve. Mini-anketimi nuk ka përgjigje të mjaftueshme për të përfaqësuar mendimet e të gjithë popullatës, por gjithsesi mbetet një burim i dobishëm informacioni.

Shkoni në komisaritet e policisë, burgjet, pikat kufitare të kontrollit etj.: Në disa vende, lejohet që anëtarë të publikut të inspektojnë komisaritet e policisë.¹⁶ Po kështu, organizatat e shoqërisë civile të grave janë të përfshira në ofrimin e shërbimeve dhe programeve për gratë në burgje. Shembulli nr. 12 flet për rastin e Jemenit. Ju mund tu bashkoheni skemave të tilla, apo të punoni me organizata që i zhvillojnë këto veprimtari, për mbledhjen e informacionit për mjediset dhe praktikat.

Janë hartuar shumë metoda për përfshirjen dhe angazhimin e komuniteteve në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve përkatëse publike si: “skeda raportimi të qytetarëve,” “skeda vlerësimi për shërbimet komunitare” dhe “plani/kontrolli i sigurisë në komunitet”. Burimet Shtesë në këtë Udhëzuesi sugjerojnë disa materiale që përmbajnë këto teknika hulumtimi.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, regjistroni/shënori nëse informacioni ka ardhur nga një grua, burrë, djalë apo vajzë, si edhe grup-moshën përkatëse (d.m.th. mbledhni të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe moshës), në mënyrë që të mund të analizoni dallimet mes grupeve. Kjo do t'ju mundësojë të flisni me besim për nevojat e ndryshme dhe të hartoni rekomandime të posaçme sipas gjinisë dhe moshës. Në varësi të kontekstit tuaj, mund të jetë e rëndësishme të regjistroni edhe karakteristika të tjera si besimi fetar, grupi gjuhësor apo përkatësia etnike.

 *Mendoni për mundësinë e kryerjes së hulumtimeve në bashkëpunim me akademikë, grupe studimore në fushën e sigurisë ose organizata që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës. Vendosni lidhje midis ofrimit të shërbimeve dhe politikave. Shpesh organizatat e shoqërisë civile angazhohen në ofrimin e shërbimeve (për shembull strehëzat), por atyre u mungojnë burimet për mbledhjen e të dhënave, analizimin e tyre, dhe hartimin e rekomandimeve strategjike. Organizatat e shoqërisë civile mund të bashkojnë forcat për të përdorur së bashku burimet ekzistuese, në mënyrë që informacionet dhe përvojat e përftuara nga ata që i ofrojnë këto shërbime të përkthehen në rekomandime për politikën dhe t'i paraqiten qeverisë.*

 *Kërkoni mundësi për ngritjen e kapaciteteve, për të shtuar njohuritë tuaja për sigurinë dhe aftësitë e avokacisë. Në instrumentin nr. 3 tek Seksioni 3 mund të gjeni kurse trajnimi pa pagesë në internet.*

SHEMBULLI NR. 3: ANKETIMET ME POSTERA NË LIBI

Organizata “Voice of Libyan Women”, VLW, (në shqipë “Zëri i grave libiane”) ka përdorur anketime të thjeshta me anë të posterave, për të mësuar më shumë se çka duan njerëzit në komunitetet e tyre. Për dy javë gjatë vitit 2011, VLW ngriti kioska pothuaj në çdo treg në Zawia dhe Tripoli dhe u kërkoi grave dhe burrave libianë të të gjitha moshave të shkruanin se çfarë donin të përmirësohej në

jetën e grave libiane. Një anketim i tillë në Tripoli tregoi se nga 142 gra libiane të anketuara, afërsisht 50 për qind mendonin se gjëja më e rëndësishme për Libinë e re ishte përmirësimi i sektorit të arsimit, pas së cilës vinin rritja ekonomike (24 për qind), kujdesi shëndetësor (9 për qind), infrastruktura (9 për qind) dhe siguria (4 për qind).

Burimi: Zëri i Grave Libiane, Raport Vjetor 2011 (Tripoli: VLW, 2012).

SHEMBULLI NR. 4: VLERËSIMI I NEVOJAVE VENDORE GJINORE DHE TË SIGURISË NË SERBI

Qendra për Politikën e Sigurisë në Beograd (BCSP), një qendër e pavarur kërkimore që fokusohet tek përmirësimi i sigurisë së qytetarëve, vërejti se problemet e sigurisë që ndikojnë tek gratë rrallë ishin marrë parasysh në nivel vendor. Institucionet vendore të sektorit të sigurisë nuk i kuptonin nevojat e veçanta të grave dhe anëtarët e këshillave bashkiake për barazi gjinore nuk kishin njohuri të mjaftueshme për marrëdhëniet midis gjinisë dhe sigurisë. Si reagim ndaj kësaj situatë, në vitin 2011, BCSP-ja ndërmori një vlerësim në nivel vendor të nevojave gjinore dhe atyre të sigurisë.

Vlerësimi i nevojave nga BCSP-ja përfshinte tre komponentë: analizën e të dhënave, trajnim dhe ndërgjegjësim, dhe konsultime. U organizuan katër raunde konsultimesh njëditore në vende të ndryshme. Në to u përfshinë organizatat të grave të shoqërisë civile, autoritetet vendore, organet vendore të sigurisë, organet bashkiake të barazisë gjinore, këshillat bashkiake, këshillat për sigurinë dhe parandalimin

e krimit, policia, prokuroria dhe media. Konsultimet, që përfshinin një kombinim ushtrimesh trajnimi dhe diskutimesh trajtuan katër aspekte:

- Marrëdhëniet midis gjinisë dhe sigurisë;
- Rreziqet kryesore që u kanosen grave nëpër bashki e komuna;
- Krijimi i partneritetit midis organeve bashkiake që përgjigjen për çështjet gjinore dhe këshillave bashkiakë për çështjet e sigurisë; dhe
- Shembuj pozitivë nga bashki e komuna të tjera në Serbi.

Vlerësimi i nevojave ofroi një platformë për dialog midis grave të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të sektorit të sigurisë. Ai forcoi njohuritë ekzistuese të të gjithë pjesëmarrësve për lidhjet midis gjinisë dhe sigurisë, lehtësoi bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile dhe, për më tepër, shërbeu si themel për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit në Serbi në kuadrin e UNSCR 1325.

Burimet: Gorana Odanović dhe Maja Bjeloš, Bezbednost i rodna ravnopravnost na vendoru (Belgrade: BCSP, 2011), <http://bezbednost.org/Svepublikacije/4665/Bezbednost-i-rodna-ravnopravnost-na-vendoru.shtml>; intervista me Sonja Stojanović nga BCSP, 24 korrik 2012; Maja Bjeloš nga BCSP, 24 korrik 2012; dhe Zorana Antonijević nga OSBE, 4 gusht 2012.

Qasja në informacionin

Në shumë vende, sektori i sigurisë është “i mbështjellë” nga një tis sekreti, kështu që sigurimi i aksesit në informacion mund të duket si një ndërmarrje shumë e vështirë. Zyrtarët shtetërorë dhe personeli i sektorit të sigurisë mund të mos jenë shumë të gatshëm për ta ndarë informacionin me organizatat e shoqërisë civile, madje edhe atë informacion që supozohet të jetë publik, ose mund të kërkojnë autorizim për ta bërë një gjë të tillë.

Më poshtë jepen disa strategji për t’ju ndihmuar të keni qasje në informacione nga institucionet e sigurisë:


Kushtojini kohë sigurimit të mbështetjes për hulumtimin tuaj. Në fillim të fazës kërkimore u shkruani letra drejtuesve të lartë vendim-marrës në institucionet e sigurisë që


po hulumtoni. Ua shpjegoni punën tuaj kërkimore dhe shprehni dëshirën për bashkëpunim. Takohuni me ta dhe përpiquini të merrni autorizim zyrtar për të kontaktuar me persona të tjerë. Kjo do t’u tregojë se keni qëllime të mira dhe po veproni sipas rregullave të institucionit.

Përdorni qasje informale. Nëse njihni dikë që punon aktualisht apo që ka punuar më parë në institucionet e sigurisë kërkojini t’ju ndihmojë për të organizuar takime.

Bëni biseda jozyrtare. Një mënyrë e mirë për të kontrolluar apo plotësuar informacionin e nxjerrë nga intervistat zyrtare dhe dokumentet zyrtare, është që të bisedoni me një të njohur që punon në një institucion të sektorit të sigurisë me një filxhan kafeje përpara.

Ofroni të bëni një prezantim informal të gjetjeve tuaja tek institucioni (institucionet) e sektorit të sigurisë që po hulumtoni, përpara se t'i bëni ato publike. Në vend që t'u jepni projekt-raportin, shqyrtoni mundësinë e organizimit të një "seminari vleftësimi" ku të prezantoni dhe diskutoni gjetjet kryesore të hulumtimit tuaj. Kjo mund të jetë mënyrë e mirë për të kontrolluar rekomandimet tuaja me realitetin, si dhe për të parë reagimet.

 *Informohuni nëse vendi juaj ka një ligj që garanton qasje në informacione shtetërore. Nëse po, mund t'i referoheni ligjit në fjalë, ose të bëni një kërkesë zyrtare në bazë të tij.*

 *Përdorimi i lidhjeve zyrtare dhe jozyrtare për të kontaktuar me njerëz në pushtet mund të jetë një strategji e mirë; megjithatë, duhet të bëni kujdes që kjo të mos minojë integritetin dhe pavarësinë tuaj dhe atë të koalicionit tuaj. Njerëzit që ju ndihmojnë, ndonjëherë mund të kujtojnë se u jeni "borxhli", apo që nuk do të mbani qëndrimi shumë kritik ndaj shefit/drejtorit apo institucionit të tyre.*

Etika në hulumtim dhe siguria personale

Etika e hulumtimit kërkon që të respektoni si hulumtuesit tuaj, ashtu edhe pjesëmarrësit në hulumtim, si dhe të merrni masa për minimizimin e çdo dëmi që mund të vijë si pasojë e hetimeve tuaja. Hulumtimi juaj duhet të jetë i ndërtuar në mënyrë të tillë që të maksimizojë përfitimet për pjesëmarrësit dhe komunitetet e tyre. Duhet të vendosni rregulla dhe t'i ndiqni ato. Për shembull, a do t'i bëni publikë emrat e personave që do të intervistoni? A është e nevojshme t'i regjistroni emrat vetëm me kod? Sidomos hulumtimet për dhunën me bazë gjinore janë veçanërisht të ndjeshme dhe kërkojnë shumë vëmendje dhe kujdes.¹⁷

Fatkeqësisht, në disa vende, puna kërkimore dhe avokacia për çështje që lidhen me sigurinë mund të jenë me rrezik, madje mund të ketë edhe kërcënime ndaj hulumtuesve dhe ndaj familjeve dhe kolegëve të tyre. Ju mund t'i vini në rrezik njerëzit që ndajnë informacion me ju.

Organizatave e shoqërisë civile duhet të mendohen me kujdes përpara se të zhvillojnë aktivitete që vënë në rrezik sigurinë e dikujt. Në pjesën dërrmuese të rasteve, veprimtaritë që lidhen me punën kërkimore dhe hulumtimet apo avokacinë duhet të ndërpriten menjëherë nëse ato vënë në rrezik sigurinë e dikujt. Organizatat e shoqërisë civile nuk duhet të ndërmarrin në asnjë rast rreziqe të panevojshme apo t'i vënë në rrezik personelin e tyre apo subjektet e hulumtimit pa pëlqimin e shprehur të këtyre të fundit dhe, edhe atëherë pas kryerjes së një vlerësimi të kujdesshëm të rrezikut.¹⁸

Shqyrtoni mundësinë për mbajtjen e seanceve apo seminareve për mbledhjen e mendimeve, si mjedise të përshtatshme për të folur mbi sfidat e sigurisë dhe për të diskutuar strategji për të qëndruar jashtë rrezikut. Mësimet

më të mira për sigurinë mund të vijnë nga aktivistët e tjerë, nga përvojat e tyre të përditshme dhe taktikat dhe strategjitë që zhvillojnë. Ndajeni informacionin tuaj me gra të tjera aktiviste.

Në Afganistan, për shembull, gratë aktiviste po krijojnë aleanca krahinore me qëllim që gratë që ndjehen të rrezikuara të mund të strehohen në një pjesë tjetër të vendit dhe të punojnë atje derisa të ulet rreziku që u kanoset.

Tek seksioni Burime Shtesë renditen disa udhëzime për sigurinë, për organizatat e grave dhe aktivistet.

Krijoni një koalicion

Organizatave e shoqërisë civile bëhen më të fuqishme kur flasin njëzëri. Në shumë vende, këto organizata krijojnë koalicione për të punuar për një kauzë të përbashkët. Secila prej organizatave vazhdon të ketë identitetin e vet dhe mund të organizojë aktivitete jashtë koalicionit, por si grup ato punojnë bashkërisht për të arritur synime specifike.

Të folurit në emër të koalicionit tregon se reforma mbështetet nga një gamë e gjerë grupesh të shoqërisë dhe ju bën të mundur të paraqisni një mesazh koherent.

Koalicionet e kanë fuqinë tek numrat dhe mund të ndihmojnë në mbrojtjen si të individëve, ashtu edhe të organizatave individuale të shoqërisë civile.

Koalicionet e shoqërisë civile të përqendruara tek gratë dhe siguria mund të përfshijnë:

- Organizata të grave;
- Organizata që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës (si strehëza, këshillim ligjor);
- Organizata të të drejtave të njeriut;
- Gra aktive in organizata me bazë fetare;
- Drejtuese dhe prijëse fisnore;
- Institute kërkimore apo institute politikash që merren me çështje të sigurisë apo drejtësisë penale;
- Individë që punojnë me çështjet e sigurisë në universitete;
- Shoqata profesionale, si për shembull: gratë juriste;
- Grupe studentore;
- Gazetarë; dhe
- Burra që mbështesin kauzën tuaj.

Mund të jetë e dobishme të krijohet një hartë për të evidentuar grupet në komunitetin tuaj që mund të jenë të interesuara për t'u përfshirë në koalicionin tuaj. Instrumenti nr. 7 në Seksionin 3 është një shembull i kësaj. Instrumenti nr. 8 është një model ftese për t'iu bashkuar një koalicioni, ndërsa Instrumenti nr. 9 është një model i një rendi dite për mbledhjen e parë të një koalicioni.

Përqendrohuni tek evidentimi i grupeve të ndryshme, në mënyrë që koalicioni të jetë sa më gjithëpërfshirës që të jetë e mundur. Mbani parasysh—nuk është e thënë që të bini dakord për gjithçka, por vetëm për çështjet për të cilat po bëni avokaci. Sa më i shumëllojshëm të jetë koalicioni, aq më shumë njerëz duket se përfaqësoni, dhe aq më të fuqishme do të jeni.

Në shumë vende mund të jetë e vështirë që organizatat e shoqërisë civile të angazhohen drejtpërdrejt në çështje të sigurisë kombëtare për shkak të një mjedisi politik të mbyllur, madje edhe armiqësor. Pjesëmarrja në diskutime që kanë të bëjnë me sigurinë në nivel rajonal apo ndërkombëtar mund të ushtrojë trysni tek politikë-bërësit në nivel kombëtar. Pjesëmarrja në rrjete me organizata të tjera të shoqërisë civile me përvojë në reformën e sektorit të sigurisë mund t'ju vijë në ndihmë për ngritjen e kapaciteteve tuaja. Për më tepër, edhe anëtarësimi në rrjete rajonale dhe ndërkombëtare grash mund t'ju shtojë besueshmërinë.

Koalicioni juaj mund të mos kufizohet vetëm brenda organizatave të tjera të shoqërisë civile. Për shembull, mund të ftoni gra ushtarake, gra police apo deputete për të diskutuar mbi çështje të sigurisë, për të krijuar një program të përbashkët dhe për të përcaktuar strategjitë për hapat që do të ndërmerren për të garantuar përfshirjen e këndvështrimit të grave në politikë-bërje.

Sugjerime për ndërtimin e koalicioneve

- Përcaktoni synimet dhe objektivat e përbashkëta për koalicionin tuaj. Koalicioni bëhet më i fortë kur ekziston një qëllim i qartë, i shkruar.
- Përcaktoni rregullat sipas të cilave do të funksionojë koalicioni: Si merren vendimet brenda koalicionit? Kush është (janë) zëdhënës(i)t?
- I kushtoni kohë dhe energji *procesit të diskutimeve*, marrëveshjeve mbi objektivat dhe planifikimit të veprimeve brenda koalicionit.
- Krijoni kanale komunikimi për anëtarët e koalicionit duke hartuar një listë email-esh, mbajtjes së mbledhjeve të rregullta, etj.
- Mos iu shmangni çështjeve të vështira apo pengesave të mundshme—bëjini ato pjesë të programeve dhe diskutojini.
- Planifikoni aktivitete të cilat do të bashkonin anëtarët e koalicionit si shikimi i një videoje apo mbledhja e firmave për një petition.

«Bashkimi bën fuqinë. Nëse jeni shumë zëra bashkë, do t'ju dëgjojnë. Por po të flisni vetëm...askush nuk do t'ju veshin».

Mary Justo Tombe, Solidariteti Jugor i grave për paqe dhe zhvillim në Sudanin Jugor

- Informoni të gjithë anëtarët për ecurinë dhe ndryshimet e politikave. Kjo do të ndihmonte në krijimin e marrëdhënieve pozitive në të ardhmen, si edhe në ruajtjen e tyre.

Plani i veprimit

Mënyra më e mirë për ta fokusuar dhe organizuar punën e koalicionit tuaj është hartimi i një plani veprimi. Ky plan do të kërkojë një farë kohe, dhe ndofta do t'ju duhet të caktoni një apo dy ditë të plota ku të gjithë anëtarët e koalicionit të punojnë së bashku. Ndofta mund të duket sikur po shpenzoni shumë kohë thjesht duke folur, por kjo do t'ju vërë ju në rrugën e duhur – së bashku.

Është me rëndësi të veçantë që objektivat e koalicionit tuaj të jenë të arsyeshme, realiste dhe të arritshme. Gjatë hartimit të planit të veprimit, merrni parasysh sa kohë ka mundësi të shpenzohet secila për këtë punë, si edhe aftësitë dhe dijet që ajo sjell.

Çfarë duhet të përfshihet në planin tuaj të veprimit

Plani juaj i veprimit duhet të përfshijë gjashtë elementët e mëposhtëm:

Synimin: Ky është rezultati i përgjithshëm që dëshironi të shihni, ose misioni i koalicionit i shprehur në një fjali të vetme. Mos ngurroni ta bëni synimin ambicioz dhe të gjerë. Ai duhet të jetë i orientuar nga veprimi dhe të përqendrohet tek ndryshimi. Për shembull, “Synimi ynë është që shërbimi policor të jetë i gatshëm dhe i aftë të plotësojë nevojat e grave, burrave, vajzave dhe djemve”.

Objektivat: Këto janë qasjet me anë të të cilave do të arrihet synimi. Bëjini objektivat tuaj sa më specifikë, konkretë dhe të matshëm. Ndajeni problemin në elementët e vet të ndryshëm. Për shembull: “Ndërtim i kapaciteteve të oficerëve të policisë për të njohur dhe plotësuar nevojat specifike të sigurisë së grave, burrave, vajzave dhe djemve”.

Veprimtaritë: këto janë gjërat që do të bëjë koalicioni për të arritur çdo objektiv dhe për të kontribuar në arritjen e synimit të përgjithshëm. Veprimtaritë tuaja mund të përfshijnë peticione, protesta, takime me komunitetin, seminare, fushata me postera, takime me hartuesit e politikave, trajnime apo programe radiofonike. Për objektivin e mësipërm, një aktivitet mund të ishte: “Trajnimi i oficerëve të lartë të policisë në akademinë

Kurrë mos e vini në dyshim nëse një grup i vogël qytetarësh mendimtarë e të përkushtuar mund ta ndryshojnë botën apo jo; në fakt kjo është e vetmja gjë që e ka ndryshuar atë.

✂ Margaret Mead, antropologe, SHBA

kombëtare të policisë për nevojat specifike të sigurisë së grave, burrave, vajzave dhe djemve”.

Mendoni për auditorin tuaj, për njerëzit që doni me doemos t’i dëgjojnë ato çka keni për t’u thënë. Auditori mund të jetë çdo aktor i sektorit të sigurisë (shihni listën në Seksioni 1), media, publiku i gjerë, kushdo që ju mendoni se mund të sjellë ndryshimin që ju doni të shihni.

Identifikoni partnerë apo aleatë potencialë që mund të ofrojnë këshilla, mund t’ju ndihmojnë të përhapni mesazhin tuaj, mund t’ju financojnë, apo të punojnë me ju. Planifikoni kohë për tu takuar me ta.

Gjatë planifikimit të secilës veprimtari mendoni për gjërat që mund ta pengonin suksesin e saj. Planifikoni si t’i shmangni këto probleme. Për shembull nëse veprimtaria që keni propozuar është “Trajnimi i zyrtarëve të lartë të policisë . . .” ekziston rreziku që zyrtarët e lartë të policisë të mos bien dakord për t’u trajnuar. Ndaj si pjesë e veprimtarisë mund të jetë që të takoheni me shefin e policisë dhe ta bindni atë se punonjësit e policisë duhet të marrin pjesë në trajnim.

Përgjegjësitë: Plani juaj i veprimit duhet të përcaktojë se “kush” do të bëjë “çfarë” dhe “kur”. Kjo i ndihmon të gjithë në koalicion të dinë se çfarë kanë rënë dakord të bëjnë.

Përcaktoni afatet e veprimtarive - jo vetëm veprimtarinë, por edhe përgatitjen dhe punën pasuese që kërkohet. Mendoni për data të rëndësishme (si zgjedhjet). Mendoni nëse ka veprimtari që duhet të organizohen përpara të tjerave. Përcaktoni afate dhe etapa. Për shembull, një afat mund të jetë kryerja e trajnimit të parë me policët deri në mesin e vitit.

Burimet: bëni një përlllogaritje të burimeve njerëzore, financiare dhe burimeve të tjera që ju nevojiten për çdo pjesë të veprimtarisë brenda planit të veprimit. Burimet njerëzore përfshijnë kohën që shpenzohet për një aktivitet të caktuar dhe kohën e shpenzuar për përgatitje dhe planifikim. Në kostot financiare mund të përfshihen telefonatat, transporti dhe qiraja e ambienteve. Ndër burimet e tjera përfshihen pajisjet dhe mjetet e transportit.

Plani juaj i veprimit mund të përfshijë veprimtari për të siguruar më shumë burime, si mbledhje fondesh dhe kërkimi i ndihmës nga organizata të tjera të shoqërisë civile.

Monitorimi dhe vlerësimi: Mendoni sesi do të monitoroni përparimin dhe vlerësoni ndikimin e veprimtarive tuaja. Kjo përmasë e avokacisë shpesh lihet pas dore, por në rast se nuk e bëni, atëherë si do ta kuptoni nëse përpjekjet tuaja po ju afrojnë drejt realizimit të synimit? Kjo shërben gjithashtu për të motivuar të gjithë personat e përfshirë në koalicionin tuaj për të parë përparimin dhe ndryshimin që po sillni.

Monitorimi vlerëson përparimin e bërë në zbatimin e planit të veprimit:

- Nëse veprimtaritë janë kryer sipas planit;
- Nëse buxheti është shpenzuar sipas planit;
- Nëse ka pasur përparim në plotësimin e synimeve të përcaktuara; dhe
- Çfarë ndryshimesh duhen bërë për të siguruar suksesin.

Ju duhet të bëni monitorim të vazhdueshëm. Për shembull, organizoni një mbledhje të koalicionit një herë në dy muaj, për të diskutuar gjendjen e planit të veprimit.

Vlerësimi është reflektimi që bëni për punën e bërë dhe për të parë çfarë ndryshimi ka sjellë. Për shembull, ta zëmë se gjatë hulumtimeve paraprake konstatuat se policia nuk reagoonte siç duhet ndaj nevojave specifike të sigurisë për gratë. Pas kësaj ju ndihmuat në hartimin dhe zbatimin e programeve të reja të trajnimit për punonjësit e policisë. Tani ju mund ta përsërisni hulumtimin tuaj, për të parë nëse ka përmirësim të reagimit nga ana e punonjësve të policisë.

Ju mund të shihni një listë pyetjesh që mund t’i bëni gjatë planifikimit të veprimeve (Instrumenti nr. 10), një model plani veprimi (Instrumenti nr. 11) dhe një shembull plani veprimi nga një organizatë e grave e shoqërisë civile në Liberi (Instrumenti nr. 12), Seksioni 3.

Si ta bëjmë planin e veprimit?


Përpiqui të përfshini të gjithë anëtarët e koalicionit në planin tuaj të veprimit dhe të organizoni konsultime me një rrjet sa më të gjerë individësh. Bërja e procesit gjithëpërfshirës do ta forcojë atë. Krijimi i hapësirës për debate të gjalla për planin, do ta shtojë përkushtimin e pjesëmarrësve për të.

Pikë së pari, bini dakord për procesin e përpilimit të planit

të veprimt. A janë të gjitha palët e përfshira në konsultime të pranishme në sallë/auditor? Në rast se “jo”, “si” dhe “kur” do të organizohet procesi i konsultimit me ta? Bini dakord se “sa shpesh” dhe “kur” do të rishikohet plani i punës.

Puna juaj kërkimore dhe hulumtimet mund të kenë nxjerrë në pah një listë shteruese të problemeve të sigurisë. Ju duhet ta përmbledhni këtë listë në një grup të menaxhueshëm çështjesh. Përpikuni të zgjidhni ato çështje për të cilat puna hulumtuese ju ka dhënë materiale të reja për t’ua sjellë në vëmendje hartuesve të politikave, si dhe ato ku mendoni se ka mundësi për të arritur ndryshim.

Ekzistojnë instrumente nga më të ndryshmet që ju ndihmojnë të përcaktoni përparësitë dhe të organizoni idetë tuaja, të tilla si: analiza SWOT (Pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet), analiza dhe skema të aktorëve të interesuar. Tek Burimet Shtesë jepen udhëzues për këto dhe instrumente të tjera planifikimi. Seksioni 3 përmban një model rendi dite për një seminar për planifikimin e veprimeve (Instrumenti nr. 13) dhe një ushtrim të thjeshtë në grup për përcaktimin e përparësive (Instrumenti nr. 14).

 *Hartoni planin tuaj të veprimt, ndaloni, dhe pastaj bëni një rivlerësim të gjërave që janë të mundshme. Çfarë mund të shkurtrohet? Cilat janë përparësitë? Çfarë mund të shtyhet për një fazë më të vonshme?*

Hartoni rekomandime

Për të arritur ndryshimin, duhet jo vetëm të shihni ku janë problemet, por edhe t’ua paraqisni zgjidhje njerëzve që mund t’i zgjidhni ato. Zgjidhjet tuaja mund të paraqiten si rekomandime për veprim. Këto rekomandime do të bazohen tek hulumtimet dhe puna kërkimore që keni bërë për çështjet e sigurisë, si edhe idetë e gjeneruara nga koalicioni juaj.

Më poshtë janë pesë hapa për hartimin e rekomandimeve:

1. ANALIZONI PROBLEMIN: hapi i parë është të menduarit kritik për problemin. Cilat janë pengesat dhe sfidat ekzistuese? Nga se lindi problemi? Në rast se situata ka ndryshuar, pse ka ndryshuar?

Shembull: Grave viktimat të dhunës në familje nuk po u jepet ndihmë. Ato nuk shkojnë në polici, sepse punonjësit e policisë (meshkuj) nuk do t’ua vënë veshin. Në disa vende ku janë ngritur njësitë e reagimit në familje dhe ku janë punësuar gra police, gjërat funksionojnë më mirë. Por gjithsesi mbetet e vështirë zgjimi i interesit të grave për të hyrë në forcën policore, sepse ato nuk dinë shumë për të dhe komunitetet e tyre me gjasë do të jenë kundër një gjëje të tillë.

2. RRIHNI MENDIME PËR TË GJETUR ZGJIDHJE: Pas analizimit të problemit, mendoni se cilat gjërat që mund ta ndryshonin situatën. Jini krijues. Përcaktoni problemin në vija të përgjithshme për t’u përqendruar tek zgjidhjet e propozuara.

Shembull: në rast se do të kishte më shumë gra punonjëse policie, në veçanti më shumë njësi të reagimit në familje, gratë viktimat të dhunës në familje do të përfitonin shërbime më të mira. Për tu siguruar që të ketë gra punonjëse policie në të gjitha rajonet e policisë në mbarë vendin, do të na duhej që së paku 10 për qind e punonjësve të policisë të ishin gra. Për të pasur më shumë gra punonjëse policie, ne mund tu tregojmë atyre, familjeve të tyre, si edhe komuniteteve ku ato jetojnë, që kjo është një punë e respektuar. Gratë punonjëse të policisë mund të flasin me gra të tjera dhe ne mund të flasim me drejtues të komunitetit.

3. IDENTIFIKONI SE KUSH MUND TA SJELLË NDRYSHIMIN: Përcaktoni se kush mund t’i ndërmarrë veprimet që nevojiten – kuptohet se nuk mund t’i kërkohet dikujt të bëjë diçka, që ai apo ajo nuk e ka autoritetin ta bëjë. Evidentimi i institucioneve, organizatave apo personave të duhur kërkon punë dhe hulumtim.

Shembull: Ministria e Brendshme menaxhon rekrutimet në polici, që është nën kontrollin e qeverisë. Një mision ndërkombëtar, EUPOL-i, ndihmon për financimin e rekrutimit të punonjësve të policisë.

4. HARTONI REKOMANDIME: Hartoni rekomandime për institucione, organizata, apo individë të caktuar që të kryejnë veprime specifike. Përfshini veprime që do t’ju bëjnë të mundur monitorimin e hapave të ndëmarra dhe ndikimin e tyre.

Shembull: Pushteti qendror duhet të zgjerojë strategjitë për rekrutimin e grave në sektorin e sigurisë. Në mënyrë të posaçme, Ministria e Brendshme dhe EUPOL-i duhet të përqendrohen tek rekrutimi i grave në radhët e policisë, duke u fokusuar tek gratë e veja dhe viktimat e luftës. Kjo mund të arrihet përmes:

- Organizimit të takimeve të hapura ku gratë punonjëse të policisë të mund të ndajnë përvojat e tyre me gratë e interesuara kandidatë;
- Kryerjes së fushatave të edukimit në shkollat e mesme dhe kolegje;
- Krijimit të fushatave të posaçme të rekrutimit që fokusohen tek gratë që nuk janë pranuar në universitete;
- Futja e konceptit më të gjerë të punës policore në komunitet, duke e vënë theksin tek sukseset e njëjësive të reagimit në familje;
- Caktimi i një kuote prej të paktën 10 për qind për gra rekrute në polici; dhe

- *Përfshirja e drejtuesve fetare dhe këshillave vendore për t'i dhënë legjitimitet përpjekjeve për rekrutim.*

Ky grup rekomandimesh u hartua nga një grup grash drejtuese afgane të mbledhura nga Instituti për Siguri Përfshirëse në janar të vitit 2008. Është një listë e mirë, sepse u drejtohet qartazi aktorëve specifikë (Ministritë së Brendshme dhe EUPOL-it) dhe paraqet objektiva konkrete (një kuotë prej së paku 10 për qind për gratë rekrute), si edhe disa zgjidhje.

Për të përmirësuar transparencën dhe për të mundësuar monitorimin, mund të shtoni: “Ministria e Brendshme duhet të përfshijë në faqen e saj të internetit raporte vjetore të strategjive për rekrutimin e grave në sektorin e sigurisë dhe se çfarë përqindjeje zënë gratë rekrute në sektorin e sigurisë dhe numrin e përgjithshëm të personelit”.

5. **VËRINI REKOMANDIMET NË PROVË:** Diskutojini rekomandimet që keni propozuar në mënyrë informale me personat që ndikohen nga problemi që po përpiqeni të trajtoni dhe personat në institucionet për të cilat janë dhënë rekomandimet. Kontrolloni që rekomandimet tuaja tu përgjigjen nevojave të komunitetit dhe që ato të jenë të zbatueshme.

Në Seksionin 3 do të gjeni një fletë pune për përpilimin e rekomandimeve (Instrumenti nr. 15), lidhje interneti për disa shembuj të tjerë rekomandimesh (Instrumenti nr. 16) dhe një model për paraqitjen e rekomandimeve (Instrumenti nr. 17).

Bëni avokaci për ndryshim!

Tani që e keni strategjinë dhe rekomandimet, vazhdoni përpara! Strategjia mund të përfshijë veprimtari avokacie drejtuar individëve dhe institucioneve të veçanta, mobilizimin e publikut dhe angazhimin e mediave. Ju duhet t'i përcillni mesazhet tuaja kryesore tek audiencat që keni identifikuar në strategjinë tuaj.

Më poshtë ofrojmë këshilla se si të punohet me disa audiencat të caktuara dhe disa rregulla të përgjithshme që do t'ju ndihmojnë t'i përcillni me efektivitet mesazhet tuaja.

- **NIJHENI AUDITORIN TUAJ:** Nëse keni planifikuar të organizoni një takim, mësoni sa më shumë që të mundeni për personat me të cilët do të takoheni—cilat janë përgjegjësitet e tyre, cili është autoriteti i tyre, çfarë pune kanë bërë për këtë problem? Në rast se do të organizoni një takim me komunitetin, mësoni paraprakisht mbi çështjet që përbëjnë shqetësim për ta. Çfarë dinë ata? Përse do të duan të përfshihen?

- **TREGONI BESIM:** Dini si të prezantoheni në mënyrë të tillë që ata të dinë përse duhet t'ju dëgjojnë (dhe nëse përfaqësoni gra të tjera, i përmendni edhe ato). Bëni prova për gjërat që do të thoni.

- **JINI KONCIZ:** Tërhiqni vëmendjen e auditorit, paraqisni argumentet tuaja dhe largohuni duke i lënë njerëzve një ide të qartë se çfarë kërkoni. Përfshini tri pika në mesazhet tuaja: problemin, zgjidhjen dhe veprimet e rekomanduara. Instrumentet nr. 21 dhe 22 në Seksionin 3 paraqesin disa çështje diskutimi për sigurinë si dhe disa përgjigje për disa argumente që përdoren rëndom kundër përfshirjes së grave në siguri.

- **JINI KONSTRUKTIVË:** përcaktojeni qartë problemin që ju shqetëson, por përqendrohuni tek zgjidhjet.

- **JINI BINDËS:** ju doni që auditori të jetë i interesuar dhe të mbajë mend ato që i thoni. Përgatitni një tregim të shkurtër për të ilustruar dhe për t'i dhënë jetë argumentit tuaj. Tregojuni atyre sesi bota do të ishte ndryshe po të zbatohen rekomandimet tuaja. Nëse mundeni, jepni dy-tri statistika që mbahen mend lehtë.


- **DËGJONI:** jepini mundësi auditorit të bashkëbisedojë me ju – u jepni njerëzve mundësi të bëjnë pyetje, jepni shembuj nga përvoja dhe sipas rastit bini dakord ose kundërshtojini ato.

- **KËRKONI GJËRA KONKRETE:** Duhet të dini me saktësi gjënë apo gjërat specifike kërkoni të bëjë dëgjuesi. Për shembull:

— në rast se po flisni me një politikan: «Ne duam nga ju që të votoni për një buxhet të dedikuar për financimin e përfshirjes së grave nga shoqëria civile në procesin e reformës së sektorit të sigurisë».

— nëse flisni me pjesëtarët e komunitetit: «do të donim nga secili prej jush që të mblidhni 50 firma për peticionin tonë për sigurimin e përfshirjes së grave në procesin e reformës së sektorit të sigurisë».

- **KUR TAKIMIT PO I VJEN FUNDI, GJENI NJË MËNYRË QË MARRËDHËNIA TË VAZHDOJË:** Për shembull: Me kë mund të mbajmë kontakt nga zyra juaj? A mund ta lëmë takohemi sërish dhe t'ju raportojmë mbi ecurinë tonë? A e lëmë takimin që sot, përpara se të largohem, për herën tjetër? A mund të na mbani të informuar për hapat e mëtejshëm?

 *Përdorni titujt zyrtarë dhe rangjet e sakta të politikanëve dhe zyrtarëve të sigurisë. Mos ngurroni të pyesni asistentet apo sekretaret e tyre për mënyrën e saktë se si duhet tu drejtoheni, ose mund t'i pyesni drejtpërsëdrejti: “Si mund t'ju drejtohem?”. Për shembull, kur i shkruani një letër një ministri të kabinetit qeveritar apo një deputeti, në shumë vende përpara emrit shkruhet “I Nderuari Zoti”.*

Përcaktoni se kujt po drejtoheni

Më poshtë vijojnë disa ide se si të angazhoheni me audienca të caktuara që mund të jenë pjesë e strategjisë suaj, si edhe disa sugjerime mbi llojet e mesazheve që mund të doni të parashtroni.

Ministrat e kabinetit qeveritar dhe ministritë/departamentet e tyre

Me kë të kontaktoni?


- Sidomos nëse jetoni në kryeqytet, qeveria (krahinore ose kombëtare) ka gjasa të jetë një objekt i rëndësishëm në procesin tuaj të avokacisë. Ju takon juve të përcaktoni se cilat ministri janë relevante për çështjet tuaja. Mos harroni që ministria përgjegjëse për çështjet e grave mund të jetë aleate e juaja.
- Ndoshta mund t'ju duhet të kontaktoni me kreun e ministrisë dhe të flisni për çështjen tuaj me vetë ministrin apo ministren, por në fillim do t'ju duhet të identifikoni zyrën përkatëse dhe drejtorët përgjegjës që punojnë me çështjet që doni të trajtoni.
- Në disa vende, sidomos ato në tranzicion nga konfliktet, mund të ketë një proces ekzistues zyrtar të reformës në sektorin e sigurisë. Në rast të tillë, gjeni se cilat janë organet e ngritura për menaxhimin e reformës së sektorit të sigurisë. Ky mund të jetë një komision parlamentar apo një grup deputetësh dhe përfaqësuesish të ministrive dhe institucioneve të sektorit të sigurisë. Ka shumë gjasa të mos ketë pasur përpjekje për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile, ndaj do t'ju duhet të luftoni për ta bërë zërin tuaj të dëgjohet.

Si të kontaktoni me ta?

- Ndofta mund të duhen disa telefonata apo takime, si edhe një farë kohe për të kuptuar se cilët janë personat e duhur në drejtoritë përkatëse të ministrive. Kontaktet informale mund t'ju ndihmojnë të konstatooni se më kë keni të bëni dhe të lini takime me ta. Disa ministri kanë një person kontakti për marrëdhëniet me komunitetin. Mund të ketë dhe një rrjet formal apo informal personeli femëror.
- Pas kësaj mund të kërkoni një takim për të paraqitur punën tuaj kërkimore apo të kërkoni të flisni në emër të koalicionit tuaj. Në rast se një nga pjesëtarët e koalicionit tuaj është nga zona zgjedhore e politikantit (nga zona që ai përfaqëson), mund të jetë më e lehtë që ai/ajo të rregullojë një takim. Instrumenti nr. 18 në Seksionin 3 jep një shembull letre që i drejtohet një zyrtari të lartë të sigurisë.

Çfarë të thoni?

- Ato që thoni do të reflektojnë problemet që ju shqetësojnë dhe planin e veprimit dhe rekomandimet që ka hartuar koalicioni juaj. Më poshtë paraqiten disa qasje që mund të jenë të dobishme për një organizatë të grave:
 - vëreni theksin tek lidhjet dhe njohjet që ju keni me bazën/terrenin—mund t'u thoni politikë-bërësve mendimet e vërteta të banorëve të komuniteteve.
 - shpjegoni sesi përfshirja e grave do t'i bëjë proceset më efikase.
 - lidhni çështjet e sigurisë që ju shqetësojnë me standardet rajonale apo ndërkombëtare që konsiderohen si të rëndësishme në vendin tuaj. Shihni listën e normave dhe standardeve ndërkombëtare që paraqiten në Instrumentin nr. 6 në Seksionin 3. Për shembull mund të thoni që: “UNSCR 1325 kërkon përfaqësim në rritje të grave në mekanizmat që parandalojnë, zgjidhin dhe menaxhojnë konfliktin. Për të përmbushur këtë detyrim, ne kërkojmë që të përfshini një përfaqësuese nga Ministria për Çështjet e Grave dhe një përfaqësuese të organizatave të grave nga shoqëria civile në Grupin e Punës së reformës në sektorin e sigurisë”.
 - Insistoni për konsultime të vazhdueshme dhe të rregullta midis qeverisë dhe shoqërisë civile për çështje të sigurisë. Këto konsultime duhet të jenë publike, të hapura për pjesëmarrje të gjerë, dhe të kenë strategji të qarta të vazhdimësisë. Në veçanti, në rast të një procesi zyrtar të reformës në sektorin e sigurisë apo të hartimit të politikave të sigurisë kombëtare, ushtroni presion ndaj personave përgjegjës që të përfshijnë konsultime publike, duke përfshirë edhe konsultimet me gra nga pjesë të ndryshme të vendit dhe nga komunitete të ndryshme. Shih shembullin nr. 5: shoqëria civile e Liberisë (grupi i punës për reformën në sektorin e sigurisë).

 *Kujdes: Bëni kujdes që fjalët tuaja të mos i zënë politikanët dhe zyrtarët në befasi në publik. Denoncimi i punës së dobët është një nga strategjitë e avokacisë, por me shumë gjasë do të jetë shumë e vështirë që të punohet në të ardhmen me figura publike që janë ndjerë të fyer apo turpëruar.*

Gratë anembanë Bregut të Fildishtë mbledhen për të festuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas në Pallatin e Kulturës të Abixhanit.

Fotografia nga: Kombet e Bashkuara / Ky Chung





SHEMBULLI NR. 5: GRUPI I PUNËS NGA SHOQËRIA CIVILE PËR REFORMËN NË SEKTORIN E SIGURISË, LIBERI

Në vitin 2006, Shoqata Kombëtare e Liberisë për Zbatimin e Ligjit dhe Rendit ndihmoi në krijimin e Grupit të Punës të Shoqërisë Civile për Reformën e Sektorit të Sigurisë. Gati 10 organizata të shoqërisë civile u bashkuan për të monitoruar procesin e reformës së sektorit të sigurisë, për të ofruar opsione alternative politikash dhe për të angazhuar dhe përfshirë qeverinë në çështjet që kishin të bënin me SSR-në, duke përfshirë çështjet gjinore.

Ngritja e grupit të punës rriti dukshmërinë e përbashkët të organizatave të shoqërisë civile dhe çoi në një ftesë nga Komisioni i Qeverisjes për të marrë pjesë në hartimin e strategjisë kombëtare të sigurisë për Liberinë. Shtylla e “paqes dhe sigurisë” e Komisionit Liberian për Rindërtim dhe Zhvillim e ftoi grupin të merrte pjesë në takimet e tij dhe në proceset e vendim-marrjes dhe të diskutimeve.

Burimi: Miranda Gaanderse, Siguri për të gjithë: praktikat e mira të Afrikës perëndimore për çështjet gjinore në sektorin e sigurisë (Gjenevë: DCAF, 2010), 24.

Deputetët në Parlament

Me kë të kontaktoni?

- Komisionet parlamentare që kanë detyrën e mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë mund të jenë objektiva të rëndësishme për avokacinë. Mund të ketë edhe grupe të tjera parlamentare që merren me çështje që lidhen me punën tuaj. Për shembull në parlamentin skocez ka një grup debati për “dhunën e meshkujve ndaj grave dhe fëmijëve”.
- Gratë parlamentare mund të jenë gjithashtu partnere shumë të rëndësishme, sidomos në rastet kur ekziston një grup grash parlamentare. Kërkoni bashkëpunim me komisione për çështjet e grave që mbulojnë edhe çështjet e sigurisë. Deputetët meshkuj që mbështesin pjesëmarrjen e grave mund të jenë gjithashtu aleatët tuaj.

Si të kontaktoni me ta?

- Një deputet mund të ketë orare dhe vende të caktuara pritjeje për popullin. Ose mund ta ftoni deputetin apo një komision parlamentar të takohet me koalicionin tuaj. Në rast se do t'ua paraqisni takimin si një mundësi e mirë për ta për të krijuar një marrëdhënie mbështetjeje të ndërsjellë dhe për të dalë në dritë pozitive përpara publikut (d.m.th. të takohen me njerëzit, t'i dëgjojnë ata), do të ketë më shumë gjasa që ata të vijnë. Mund të jetë më e lehtë të lihet një takim me një deputet nëse kërkesa vjen nga dikush që është nga rrethi apo zona e tij/saj zgjedhore. Përsëri, edhe

rrjetet informale në koalicionin tuaj mund të jenë të dobishme.

- Shikoni mundësitë për konsultime formale për çështjet e sigurisë, si për shembull kur bëhet fjalë për hartimin e një legjislacioni të ri. Organizatat e shoqërisë civile mund t'i paraqesin mendimet dhe qëndrimet e tyre me shkrim apo me gojë. Në parlament duhet të ketë një sekretariat ku mund të merrni informacion se kur do të diskutohen çështje të caktuara. Disa organizata të shoqërisë civile apo koalicione kanë ndonjë punonjës të tyre ose vullnetar, puna e të cilit përfshin monitorimin e procedurave parlamentare. Në rast se parlamenti juaj nuk ofron të tilla shërbime dhe ju nuk i keni të tilla kapacitete, përpiquni të gjeni një deputet apo dikë nga stafi i deputetit t'ju mbështesë dhe t'ju japë informacion.

Çfarë duhet të thoni?

- Ju mund t'i ndihmoni parlamentarët të formulojnë pyetje që mund t'i bëjnë gjatë seancave parlamentare apo të merrni pjesë në debatet që lidhen me sigurinë. Kjo do të ndihmonte që çështja juaj të merrte vëmendje në parlament dhe në media. Mund t'u propozoni tema për interpelanca në komisione parlamentare apo për një hetim parlamentar të veçantë, dhe mund t'u jepni lista të grave eksperte për të dëshmuar. Ose mund të ketë edhe ndonjë ligj specifik që doni prej tyre ta propozojnë, ta mbështesin, apo kundërshtojnë.
- Ju mund të ofroni të bëni punë kërkimore të cilën deputeti mund ta paraqesë në parlament apo përpara një komisioni.

Institucionet e sektorit të sigurisë

Me kë të kontaktoni?

- Të gjithë personat apo institucionet në vijim mund të shërbejnë si pika të mira kontakti: një punonjës përgjegjës për marrëdhëniet me komunitetin; rajonet e policisë për gratë; njësitë e dhunës në familje/njësi mbështetëse; komisionet vendore apo në rang rrethi për sigurinë e komunitetit; pikat e brendshme të kontaktit për çështjet gjinore ose mundësitë e barabarta; ose një rrjet grash, si për shembull Rrjeti i grave punonjëse të policisë.¹⁹
- Mund të kontaktoni drejtpërdrejt me zyrtarin e lartë në zyrën e zonës suaj -komandantin e një njësie ushtarake, shefin e policisë, ose një gjyqtar.
- Ndonjëherë gazetatat identifikojnë një person nga institucionet e sektorit të sigurisë, i cili është i hapur ndaj çështjeve për të cilat po bëni avokaci.

Si të kontaktoni me ta?


- Mund t'u shkruani një letër ku t'u kërkonti mundësi të diskutoni shqetësimet e koalicionit tuaj, sigurohuni të keni një strategji vijuese, në mënyrë që letra juaj të marrë përgjigje. Përndryshe, edhe përdorimi i kontakteve informale mund të jetë një instrument tjetër i dobishëm; mund t'i kërkonti edhe ndonjë zyrtari të zgjedhur apo ndonjë drejtuesi vendor, fisnor apo fetar të komunitetit që lërë një takim në emrin tuaj.
- Shumë shërbime të policisë përfshijnë një proces ankesash nga populli, që është një kanal përmes të cilit mund të ngrihen probleme. (Por nëse përdorni këtë mekanizëm ekziston rreziku që t'ju shohin më shumë si kundërshtar, se sa si ndihmës).
- Në rast se këto qasje rezultojnë të pasuksesshme, përdorni qasje më publike. Përdorni radion për të kërkuar takime me autoritetet dhe informojeni publikun për rezultatin. Organizoni një protestë të ulur (sit-in) në rrugën kryesore që të çon tek zyra dhe njoftoni edhe shtypin.


Çfarë duhet të thoni?

- Gjatë kontakteve të para përqendrohuni tek krijimi i besueshmërisë për veten tuaj dhe koalicionin. Përmendni detyrën/postin që mbani ose titujt tuaj akademikë, në rast se keni të tillë. Prezantoni pjesëtarët e koalicionit dhe ata që përfaqësoni. Tregoni punën kërkimore dhe hulumtimet që keni bërë dhe përmendni emrat e autoriteteve të tjerë me të cilët jeni takuar. Jini në gatishmëri për t'iu përgjigjur pyetjeve të vështira.
- Lidhini ato që po thoni me mandatin dhe rolin e institucionit të sektorit të sigurisë me të cilin po flisni. Për shembull, kur flisni me policinë mund të jetë me vend ta vini theksin tek çështjet që kanë të bëjnë

me kriminalitetin; me zyrtarë të mbrojtjes, ushtrisë dhe drejtësisë mund të doni të theksoni aspekte të drejtësisë. Mbani parasysh që askush nga personat e lartpërmendur nuk e ndryshon dot ligjin, por ju mund tu kërkonti të garantojnë drejtësi në zbatimin e tij.

- Ju mund të keni ekspertizë për t'i ofruar trajnime personelit të sektorit të sigurisë për tema të tilla si të drejtat e njeriut, dhuna në familje, dhuna seksuale, trafikimi i qenieve njerëzore apo siguria e komunitetit. Ky mund të jetë një qëllim në vetvete, por mund të përdoret edhe si mundësi për të pasur qasje për procesin e avokacisë.

 *Ndonëse mund të jetë me dobi të përdorni terminologjinë e përdorur nga aktorët e sektorit të sigurisë, mos u shqetësoni në rast se nuk mundeni. Ju mund të mos e kuptoni terminologjinë e përdorur prej tyre, por ata me siguri e kuptojnë ato që ju po u përçoni. Instrumenti nr. 4 në Seksionin 3 është një Fjalorth që shpjegon disa prej termave teknike që mund të dëgjoni.*

 *Do të duhet të keni një informacion bazë për rangjet e ndryshme të hierarkisë institucionale për të kuptuar se kush është personi me autoritet.*

Organet mbikëqyrëse të sektorit të sigurisë

Me kë të kontaktoni?

- Organet e mbikëqyrjes mund të jenë aleatë të fuqishëm për organizatat e shoqërisë civile sepse ato kanë pushtet të posaçëm për qasje në informacion dhe për lëshimin e rekomandimeve për shërbimet qeveritare dhe ato të sigurisë.

Si të kontaktoni me to?

- Çdo agjenci mbikëqyrëse ka mënyra të ndryshme për marrjen e ankesave nga publiku. Gjeni mënyrën sesi ta trajtoni problemin me ta duke parë në faqen e tyre të internetit, duke telefonuar në zyrat e tyre apo duke shkruar në zyrat e tyre personalisht.

Çfarë duhet të thoni?

- Do t'ju duhet të mësoni se cilat janë llojet e problemeve apo ankesave me të cilat mund të merret apo trajtojë ky organ i caktuar dhe cilat institucione sigurie ka autoritetin t'i marrë në shqyrtim (juridiksioni i tyre).
- Përveç se dëgjon shqetësimet tuaja, Komisioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut mund të jetë një partner për punën kërkimore apo avokacinë. Në shumë vende, në veçanti aty ku këto organe mbikëqyrjeje janë të reja apo nuk kanë kapacitetet e nevojshme, ato nuk i kanë të qarta tiparet e veçanta të sektorit të sigurisë. Organizatat e shoqërisë civile mund t'i ndihmojnë ato ta ndërtojnë këtë ekspertizë.

Organizatat ndërkombëtare dhe rajonale edhe Misionet Paqeruajtëse

Me kë të kontaktoni?

- Organizatave ndërkombëtare mund të jenë një burim i rëndësishëm financimi dhe drejtimi për procesin e reformës në sektorin e sigurisë në vendin tuaj. Personeli ndërkombëtar mund të ofrojë trajnime dhe këshillim për zhvillimin e forcave tuaja të armatosura dhe atyre të sigurisë.

Si të kontaktoni me ta?

- Për të kontaktuar me organizatat ndërkombëtare dhe ato rajonale, përpiquni të gjeni zyrën apo përfaqësinë e tyre vendore. Kështu për shembull, në rastin e organizatës së OKB-së, kërkoni zyrën më të afërt të UN Women apo PNUD-it.²⁰ Në rastet e misioneve paqeruajtëse të OKB-së mund të ketë një këshilltar për çështjet gjinore, këshilltar për çështjet sociale, njësi të drejtave të njeriut ose të ruajtjes së rendit, ekip për marrëdhëniet me komunitetin apo mund të jetë dikush nga kontingjenti i policisë së OKB-së që mund t'ju vijë në ndihmë për t'i bërë të ditura shqetësimet tuaja.

Çfarë duhet të thoni?

- Sërish, do të jetë e nevojshme që ta lidhni atë që po thoni me mandatin e misionit apo organizatës me të cilën po flisni. Për shembull, policia e OKB-së në Burundi

ka mandatin të mbështesë ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e ekspertizës në policinë kombëtare të Burundit. Ju mund të ngrini shqetësimin për mënyrën sesi policia trajton komunitetet vendore, duke theksuar se është çështje profesionalizmi, dhe të jepni sugjerime specifike mbi mënyrat e përmirësimit të trajnimit të tyre.

Qeveritë donatore

Me kë të kontaktoni?

- Vendet që janë donatore të qeverive tuaja mund të jenë të rëndësishme në procesin e financimit dhe drejtimit të reformës në sektorin e sigurisë. Ato mund të ushtrojnë edhe trysni mbi qeveritë tuaja për trajtimin e çështjeve specifike.

Si të kontaktoni me to?

- Shtetet e huaja që mbështesin iniciativën të ndryshme në vendin tuaj zakonisht përfaqësohen përmes një ambasade apo zyrës së bashkëpunimit tregtar në kryeqytet. Ka raste kur ambasada mund të jetë në një shtet tjetër në rajonin tuaj, gjë që e bën kontaktin me të më të vështirë. Ambasadori është zyrtari më i lartë i ambasadës, por gjasat janë që kontaktet e para t'i keni me sekretarin politik ose atasheun ushtarak.

Çfarë duhet të thoni?

- Në rast se do të flisni me një punonjës të ambasadës, pyeteni për llojet e aktiviteteve apo shërbimeve që

SHEMBULL NR. 6: TELENOVELAT BRAZILIANE MBËSHTESIN AVOKACINË E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Me datë 14 shtator 2003, organizatat braziliane të shoqërisë civile të drejtuara nga Viva Rio organizuan një marshim në plazhin Kopakabana, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për ndikimin e armëve të zjarrit dhe në mbështetje të një ligji të ri për rritjen e kontrollit të armëve të zjarrit. Ky mobilizim publik mori mbështetje nga burime të pazakonta, si televizioni. Në një nga telenovelat e famshme braziliane, të titulluara *Mulheres Apaixonadas* (Gra të dashuruara), tema e dhunës nga armët u prezantua kur një plumb qorr gjatë një përplasjeje midis policisë dhe një banditi qëlloi dhe vrau një nga personazhet kryesore të saj. Kjo ngjarje pati një ndikim të fortë emocional tek banorët e Rio de Zhaneiros, ku në atë kohë vdiste

mesatarisht një person çdo gjashtë ditë nga plumbat qorr. Gjatë javës që i parapriu këtij marshimi të madh, aktorë nga programi televiziv deklaruan pjesëmarrjen e tyre në marshim, dhe faktikisht morën pjesë vërtet, duke tërhequr kështu edhe shumë admirues në këtë veprimtari. Afërsisht 50 mijë njerëz morën pjesë në marshimin e quajtur "Brazil pa armë" përgjatë plazhit të Kopakabanës. Marshimi u pasqyrua në një seri tjetër të telenovelës. Filmi dhe realiteti u bënë një, duke nxitur një debat në rang kombëtar mbi kontrollin e armëve dhe duke bërë që shumë njerëz të dilnin në rrugë në mbështetje të kësaj kauze.

Burimi: Deklarata për shtyp e organizatës Viva Rio, në Eden Cole et al., *Mbikëqyrja publike e sektorit të sigurisë: Manual për organizatat e shoqërisë civile* (DCAF dhe PNUD: 2008), 85.

SHEMBULLI NR. 7: PROGRAMET RADIOFONIKE “GRATË NË SIGURI” NË SIERRA LEONE

Rrjeti i Grave për Paqe dhe Siguri në Afrikë (WIPSEN) organizoi transmetimin e disa programeve radiofonike me seri për “gratë në sektorin e sigurisë” në Sierra Leone. WIPSEN-i është një organizatë grash e shoqërisë civile, organizatë pan-afrikane, e cila nxit pjesëmarrjen e grave dhe rolin drejtues të tyre në qeverisjen e paqes dhe sigurisë. Programet u zbatuan në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale, Çështjeve Gjinore dhe të Fëmijëve dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrimin.

Programet radiofonike komunitare “Women in security hour” (Gratë në orën e sigurisë) ishin pjesë e një programi pilot gjashtëmuor, që synonte angazhimin e grave të shoqërisë civile (si edhe të personelit femëror në siguri), në nivel krahine, rrethi dhe fisi në një dialog për procesin e reformës në sektorin e sigurisë. Programet kishin si synim identifikimin e mundësive për përfshirjen aktive të grave në qeverisjen e sektorit të sigurisë, për parandalimin e konflikteve dhe ndërtimin e paqes. Programet e

transmetuan në tri komunitete kufitare: në Kambia, Pujehun dhe Kailahun. Një herë në javë, për tri javë, programet radiofonike përfshinë edhe një diskutim paneli me të ftuar të përzgjedhur nga komuniteti, pasuar nga një seancë me telefonata. Të tri programet përfshinin:

- “Çfarë është siguria?”;
- Kuadrin e sigurisë në Sierra Leone dhe pikat e mundshme të hyrjes për organizatat e grave; dhe
- Komisionet e sigurisë së grave që u trajnuan nga projekti për trajtimin e shqetësimeve të sigurisë të grave vendase.

Programet radiofonike siguruan një instrument për përfshirjen e grave në procesin e sigurisë përmes sfidave të qëndrimeve vendore ndaj sektorit të sigurisë. Ato ndihmuan në ndarjen e informacionit dhe në rritjen e dijeve mbi gjininë dhe sigurinë në nivel vendor. Për më tepër, radioja ishte një mjet i mundshëm shkëmbimesh midis organizatave të shoqërisë civile, grave, burrave dhe ekspertëve.

Burimet: Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Raporti i Progresit për DCAF-in: Nisma e posaçme për nxitjen e pjesëmarrjes së grave në komunitete në procesin e reformës së sektorit të sigurisë në Sierra Leone (IOM: 2011); Rrjeti i Grave për Paqen dhe Sigurinë në Afrikë (WIPSEN), Raporti i tremujorit të tretë: qeverisja e sektorit të sigurisë me fokus njerëzit: Iniciativa e posaçme për nxitjen e pjesëmarrjes së grave në komunitete në procesin e reformës së sektorit të sigurisë në Sierra Leone (WIPSEN: 2011), <http://www.wipsen-africa.org>.

financon vendi i tij dhe përqendrohuni aty. Për shembull, në rast se vendi me të cilin po takoheni po financon reformën në drejtësi, personeli i ambasadës do të ketë më shumë mundësi t’ju përgjigjet për problemet që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë.

- Disa vende donatore përdorin kontraktues privatë për zbatimin e aktiviteteve të reformës në sektorin e sigurisë. Për shembull kompanitë “Dyncorp” dhe “Pacific Architects and Engineers” (PAE) ofrojnë programe të “asistencës për siguri”, në emër të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.
- Në rast se flisni me një donator që po financon reformën në sektorin e sigurisë, pyeteni atë se kush përgjigjet për zbatimin e programeve. Në rast se për to përgjigjet një kontraktues privat, kërkoni të vendosni një kontakt me dikë nga kompania në fjalë, si edhe dokumente të publikuara, që flasin për mandatin e tyre.

Mediat

Me kë të kontaktoni?

- Organizatat e shoqërisë civile mund të bashkëpunojnë me median, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe avokacisë. Duhet të mbani parasysh që media ka influencë tek opinioni publik dhe rrjedhimisht tek politikë-bërësit, si politikanët dhe funksionarët e sigurisë. Gjithashtu po të dilni në një program të njohur apo në një gazetë me emër, kjo mund ta shtojë besueshmërinë tuaj si eksperte.
- Media shpesh është tejet e politizuar, sidomos në situata post-konfliktuale. Zgjidhni me kujdes partnerët e tuaj të medias.
- Përpiquni të identifikoni gazetarë nga gazetatat vendore, radiot dhe televizionet, të cilët mund të jenë të interesuar për mendimet tuaja. Lexoni tek shembulli nr. 6 sesi televizioni në Brazil ndihmoi në forcimin e kontrollit të armëve.

Si të kontaktoni me to?

- Deklarata për shtyp: deklarata për shtyp shkruhet si një raport për lajmet dhe u dërgohet sa më shumë gazetave të përshtatshme që të jetë e mundur. Deklarata nis me një fjali kryesore (pika më e fortë që keni për të thënë), vazhdon me argumente mbështetëse dhe pastaj jep informacionin sipas një rëndësie zbritëse. Instrumenti nr. 20 në Seksionin 3 është një model për hartimin e deklaratave për shtyp.
- konferenca për shtyp: për të mbajtur një konferencë për shtyp, informoni shtypin që keni për të bërë një lajmërim të rëndësishëm, në një kohë dhe vend të caktuar.
- aktivitete publike: demonstrata të mëdha, si marshime apo panairë të rrugës mund të tërheqin ndjeshëm vëmendjen e medias. Gjatë planifikimit të një aktiviteti, zgjidhni një vend të përshtatshëm pranë zyrave të gazetareve dhe njoftojini gazetarët paraprakisht. Konferencat është mirë të mbahen herët sepse gazetarët dhe reporterët i shkruajnë lajmet më vonë. Në fillim, mendoni për sigurinë tuaj. Ndofta mund t'ju duhet leje nga policia për të organizuar një demonstratë.

- Trajnimi: organizimi i trajnimeve me gazetarët u jep atyre një mundësi për të mësuar mbi temën dhe për të pasur tek të intervistuarit potencial interesant. Gjithashtu trajnimet ndihmojnë për të bërë gazetarët të kuptojnë disa nga shqetësimet tuaja.

Çfarë duhet të thoni?

- Jepuni organizatave të lajmeve informacion interesant dhe të saktë. Theksoni si lidhet ai me informacione të tjera të rëndësishme lajmesh. Për shembull, në rast se lajmet flasin për korrupsionin, ju mund të jepni një intervistë për mënyrën sesi korrupsioni ndikon tek gratë dhe burrat në komunitetet vendore.
- Shihni “Rekomandime për punën me median” tek Instrumenti nr. 19 në Seksionin 3.

Publiku

Me kë të kontaktoni?

- Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e sigurisë shpesh përfaqëson një hap të parë për debatin në publik dhe një mjet për nxitjen e ndryshimit politiko-shoqëror.

SHEMBULLI NR. 8: TEATRI/SHFAQJA SI NJË INSTRUMENT INFORMACIONI, FUQIZIMI DHE MOTIVIMI NË REPUBLIKËN DEMOKRATIKE TË KONGOS

Teatri mund të jetë një instrument efikas për përhapjen e një mesazhi dhe nxitjen e dialogut mbi tema të ndjeshme brenda një komuniteti. Ai është informal, i përshtatshëm për të gjitha moshat dhe u ofron komuniteteve mundësinë për të reflektuar bashkërisht, duke përdorur skenën si vend për të eksploruar mënyra të reja jetese dhe mundësi për ndryshim. “Search for Common Ground” (Kërko të përbashkëtat), një organizatë jo-qeveritare për transformim dhe ndërtimin e paqes, e përdor teatrin me pjesëmarrje për t'i ardhur në ndihmë zgjidhjes së konfliktit vendor në Republikën Demokratike të Kongos. Ky projekt ka nisur në vitin 2005 dhe dërgon trupa teatrale në komunitet. Trupa dëgjon, bën pyetje dhe përcakton se

cilat janë llojet e konflikteve që ekzistojnë. Aktorët bëjnë skenarin dhe e dramatizojnë konfliktin në komunitet. Po atë ditë, ata japin një shfaqje, nga fillimi në fund, përpara komunitetit në fjalë. Me përfundimin e shfaqjes, ata e luajnë shfaqjen sërish, skenë pas skene, duke ftuar pjesëtarë nga auditori të thonë se çfarë nuk ka qenë siç duhet, çfarë ka ndodhur, si mund të ishte ndryshe dhe mund të kishte parandaluar një situatë të dhunshme, duke e nxitur komunitetin të kërkojë zgjidhje alternative të problemeve. Spektatorët e teatrit me pjesëmarrje shpesh largohen jo vetëm me një tjetër ndërgjegjësim, por edhe me më shumë besim në aftësitë e tyre për ta sjellë këtë ndryshim në jetën e tyre dhe në botën që i rrethon.

Burimi: Search for Common Ground, *teatri me pjesëmarrje për transformimin e konfliktit: Manual Trajnimi* (Bakavu: Search for Common Ground, 2005), <http://www.sfcg.org/programmes/drcongo/pdf/Participatory-Theatre-Manual-EN.pdf>.

Strategjia juaj do të tregojë se cilës pjesë të publikut doni t'i drejtoheni për ta informuar. Këta mund të jenë individë që shpërndajnë informacionin në komunitetet e tyre, si për shembull: drejtues komuniteti apo fetarë, kryepleq, sipërmarrës, parti politike apo organizata të tjera të shoqërisë civile. Mund të jenë gjithashtu edhe grupe të cilët ka tendenca të mënjahohen apo anashkalohen nga politikë-bërja, të tilla si: minoritetet dhe të rinjtë. Ose ndofta mund të doni të përqendroheni posaçërisht tek gratë.

Si të kontaktoni me ta?

- Audiencia juaj do të përcaktojë edhe mënyrën sesi do të përcillet mesazhi. Mendoni organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit të publikut për shqetësimet kryesore të sigurisë. Mund të përdorni stacionet e radiove nëpër komunitete, internetin, fushatat me postera, paradat, garat dhe teatrin. Shihni shembullin nr. 7 për një projekt komunitare në Sierra Leone ku u përdorën programet e radios, si dhe shembullin nr. 8 me projektet e teatrove komunitare në Republikën Demokratike të Kongos.
- Mendoni se në cilat vende shkon grupi që keni piketuar: tregje, shkolla, stacione autobusi? Në vendet ku gratë nuk dalin shumë jashtë, krijimi i trastave të pazarit me një slogan të shkurtër tuajin të shkruar mbi to mund të jetë efektive, sepse gratë i shohin dhe i përdorin sërish.

Çfarë duhet të thoni?

- Bëjini njerëzit të kuptojnë se vendimet për sektorin e sigurisë kanë ndikim në jetën e tyre. Ata kanë të drejtën t'u plotësohen nevojat e tyre të sigurisë. Ftojini dhe fuqizojini ata që të bëhen pjesë e lëvizjes suaj për përmirësimin e gjërave.
- Fokusohuni në një aktivitet të veçantë, si java e vizitave në polici, dita e të drejtave të njeriut, ose dita ndërkombëtare e grave.

Mos harroni, avokacia është një përpjekje e planifikuar dhe e vazhdueshme për të çuar përpara programin e ndryshimit. Mos u dekurajoni nëse nuk shihni veprime të menjëhershme. Ka gjasa që t'ju duhet të provoni disa strategji të ndryshme me njerëz dhe organizata të ndryshme, dhe ndofta do tu duhet të takoheni me ta shumë herë përpara se të shihni një farë reagimi ndaj rekomandimeve tuaja. Gjenerale Kestoria Kabia nga Sierra Leone, një nga oficeret me rang më të lartë në kontinentin afrikan, i komentoi kështu negociatat me strukturën dominuese mashkullore të pushtetit: "Do t'u flas (atyre) derisa t'i bëj të bien dakord me mua!"²¹

Angazhohuni me sektorin e sigurisë

Në bazë të llojit avokacisë që kryeni, ka shumë mënyra konkrete për përfshirjen tuaj në sektorin e sigurisë në mënyrë të vazhdueshme. Më poshtë parashtrohen disa ide:

Merrni pjesë në organet zyrtare të organeve të mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë

Shoqëria civile mund të marrë pjesë në një numër organesh formale të mbikëqyrjes në sektorin e sigurisë, si bordet e shqyrtimit civil, komisionet e ankesave nga publiku dhe grupet e pavarura të monitorimit. Këto organe zakonisht mbikëqyrin policinë dhe burgjet.

Nëse mund t'i siguronit një vend rrjetit tuaj të shoqërisë civile në një organ të tillë përzgjidhni kush është gati të investojë kohë të punojë në emër të komunitetit. Përfaqësuesi juaj mund të ketë nevojë për ndihmë për përgatitjen e materialeve, studimin e çështjeve dhe për të mësuar teknika efektive për ndërhyrjen dhe negociimin.²²

Krijoni ose bashkohuni me forume vendore të sigurisë

Në shumë vende, forumet vendore të sigurisë (që ndofta mund të quhen me ndonjë emër tjetër, si borde të kontaktit me policinë, komiteti i rrethit/krahinës për çështjet e sigurisë, ose këshilli për sigurinë qytetare) funksionojnë si mekanizëm zyrtar për shkëmbimin e informacionit midis komuniteteve dhe shërbimeve të sigurisë. Merrni informacioni nga policia dhe pushteti vendor nëse këto shërbime ekzistojnë në vendin tuaj dhe nëse mund të caktoni aty një përfaqësuese nga një organizatë grash nga shoqëria civile. Në rast se jo, atëherë mendoni të krijoni vetë një forum. Shembujt nr. 9 dhe 10 janë shembuj të forumeve vendore të sigurisë që përfshijnë organizata të grave nga shoqëria civile.

Monitoroni sektorin e sigurisë

Ndoshta ju po e vëzhgoni dhe analizoni sektorin e sigurisë, por mund të mos shihni veten ende si "monitorues të të drejtave të njeriut" apo si "monitorues të sektorit sigurisë". Monitorimi është një shqyrtim i planifikuar dhe sistematik i një institucioni specifik apo çështjeje specifike që:

- kryhet gjatë një periudhe të zgjatur kohore;
- sipas një metodike transparente dhe të qëndrueshme; dhe
- përmes përdorimit të kriterëve të qarta në trajtën e detyrimeve ligjore dhe praktikave më të mira.

Procesi i monitorimit ka për qëllim të dokumentojë dhe analizojë ndikimin e veprimeve të tanishme të qeverisë dhe të sugjerojë mënyra për përmirësimin e tij. Monitorimi përfshin publikimin dhe promovimin e një raporti monitorimi që përdoret si instrument për avokacinë. Rezultatet e monitorimit i paraqiten jo vetëm qeverisë, por edhe medias dhe organeve të mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë.

Informacion mbi monitorimin mund të gjeni tek “Mbikëqyrja publike e sektorit të sigurisë: manual për organizatat e shoqërisë civile dhe monitorimi”, si edhe “Raportimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut në Afrikë: manual për aktivistët e komunitetit”, tek Burimet Shtesë.

Trajnori

Ju mund të jeni në gjendje t’u ofroni trajnime ndërgjegjësuese për çështjet gjinore apo për të drejtat e njeriut atyre degëve të institucioneve të sektorit të sigurisë që kanë më shumë gjasa të jenë në kontakt me popullatën civile (si për shembull: policia, rojat e burgjeve, rojet e kufirit dhe gjyqtarët). Po kështu, ju mund të ofroni trajnime për pjesëmarrësit në organet e monitorimit të sektorit të sigurisë, për mënyrat e monitorimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave, apo për mënyrat se si t’u mundësojnë më shumë qasje shoqërisë civile.

Ofrimi i trajnimeve është jo vetëm një mjet për përmirësimin e sjelljes së institucioneve të sektorit të sigurisë, por mund të ndihmojë gjithashtu në ndërtimin e besimit, respektit dhe të shërbejë si bazë për bashkëpunim në të ardhmen.

Më poshtë jepen disa rekomandime për trajnimin e personelit të sektorit të sigurisë:

- Bëni një vlerësim të nevojave për trajnim, me qëllim evidentimin e boshllëqeve në trajnimet ekzistuese dhe fushat për përmirësim.
- Nuk ka nevojë të shpikni gjëra nga e para: përshtatni dhe bazohuni tek materialet e trajnimit të hartuara tashmë.
- Kërkoni mundësi për të filluar apo kontribuar në përpilimin e moduleve standarde të trajnimit (si për shembull për çështjet gjinore, të drejtat e njeriut) për rekrutet e reja dhe oficeret në detyrë.
- Kërkoni mundësi për integrimin e informacionit në materialet ekzistuese të trajnimit dhe kurrikulat për të

SHEMBULLI NR. 9: FORUMI I PRIJEDORIT PËR SIGURINË NË BOSNJE

Forumi i Prijedorit për sigurinë u krijua në vitin 2003, me qëllim identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve vendore të sigurisë. Forumi ofron një model praktik të bashkëpunimit efikas midis 26 institucioneve, ndër të cilat organizatat e shoqërisë civile, autoritetet vendore (shërbimet arsimore dhe të kujdesit shëndetësor), ofruesit e sigurisë (policinë dhe zjarrfikësit). Një ndër funksionet thelbësore të forumit është hartimi i një plani strategjik që identifikon një vizion të përbashkët për sigurinë për qytetin e Prijedorit dhe krijon bashkëpunim midis institucioneve kryesore dhe qytetarëve në fushën e sigurisë. Gjithashtu, forumi po zbaton projekte specifike, si një strehëz për viktimat e dhunës dhe një sistem për monitorimin me video të hapësirave publike. Forumi ka për qëllim që të nxiten qytetarët të marrin një rol aktiv në trajtimin e çështjeve të sigurisë në komunitetet e tyre, përmes fushatave të informimit në media, shpërndarjes së fletëpalosjeve,

diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta dhe vizitave në zonat rurale.

Pjesëmarrja e organizatave të grave nga shoqëria civile në forum ka kontribuar në miratimin e një protokollit të përbashkët mbi dhunën në familje dhe masat për mbrojtjen e viktimave. Komandanti i policisë vendore, Zoran Indic thekson se rritja e numrit të raportimeve për rastet e dhunës në familje tregon ndikimin pozitiv të fushatave ndërgjegjësuese të forumit dhe përpjekje të tjera. Më gjerë, sipas njëres prej organizatave të shoqërisë civile, Shoqata e Grave (NADA), bashkëpunimi midis institucioneve përmes forumit ka zgjidhur problemet me të cilat përballeshin qytetarët (si burrat dhe gratë), sidomos të kthyerit; ka mbështetur punën e organizatave fetare; ka mbështetur të drejtat e minoriteteve; dhe ka forcuar pjesëmarrjen aktive të grave në politikë dhe në jetën publike.

Burimet: PrijedorGrad, Forum za bezbjednost zajednice Prijedor (Prijedor: 2010); Majda Bećirević, Željka Šulc, dhe Maja Šoštar, *Gjinia dhesektori i sigurisë Reforma në Bosnje Hercegovinë* (Sarajevë: DCAF, 2011), 100; Forumi i Prijedorit “Protokollit i takimeve/konsultimeve të brendshme” <http://www.opstinaprijedor.org/>; Intervistë me Radenka Karajica nga NADA, 3 gusht 2012 dhe Majda Bećirevic nga Nisma e Atlantikut, 6 gusht 2012.

SHEMBULL NR.10: KOMITETI VENDOR I SIGURISË NË HAITI


Në nëntë komunitete në Haiti, organizatat e grave nga shoqëria civile kanë ngritur komitete vendore të sigurisë, të njohura si *comités de sécurité*, të mbështetura nga programi UN Women, me qëllim nxitjen e përfshirjes së grave në nismat në nivel komuniteti për përmirësimin e sigurisë. Këto komitete përfshijnë gjithashtu përfaqësues nga pushteti vendor, nga policia, gjyqësori, arsimiti, shëndetësia, kisha dhe komuniteti vudu. Roli i tyre

është diskutimi i nevojave të sigurisë së grave, rritja e ndërgjegjësimit për dhunën ndaj grave dhe përmirësimi i reagimit dhe llogaridhënies nga ana e ofruesve vendorë të shërbimeve (përfshirë policinë) si pjesë e një rrjeti referimi në nivel komuniteti. Rezultatet paraprake sugjerojnë që këto komitete luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e besimit tek reagimi i policisë kundrejt dhunës.

Burimi: Helen Spraos dhe Lyndsay McLean Hilker (2011, 2009), të cituara në: *UN Virtual Knowledge Centre to End Violence against women and Girls* (Njohuritë virtuale të OKB për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe vajzave) <http://www.endvawnow.org/en/articles/1097-mechanisms-for-community-engagement-dialogue-dhe-outreach.html>.

gjitha temat. Në rast se, fjala vjen, ka një modul trajnimi për procedurat “ndalo dhe kontrollo”, merrni masa që ai të trajtojë mënyrën se si të kontrollohen gratë, vajzat, djemtet dhe burrat.

Instrumenti nr. 23 në Seksionin 3 është shembull i një programi trajnimi dyditor për çështjet gjinore dhe reformën e sektorit të sigurisë. Burime të dobishme që lidhen me trajnimin përfshijnë: Manualin e DCAF-it mbi *Trajnimin mbi çështjet gjinore për personelin e sektorit të sigurisë dhe Paketa e Burimeve të trajnimit për çështjet gjinore dhe reformën e sektorit të sigurisë*, tek Burimet Shtesë.

 Një ndër sfidat e zakonshme të organizatave të shoqërisë civile është marrja e miratimit që personeli në institucionin e sigurisë apo ministrinë përkatëse të marrë pjesë në trajnimin tuaj. Nëse organizata juaj ka krijuar besueshmëri se ka ekspertizë në një temë të caktuar, ata mund të bien dakord fare lehtë. Përndryshe, mund të jetë me dobi që të krijohet partneritet me një organizatë tjetër më të njohur, vendore ose ndërkombëtare.

Kërkoni mënyra se si organizata juaj e shoqërisë civile mund të bashkëpunojë me sektorin e sigurisë për përmirësimin e shërbimeve

Seksioni 1 paraqet shembuj të organizatave të grave që punojnë me institucionet e sektorit të sigurisë për rritjen e sigurisë në komunitet e tyre. Mund të ketë situata në të cilat organizatat e shoqërisë civile janë më në gjendje të ofrojnë shërbime sesa institucionet e sektorit të sigurisë. Për shembull, organizatat e shoqërisë civile mund të sigurojnë

shtëpi të sigurta për viktimat e trafikut të qenieve njerëzore, trajnime për ish-luftëtarët, apo të ofrojnë programe edukimi brenda burgjeve. Në shumicën e këtyre situatave, një organizatë e shoqërisë civile punon në mënyrë të pavarur nga institucionet e sektorit të sigurisë, por e bashkërendon punën me ta, shkëmben informacion për vështirësitë që hasin personat me të cilët punojnë, dhe komunikojnë çdo shqetësim për politikën ose praktikën e institucioneve të sektorit të sigurisë.



Përvoja juaj dhe mendimet tuaja për çështjet e sigurisë kanë rëndësi. Udhëheqësit botërorë po thonë që duhet të dëgjohet zëri i gruas dhe se gratë duhet të jenë pjesë e pandashme e vendimeve të sigurisë. Ky Udhëzues ju jep disa instrumente për ta bërë zërin tuaj të dëgjohet, qoftë kjo në lagjen tuaj, në shkallë krahine apo vendi.

Ky Seksion i këtij Udhëzuesi e vë theksin tek veprimtaritë kryesore përmes të cilave mund të identifikoni, promovoni dhe – shpresojmë – të përmbushni synimet tuaja për sigurinë: **puna kërkimore**, bashkimi i forcave për të punuar si një **koalicion**, **planifikimi** strategjik, hartimi i **rekomandimeve**, **avokacia** dhe **angazhimi** me sektorin e sigurisë në vijimësi. Nëse shumë prej këtyre elementeve janë të reja për ju, niseni punën pak nga pak dhe kërkoni mbështetjen e atyre që kanë më shumë përvojë. Në rast se e keni përvojën për këto veprimtari, shpresojmë t'ju lindin ide të reja për një proces efikas avokacie dhe angazhimi me sektorin e sigurisë. Seksionin tjetër do të kalojmë në aspekte më praktike. Vazhdoni të lexoni!

SHEMBULLI NR. 11: ZYRA E MONITORIMIT TË TË DREJTAVE TË GRAVE NË KAMBOXHIA

Organizata kamboxhiane e të drejtave të njeriut, e quajtur LICADHO monitoron trajtimin e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore. Organizata përdor standarde ndërkombëtare si CEDAW, si standarde për monitorimin e qeverisë së Kamboxhias. Ndër veprimtaritë e zyrës e monitorimit për të drejtat e grave përfshihen:

- Identifikimi i shkeljeve të të drejtave të grave përmes viktimitave, dëshmitarëve dhe mediave;
- Reagimi ndaj këtyre shkeljeve duke e ndihmuar viktimitën me anë të ndërhyrjeve juridike dhe referimeve, dhe përmes bashkërendimit të ofrimit të ndihmës së parë, këshillimit dhe mbështetjeve të tjera materiale bazë për viktimat;
- Ndjekja e punës në vijimësi me autoritetet, për të garantuar ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshme

për hetimin dhe ndëshkimin e autorëve të veprës penale;

- Kur del e nevojshme, t'i bëhet thirrje për veprim Kryetarit të Gjykatës ose niveleve më të larta, si për shembull Ministria e Drejtësisë apo Këshilli i Lartë i Magjistraturës; dhe
- Fuqizimi i pikave fokale të cilat edukojnë komunitetet për shkeljen e të drejtave të grave, fuqizimi i grave për t'i ushtruar të drejtat e tyre dhe ofrimi i mbështetjes për viktimat në nivelin e bazës.

Gjatë viteve 2005, 2006 dhe 2007, LICADHO nxori raporte mbi dhunën ndaj grave në Kamboxhia, ku analizohej nëse legjislacioni kamboxhian për dhunën kundër grave binte ndesh me Konventën CEDAW dhe cili ishte ndikimi i këtyre mospërputhjeve.

Burimi: Lidhja e Kamboxhias për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (LICADHO), *Zyra për monitorimin e të drejtave të grave*, <http://www.licadho-cambodia.org/programs/womenoffice.ph>.

SHEMBULLI NR. 12: BASHKIMI I GRAVE JEMENITE OFRON SHËRBIME PËR BURGJET

Bashkimi i grave jemenite është një organizatë e shoqërisë civile që punon për rritjen e aksesit të grave dhe vajzave në shërbime arsimore, kujdes shëndetësor, mbrojtje juridike dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën ekonomiko-politike të vendit. Bashkimi ka programe të posaçme për gratë e burgosura dhe vajzat në qendrat e riedukimit për të mitur. Ndër veprimtaritë e Bashkimit mund të përmendim:

- Puna në pesë rrethe me 36 avokatë që ofrojnë

mbështetje juridike dhe shërbime këshillimi për gratë e varfra që vuajnë heqjen e lirisë, mbi baza vullnetare (me mbështetjen e Oxfam-it);

- Administrimi i një strehe të sigurte banimi për ish të burgosurat;
- ofrimi i kurseve të trajnimit për të ndihmuar në ri-integrimin e të ndaluarave në jetën ekonomiko-shoqërore; dhe
- Mbrojtje e të drejtave të grave të dënuara me heqje lire.

Burimet: Oxfam, *Yemen Program Overview* (Vështrim i Përgjithshëm mbi Programin e Jemenit), http://www.oxfam.org.uk/~media/Files/OGB/What%20we%20do/Countries%20we%20work%20in/Yemen/5158_meeecis_yemen%20PRINT2.ashx; Yemeni women's Union, *Legal Protection*, <http://yemeniwomen.org/ourprograms/legal-protection/>.

Zayneb Ashalalfeh, një drejtuese e re nga shoqëria civile palestineze, jep mendime për kontributin e grave në siguri në një seminar trajnimi për zhvillimin e aftësive të avokacisë në qershor2011 në Betlehem.

 Fotografia: Instituti për Siguri Përfshirëse



Seksioni III: Instrumente për veprim

Tani që e keni kuptuar se çfarë përfaqëson sektori i sigurisë dhe keni ide mbi mënyrën e pjesëmarrjes në reformën e sektorit të sigurisë, Seksioni i mëposhtëm ju siguron instrumentet për t'ia nisur nga puna. Ndonëse në këto rekomandime nuk kemi thënë apo përfshirë gjithçka, këto sugjerime ofrojnë sugjerime dhe ide të dobishme për të vepruar në përputhje me aktivitetet e parashtruara në Seksionin 2. Ju përshtatini sipas nevojave dhe rrethanave tuaja!

Instrumenti nr. 1 - Llojet dhe burimet e informacionit për shqyrtim literature

Llojet e informacionit

- *Dokumente politikash*: koncepte apo strategji për sigurinë kombëtare; dokumente programatike; dokumente strategjike të ministrive dhe drejtorive; politika dhe procedura institucionale; platforma të partive politike; mandate të lëshuara nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së apo organe të tjera.
- *Deklarata dhe raporte*: deklaratat, fjalime dhe raporte nga zyrtarë dhe parlamentarë; raporte dhe statistika nga agjenci qeveritare; raporte nga zyrat e Avokatit të Popullit apo Komisionit për të Drejtat e Njeriut.
- *Raportime nga media*: artikuj shtypi, radioja, televizioni dhe interneti.
- *Studime analitike*: hulumtime të mëparshme nga organizatat e shoqërisë civile dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare, studiues, etj.
- *Anketime/sondazhe të opinionit të gjerë*: sondazhe sociologjike që bëjnë pyetje që lidhen me perceptimet dhe përvojat e sigurisë të burrave dhe grave.

Burimet e informacionit

- *Interneti*: faqet e internetit të institucioneve të sektorit të sigurisë, organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave dhe enteve të tjera vendore dhe ndërkombëtare; baza të dhënash në internet që grupojnë statistika dhe raporte relevante; artikuj të

ndryshëm.

- *Bibliotekat*: raporte dhe artikuj shkencorë, shumë prej të cilëve ende publikohen vetëm në letër. (Bibliotekat universitare dhe institutet e çështjeve ndërkombëtare mund të jenë veçanërisht të dobishme. Shumë organizata të shoqërisë civile krijojnë bibliotekat e tyre).
- *Kontaktet personale*: persona të tjerë (në veçanti ata me të cilët jeni takuar gjatë projekteve hulumtuese) të cilët shpesh e dinë çfarë informacioni disponohet dhe ku të gjendet.

Institucionet që kanë qasje në të dhënat primare:

- Qeveria rajonale dhe nacionale;
- Autoritetet e policisë dhe ato të kufirit;
- Gjyqtarët dhe prokurorët;
- Shërbimet e Burgjeve dhe të Provës;
- Kompani private të sigurimeve;
- Punonjës socialë, këshilltarë dhe strehëzat;
- Spitalet, klinikat dhe mjekët;
- Organizata qytetare dhe sindikata; dhe
- Këshillat vendorë dhe krahinorë.
- Local and provincial councils.

Instrumenti nr. 2 – Pyetje për diskutim

Këto pyetje mund të përdoren për t’ju ndihmuar të organizoni mendimet apo për të nxitur diskutime në grup:

- Çfarë do të thotë “siguria” për ju?
- Cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë me të cilat përballen kanosin gratë, burrat, djemtë dhe vajzat në familjet tuaja? Në komunitetin tuaj? Në krahinën tuaj? Në vendin tuaj?
- Cilat grupe të tjera në komunitetin tuaj kanë nevoja specifike sigurie të cilat nuk po plotësohen?
- Çfarë informacioni, kapacitetesh dhe përvoja mund të sjellin organizatat e grave të shoqërisë civile në diskutimet që lidhen me sigurinë dhe si ofrohen shërbimet e sigurisë?
- Si mundën institucionet e sektorit të sigurisë, si policia dhe gjykatat, t’u përgjigjen më mirë nevojave të ndryshme të sigurisë së grave, burrave, vajzave dhe djemve?

Instrumenti nr. 3 – Listë kursesh trajnimit falas në internet për reformën e sektorit të sigurisë dhe çështje që lidhen me të

- UNITAR- Ky kurs njohjeje me sektorin e sigurisë ofron një vështrim të përgjithshëm mbi konceptin e reformës në sektorin e sigurisë, përcakton aktorët kryesorë dhe rolet e tyre, si dhe përvijon zbatimin e programit: <http://www.unitar.org/event/introductionsecurity-sector-reform-ptp201201e>.
- Instituti “Peace Operations Training” (Trajtime për Operacione të Paqes) ofron kurse trajnimi në internet për zbatimin e UNSCR 1325 (2000) në vendet e Amerikës Latine, Karaibe dhe Afrikë: <http://www.peaceopstraining.org/e-learning/free-courses/>.
- Instituti për Paqen (Institute of Peace) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ofron kurse në internet për analizimin e konflikteve, negociatat, menaxhimin e konflikteve dhe zgjidhjen e konflikteve ndër-fetare: <http://www.usip.org/education-training/international/online-courses>.
- Aleanca feministe për veprim ndërkombëtar (Feminist Alliance for International Action CEDAW) ofron kurse në internet për t’i njohur pjesëmarrësit me të gjitha aspektet e konventës (CEDAW), përfshirë historikun e saj, zbatimin dhe rolet e qeverive dhe shoqërisë civile: <http://www.fafiaafai.org/en/cedawcourse>.
- RESPECT Refugiados ka një kurs trajnimi në internet për të drejtat e njeriut për të rinjtë: <http://humanrightsfor youth.org/training-course/>.
- Qendra për çështje Publike e bazuar në Bangalore dhe Banka Aziatike për Zhvillim kanë përpiluar një Manual Mësimi në Internet për Skedat e Vlerësimit të Qytetarëve (Citizen Report Card e-learning toolkit): <http://www.citizenreportcard.com/#>.

Instrumenti nr. 4 – Fjalorth për sigurinë

Spektori i sigurisë përdor shumë terma dhe zhargon. Organizata të ndryshme mund të miratojnë terminologjinë e tyre për të shprehur të njëjtat koncepte. Kështu për shembull, BE-ja përdor termin “battle groups” (grupe beteje), ndërsa NATO-ja mund të përdorë termin “rapid deployment teams” (skuadra të ndërhyrjes së shpejtë). Si pjesëtarë të shoqërisë civile, askush nuk pret nga ju të dini çdo fjalë dhe çdo shkurtim; megjithatë, disa nga termat e mëposhtme që përdoren rëndom mund t’ju ndihmojnë të trajtoni me besim dhe të kuptoheni më mirë me aktorët e sektorit të sigurisë. Përpquni të mësoni termat që përdor organizata tek të cilat dëshironi të ndikoni.

Teatri ose Zona e Operacioneve: një zonë specifike gjeografike që mund të përdoret nga një forcë ushtarake, madhësia e së cilës mund të ndryshojë ndjeshëm. *Për shembull: “Ekipi i krahinës për rindërtim është i përqendruar tek projektet e ujitjes në zonën e vet të operacioneve”.*

Zinxhiri i komandës: strukturë organizative ku autoriteti delegohet nga lartë poshtë dhe ku çdo person në zinxhir jep llogari drejtpërsëdrejti tek eprori i tij një shkallë më lart. Forcat e armatosura kanë një zinxhir të qartë dhe të prerë komande. *Për shembull: “Oficeret së re iu desh të mësohej të merrte urdhra nga komandantja e saj dhe të mësohej me punën brenda zinxhirit të komandës”.*

Kontrolli civil: përgjegjësia përfundimtare për vendim-marrjen strategjike në vend është në dorën e udhëheqjes politike civile dhe jo në atë të forcave profesioniste ushtarake apo të policisë. Kjo nxit llogaridhënien dhe transparencën brenda forcave të armatosura dhe atyre të sigurisë. *Për shembull “Qeveria e re shprehu angazhimin e saj për kontrollin civil të ushtrisë përmes emërimit të një ish-deputeti dhe jo të një gjenerali në krye të Ministrisë së Mbrojtjes.”*

Marrëdhëniet ose operacionet civilo-ushtarake: veprimtaritë që kryhen nga ushtria për të promovuar marrëdhënie të mira me popullsinë civile. Gjithashtu ky term ka edhe kuptimin e bashkëpunimit ose dialogut midis komuniteteve ushtarake dhe civile. *Për shembull “Ushtria është përqendruar tek marrëdhëniet civilo-ushtarake për të përmirësuar imazhin e saj ndër komunitetet vendore”.*

Kodi i sjelljes (etikës): Një kod i hartuar për të nxitur një mjedis pune të përgjegjshëm dhe etik. Ai përcakton kriteret e standardeve të pritshme etike, detyrimet juridike, si edhe

rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të angazhuar në një proces të përbashkët. *Për shembull: “Misionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara kanë detyrimin të respektojnë standardet e përcaktuara në Kodin e Sjelljes Personale të OKB për Helmetat Blu, ku përcaktohet politika e tolerancës zero ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit seksual”.*

Puna policore në komunitet: Përpjekje për ta bërë policinë më të aksesueshme dhe më të pranishme në nivel vendor dhe vendosja e një raporti më të ngushtë midis policisë, institucioneve të sektorit të sigurisë dhe komuniteteve. *Për shembull: “Fokusi i ri që i ka kushtuar bashkia kohët e fundit punës policore në komunitet përfshin takime të vazhdueshme midis policisë dhe kishës vendore dhe grupeve të rinisë dhe grave”.*

Kontrolli demokratik i forcave të armatosura: forcat e armatosura kontrollohen nga autoritete civile të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe janë objekt i mbikëqyrjes nga gjyqësori, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile. *Për shembull: “Kontrolli demokratik i forcave të armatosura garanton që civilët të përcaktojnë madhësinë e forcave ushtarake”.*

Çarmatimi, çmobilizimi dhe ri-integrimi: Një varg specifik procesesh në periudhën post-konfliktuale për ndërtimin e paqes. Çarmatimi ka të bëjë me grumbullimin, kontrollin dhe heqjen nga përdorimi të armëve të vogla, municionit dhe eksplozivëve, armatimeve të lehta dhe të rënda të luftëtarëve dhe popullatës civile brenda një zone konflikti. Çmobilizimi është procesi me anë të të cilit forcat ndërluftuese shpërndajnë strukturat e tyre ushtarake ose i reduktojnë ato dhe luftëtarët dalëngadalë i kthehen jetës civile. Ri-integrimi është procesi në të cilin ish luftëtarët dhe

familjet e tyre përshtaten ekonomikisht dhe shoqërisht me një jetë produktive civile, shpesh në strukturat shtetërore të sigurisë. *Për shembull: “Roli i grave luftëtare shpesh lihet në harresë nga ekspertët që planifikojnë programet e ÇÇR-së”.*

Shumëfishues i forcës: në terminologjinë ushtarake, një shumëfishues i forcës ka kuptimin e diçkaje që e bën një forcë të caktuar edhe më efektive nga çka do të kishte qenë pa të. Për shembull, një teknologji apo taktikë e caktuar që e bën një forcë të arrijë synimet e saj është shumëfishues force. *Për shembull: “Ushtarët kanë konstatuar se kur flasin me popullsinë vendase mbi rreziqet që lidhen me sigurinë, kjo është një shumëfishues force si rezultat i informacionit unik që zbulohet.”*

Dhuna me bazë gjinore: Çdo veprim i dëmshëm që kryhet kundër dëshirës së një personi dhe bazohet tek dallimet (gjinore) të caktuara nga shoqëria midis femrave dhe meshkujve. Këtu mund të përfshihet dhuna psikologjike, dhuna në familje, trafikimi për qëllime të shfrytëzimit seksual, ose puna e detyruar, dhuna seksuale, gjymtimi i organeve seksuale dhe dhuna nga bandat. *Për shembull: “Dhuna me bazë gjinore shfaqet në shumë forma, por gjithmonë dëmton familjet dhe komunitetet po aq sa individët”.*

Mandati: urdhër zyrtar apo autorizim me shkrim për operacionet e sigurisë. *Për shembull: “Mandati i misionit përfshinte mbrojtjen e civilëve”.*

Misioni: Institucionet e sigurisë dhe ato të mbrojtjes e përdorin këtë term në kuptimin e aktivitetit apo operacionit të sigurisë të caktuar nga një epror. *Për shembull: “Misioni ishte mbrojtja e grave nga dhuna seksuale”.*

Efektiviteti operativ: Niveli i efikasitetit sipas të cilit vepron aktualisht organizata në fjalë; kryerja e një detyre me rezultate maksimale dhe burime minimale. *Për shembull: “Kryerja e detyrave me shpejtësi dhe sukses rrit efektivitetin operativ/operacional”.*

Sundimi i ligjit: Ligji është një dhe i barabartë për të gjithë. Sundimi i ligjit kërkon një sistem të pavarur gjyqësor, të drejtë dhe transparent dhe që i parandalon qeveritë nga marrja e vendimeve arbitrare. *Për shembull: “Respekti për sundimin e ligjit është me shumë rëndësi që njerëzit të ndjehen të sigurtë dhe të trajtohen njësoj nga qeveria e tyre dhe aktorët e sigurisë”.*

Rregullat e angazhimit: Direktivat që përcaktojnë rrethanat dhe kufizimet sipas të cilave personeli ushtarak mund

të përdorë forcën dhe sipas të cilave kryen aspekte të tjera të detyrave. Rregullat e angazhimit përcaktohen nga ushtarakët e lartë dhe çdo ushtar duhet t'i njohë ato. *Për shembull: Rregullat e angazhimit për operacionin “Provide Relief” në Somali në vitin 1992 përcaktonin që “Nuk duhet të përvetësosh pronat e të tjerëve për të realizuar misionin tënd”.*

Armët e vogla dhe të lehta: Armët e vogla janë armë për përdorim personal. Këto lloj armësh përfshijnë revolverët, pistoletat, pushkët dhe disa lloje mitralozash. Armët e lehta janë armë që janë menduar për përdorim nga dy apo tri persona që janë një skuadër. *Për shembull: “Komuniteti po përpiqet t'i vërë fre hyrjes së armëve të vogla dhe të lehta pas luftës”.*

Reforma në sektorin e sigurisë (SSR): Shndërrimi i sektorit të sigurisë (përfshirë forcat e armatosura, policinë, shërbimet inteligjente, ministritë përkatëse të linjës, sistemin penal, strukturat e mbikëqyrjes, etj.) për të garantuar që sektori i sigurisë të ofrojë siguri me efektivitet dhe efikasitet, në rrethanat e mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik. Reforma e sektorit të sigurisë mund të jetë një proces gjithëpërfshirës zyrtar i drejtuar nga qeveria kombëtare ose mund t'i referohet përpjekjeve për reformë në një sektor specifik (si për shembull në polici). *Për shembull: “Ne duam të angazhohemi zyrtarisht në procesin e reformës në sektorin e sigurisë që po zbatohet nga pushteti qendror”.*

Trajnimi dhe pajisja: përkrahur veprimtari brenda programit ndërkombëtar të mbështetjes së SSR-së, të cilat i japin përparësi rekrutimit, trajnimit dhe pajisjes së personelit brenda një afati të shkurtër kohor. Ndonëse me rëndësi, këto llojveprimtarish shpesh mund të lënë mënjanë reforma më të rëndësishme afatgjata të cilat mund të jenë më vështirë për tu monitoruar. *Për shembull: “Ndërsa fokusi tek trajnimi dhe pajisja e policisë sollti ndërtimin e kazermave të reja të policisë, ai la jashtë programe për ndërtimin e një marrëdhënieje besimi me komunitetin vendor”.*

Vlerësimi paraprak i kandidatëve: Shqyrtim i historisë personale dhe integritetit të individëve për të përcaktuar nëse dhe sa të përshtatshëm janë ata për tu punësuar në sektorin publik. Ai garanton që aplikantët nuk kanë histori dhune apo krimesh të rënda, duke përfshirë shkelje të të drejtave të njeriut apo krime lufte. *Për shembull: “Vlerësimi i punonjësve të rinj të policisë pas një lufte civile ndihmon në parandalimin e marrjes së posteve të rëndësishme nga kriminelët”.*

Instrumenti nr. 5 – Çfarë roli luajnë aktorët kryesorë të sektorit të sigurisë?

Me qëllim që të kontaktoni me aktorët e përshtatshëm të sektorit të sigurisë për ato ndryshime që dëshironi të arrini, duhet të kuptoni se çfarë pune bën secili prej tyre.

Tabela e mëposhtme paraqet disa nga funksionet kyçe të aktorëve kryesorë të sektorit të sigurisë dhe disa prej parimeve kyçe që i qeverisin ato. Kjo është një tablo e përgjithshme e disa prej roleve dhe marrëdhënieve. Çdo vend ka veçantitë e veta, kështu që ju duhet të zbuloni

sesi funksionojnë gjërat në vendin tuaj. Në seksionin “Burime Shtesë” do të gjeni organizatat që publikojnë punë kërkimore për sektorin e sigurisë dhe reformën në sektorin e sigurisë. Disa prej këtyre organizatave mund të kenë publikuar raporte edhe për vendin tuaj.

Forcat e armatosura dhe forcat e sigurisë shtetërore

Forcat e armatosura/ ushtria/forcat e mbrojtjes (ku mund të përfshihet edhe xhandarmëria)

- Funkzioni parësor i ushtrisë është mbrojtja dhe ruajtja e shtetit dhe popullatës nga agresioni i huaj. Disa forca të armatosura marrin pjesë në operacione ndërkombëtare paqeruajtëse.
- Ushtria duhet të përdoret edhe për qëllime të tjera të brendshme të sigurisë, vetëm në rastet kur forcat civile e kanë të pamundur të reagojnë të vetme me efikasitet (situata emergjencash).
- Ushtria duhet të jetë e pajisur për t'i bërë ballë një game të gjerë rreziqesh, të jetë në gjendje të bashkëpunojë me aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe jo-shtetërorë, si edhe të respektojë të drejtat e njeriut.
- Autoritetet civile duhet të mbikëqyrin veprimtaritë, shpenzimet dhe proceset e ushtrisë.

Agjencia për menaxhimin e kufirit

- Kjo agjenci përqendrohet tek rregullat dhe procedurat që rregullojnë veprimtaritë dhe trafikun përmes zonave të përcaktuara kufitare.
- Detyra e kësaj agjencie është të parandalojë aktivitetet e paligjshme ndërkufitare, të zbulojë rreziqe që mund t'i kanosen sigurisë kombëtare dhe të kontrollojë personat dhe automjetet në pikat e caktuara kufitare.
- Rojat kufitare zakonisht veprojnë nën autoritetin e një shpërblimi civil apo parlamentar të zbatimit të rendit.

Agjencia e imigrimit dhe doganave

- Kjo agjenci përgjigjet për zbatimin e kufizimeve hyrëse dhe dalëse, garanton ligjshmërinë e dokumenteve të udhëtimit, identifikon dhe heton kriminalitetin dhe u vjen në ndihmë personave që kanë nevojë për mbrojtje.
- Objektivi i kësaj agjencie është përmirësimi i parandalimit dhe zbulimit të rasteve të trafikimit dhe kontrabandës, fuqizimi i mbrojtjes dhe nxitjes së të drejtave të njeriut, si edhe rritja e “pronësisë” vendore, mbikëqyrjes dhe bashkëpunimit.

Policia

- Funkzioni kryesor i policisë është zbatimi i rendit.
- Policia përqendrohet tek parandalimi dhe zbulimi i krimit, ruajtja e rendit publik dhe mbrojtja e pronës dhe popullatës.
- Udhëheqja civile duhet të mbikëqyrë aktivitetet, shpenzimet dhe proceset e tjera të policisë.

Organet shtetërore të mbikëqyrjes dhe menaxhimit

Kryetari i shtetit	<ul style="list-style-type: none"> Kryetari i shtetit mund të jetë kryeministri, presidenti apo një monark. Roli i tij/saj, për sektorin e sigurisë mund të variojë nga funksioni thjesht ceremonial, tek shefi i shtabit të forcave të armatosura, tek komandanti suprem në kohë lufte. Bashkërisht me agjenci të tjera brenda degës ekzekutive të qeverisë, ai/ajo përcakton buxhetin, udhëzimet e përgjithshme dhe përparësitë e shërbimeve të forcave të armatosura dhe atyre të sigurisë.
Anëtarët e legjislativave/ parlamenti	<ul style="list-style-type: none"> Parlamentarët ose deputetët përgjigjen për prezantimin, debatimin dhe miratimin apo kundërshtimin e ligjeve. Ata ushtrojnë mbikëqyrjen e politikave, miratojnë buxhetet dhe mund të bëhen shkas për nisjen e hetimeve. Parlamentarët mund të organizojnë seanca dëgjimore publike, mund tu ofrojnë organizatave të shoqërisë civile informacione të ndryshme dhe të përdorin instrumente të ndryshme për diskutimin e politikave shtetërore të sigurisë.
Ministria e Mbrojtjes	<ul style="list-style-type: none"> Ministria e Mbrojtjes përgjigjet për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e forcave të armatosura, si edhe për përcaktimin dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes. Ministri i Mbrojtjes është zakonisht këshilltari kryesor për çështjet e mbrojtjes për kreun e shtetit. Ministria e Mbrojtjes është e dallueshme nga vetë forcat e armatosura, të cilat janë më operative.
Ministria e Brendshme	<ul style="list-style-type: none"> Kjo Ministri, në përgjithësi, përgjigjet për politikën, financimin dhe mbikëqyrjen e organizimit të aspektit civil të zbatimit të rendit, përfshirë policinë, sigurinë e kufirit dhe njësitë e posaçme të hetimit. Në disa vende, Ministria e Brendshme mund të përgjigjet edhe për burgjet, çështjet e imigrimit dhe pushtetit vendor, duke përfshirë administratën e provincave, bashkive dhe rretheve.
Ministria për Çështjet Gjinore dhe Gratë	<ul style="list-style-type: none"> Kjo Ministri përgjigjet për dhënien e udhëzimeve, në mënyrë që të gjitha politikën, strukturat dhe programet qeveritare të përmbushin nevojat e burrave dhe grave njësoj. Ajo shpesh përqendrohet tek integrimi i çështjeve gjinore në të gjitha agjencitë qeveritare, si dhe tek fuqizimi i grave, sidomos përmes programeve dhe fondeve të dedikuara. Ajo mund të luajë rol për garantimin që proceset e reformës së sektorit të sigurisë dhe institucionet e sektorit të sigurisë t'i përfshijnë gratë, si dhe të përmbushin nevojat e grave dhe vajzave.
Këshilli kombëtar i sigurisë	<ul style="list-style-type: none"> Ky organ përgjigjet për shqyrtimin e politikës kombëtare të sigurisë, që përbën kuadrin për mënyrën sesi vendi garanton sigurinë për shtetin dhe shtetasit e vet. Ky grup mund të jetë kabineti i përhershëm ose një komitet i përkohshëm që këshillon kreun e shtetit. Këshilli kombëtar i sigurisë zakonisht organizon këshillime përfshirëse me aktorë qeveritarë të sigurisë, si edhe me aktorë jo-qeveritarë.
Komisioni parlamentar i financës/buxhetit	<ul style="list-style-type: none"> Këto komisione janë ato që thonë fjalën e fundit për buxhetet e të gjitha institucioneve të sektorit të sigurisë (përveç komisionit të llogarive publike, i cili shqyrton raportet e auditimit për të gjithë buxhetin mbarëkombëtar, duke përfshirë edhe buxhetin për mbrojtjen).

Organet shtetërore të mbikëqyrjes dhe menaxhimit

Komisioni parlamentar i mbrojtjes dhe shërbimeve të zbulimit

- Ky komision i ofron parlamentit këshillim dhe jep rekomandime për ligjet apo vendimet që kanë të bëjnë me çështje të mbrojtjes kombëtare dhe shërbimet inteligjente.
- Ky komision duhet të përqendrohet tek çështje që kanë të bëjnë me madhësinë, strukturën, organizimin, prokurimet, financimin dhe funksionimin e aktorëve shtetërorë që kanë mandatin e përdorimit të forcës dhe organet e menaxhimit civil që marrin vendimet për përdorimin e forcës.
- Të gjitha komisionet parlamentare duhet të ushtrojnë pushtet të gjerë mbikëqyrës për hetimin e çështjeve madhore që lidhen me politikat publike, keqadministrimin, akuzat për korrupsion apo skandalet.

Drejtësia dhe institucionet e zbatimit të rendit

Ministria e Drejtësisë

- Kjo Ministri përgjigjet për organizimin e sistemit të drejtësisë, mbikëqyrjen e prokurorisë dhe ruajtjen e sistemit juridik dhe rendit publik. Zakonisht, Ministria e Drejtësisë ka përgjegjësinë për sistemin penal, duke përfshirë burgjet.
- Gjithashtu, disa ministri kanë përgjegjësi shtesë në fushat përkatëse të politikave, kanë përgjegjësi për mbikëqyrjen e procesit zgjedhor, drejtimit të policisë, dhe reformës ligjore.

Sistemi i gjyqësorit

- Sistemi i gjyqësorit përfaqëson gjykatat që administrojnë drejtësi dhe përbën degën e gjyqësorit të qeverisë.
- Shërbimet e gjyqësorit prokurorisë dhe mekanizma të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duhet të jenë të paanshme dhe të vihen përpara përgjegjësisë.
- Sistemi i gjyqësorit luan rol në mbikëqyrjen e segmenteve të tjera të sektorit të sigurisë, në rastet kur personeli apo institucionet e sektorit të sigurisë sillen përpara gjykatës.

Sistemi penal

- Sistemi penal përgjigjet për zbatimin e ndëshkimeve apo masave të tjera të urdhëruara nga gjykatat. Sistemi penal përfshin burgjet, por edhe alternativat e marrjes në mbrojtje si për shembull: sistemet e lënies së lirë kundrejt pagesës dhe urdhrat e punës në komunitet, si edhe shërbimet e barrës së provës dhe inspektoratet (në vendet ku ato ekzistojnë), si edhe sistemet e zakonshme dhe sanksionet informale.
- Një sistem penal që të konsiderohet funksional duhet të ketë personel të mjaftueshëm të trajnuar dhe paguar siç duhet, me qëllim shmangien e korrupsionit; të respektojë të drejtat e njeriut dhe nevojat e ndryshme të grave, burrave, djemve dhe vajzave; dhe të ofrojë veprimtari rehabilituese dhe edukuese.
- Burgjet duhet të monitorohen nga grupe të pavarura/shoqëria civile me qëllim parandalimin e abuzimit.

Autoritetet tradicionale

- Autoritete zakonore, vendore (të tilla si: kryetari e fshatit, prijësit, kryeplaku dhe këshillat) mund të luajnë një rol të rëndësishëm përsa i takon qëndrimeve dhe zakoneve e dokeve vendore.
- Këta aktorë mund të luajnë një rol të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Aktorët jo-shtetërorë të sektorit të sigurisë

Kompani private ushtarake dhe të sigurisë

- Këto janë kompani që punojnë për qëllime fitimprurëse dhe ofrojnë shërbime ushtarake dhe sigurie për një shtet.
- Detyrat e tyre janë zakonisht të ngjashme me ato që ofrojnë trupat ushtarake dhe forcat e policisë, por shpesh në një shkallë më të ulët/vogël. Këto kompani mund të kenë personel të huaj ose vendor. Ato shpesh janë të përfshirë në administrimin e qendrave të ndalimit dhe në trajnimin e personelit të sektorit të sigurisë.
- Kuptohet që ato shpesh nuk janë objekt i të njëjtit nivel mbikëqyrjeje dhe llogaridhënieje siç janë forcat e armatosura shtetërore dhe ato të sigurisë.

Mbikëqyrja e pavarur

Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, Avokaci i Popullit dhe organet e specializuara të mbikëqyrjes

- Këto janë organe të ngritura me ligj ose në përputhje me Kushtetutën. Ato janë organe të përhershme, të pavarura nga shteti, por që zakonisht raportojnë përpara Parlamentit.
- Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe Avokaci i Popullit kanë si qëllim shqyrtimin e aktiviteteve të autoriteteve qeveritare, duke përfshirë edhe sektorin e sigurisë (ndonëse forcat e armatosura shpesh janë të përjashtuara nga juridiksioni i tyre).
- Organe të tjera të specializuara të mbikëqyrjes mund të kenë mandat për të mbikëqyrur agjenci apo sektorë specifikë (si për shembull policinë, burgjet) apo çështje tematike (si për shembull korrupsioni).
- Në disa vende ekzistojnë gjithashtu edhe zyra Avokaci të Popullit të specializuara për çështjet e mbrojtjes që nuk janë të pavarura nga forcat e armatosura. Po kështu policia, burgjet dhe institucionet e sektorit të sigurisë mund të kenë organe të brendshme të mbikëqyrjes (si për shembull inspektorët) të cilat nuk janë të pavarura nga institucioni.

Organizatata e shoqërisë civile (si Organizatat e të drejtave të njeriut, organizata që ofrojnë asistencë për viktimat, organizata të grave)

- Organizatat e shoqërisë civile mund të monitorojnë sektorin e sigurisë, të kryejnë punë kërkimore, të kërkojnë ndryshim të një politike të caktuar dhe të ofrojnë shërbime për popullatën që lidhen me çështjet e sigurisë.
- Ato shpesh kanë rjetet të fuqishme në popullatë dhe me organizata të tjera të shoqërisë civile.

Media

- Media mund të luajë një rol të rëndësishëm për sa i takon mbikëqyrjes së autoriteteve publike dhe informimit të qytetarëve për rreziqet që kanë të bëjnë me sigurinë.
- Media mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të krijojë mbështetje për reformën në sektorin e sigurisë. Media mund të ketë ndikim negativ, në qoftë se nuk është e pavarur nga shteti.

Grupet për studimin e politikave (Think tanks)

- Grupet për studimin e politikave dhe institutet kërkimore të politikave publike janë pjesë e organizatave të shoqërisë civile që mund të ndikojnë tek politikat përmes ofrimit të informacionit, punës analitike dhe këshillimit.
- Këto institute që ofrojnë punë kërkimore dhe politika për sigurinë gjithashtu mund të ndihmojnë në informimin e medias dhe publikut të gjerë për çështjet e politikave.

Instrumenti nr. 6 – ligjet dhe instrumentet rajonale dhe ndërkombëtare që lidhen me reformën në sektorin e sigurisë dhe me gratë

Siç u diskutua në Seksionin 1, sot ka ligje dhe instrumente të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare, të cilat flasin mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së grave dhe shoqërisë civile në çështjet e sigurisë dhe paqes. Sa më poshtë përfaqëson vetëm disa prej elementëve të përzgjedhur prej nesh. Ne do të rekomandonim që t'i referoheshit *Paketës së Ligjeve dhe Instrumenteve rajonale dhe ndërkombëtare për reformën e sektorit të sigurisë dhe çështjet gjinore të DCAF-it*, për një panoramë të plotë, duke përfshirë një përshkrim të secilit prej instrumenteve.

Evropa

- OSBE, Vendimi nr. 14/05 Për gratë në parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave dhe rehabilitimin post-konfliktual (2005)
- Këshilli i BE-së “Konkluzione mbi nxitjen e barazisë gjinore dhe përfshirjen e çështjeve gjinore në menaxhimin e krizave” (2006)
- “Qasje gjithëpërfshirëse për UNSCR 1325 dhe 1820 “Për gratë, paqen dhe sigurinë” (2008) (BE)

Afrika

- Protokollin i Kartës afrikane për të drejtat e njeriut dhe popullit për gratë në Afrikë (2003)
- “Deklarata solemne e barazisë gjinore në Afrikë” (2004) e Bashkimit afrikan
- Kuadri për parandalimin e konfliktit, ECOWAS-it (2008)
- “Politika gjinore” e bashkimit afrikan (2009)

Azia dhe Paqësori

- Komuniteti i Paqësorit, Platforma e rishikuar e Paqësorit për Veprim mbi avancimin e grave dhe barazinë gjinore për periudhën 2005 deri 2015: një kapitull rajonal (2004)
- Deklarata e Kolombos e Samitit të 15-të të SAARC-ut (Shoqata e Azisë jugore për bashkëpunim rajonal) -Karta sociale e SAARC-ut për gratë dhe fëmijët (2008)

Amerikat

- Organizata e Shteteve Amerikane, Konventa Pan-amerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (Konventa e Belem do Paras) (1994)

Të tjera

- Konferenca e Katërt Botërore për Gratë, Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995)
- “Direktiva e Komandës bi-strategjike 40-1” e NATO-s “Integrimi i UNSCR 1325 dhe perspektivës gjinore në strukturën e komandës së NATO-s” (rishikuar në vitin 2012)

Kombet e Bashkuara

- Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara-Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) (1979)
- UNSCR 1325- për gratë, paqen dhe sigurinë (2000)
- Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i Sigurisë i OKB-së: “garantimi i paqes dhe zhvillimit: roli i Kombeve të Bashkuara në mbështetjen e reformës së sektorit të sigurisë”, raporti i Sekretarit të përgjithshëm, A/62/659-S/2008/39 (2008)
- UNSCR 1820 (2008)
- UNSCR 1888 (2008)
- UNSCR 1889 (2009)
- UNSCR 1960 (2010)


Instrumenti nr. 7 – Ushtrimi për hartën e aktorëve të interesit

Në rast se po merreni me një çështje specifike, krijoni një hartë të të gjithë aktorëve të angazhuar në sektorin e sigurisë.

Për shembull “trajtimi i problemit të numrit në rritje të armëve” mund të ishte një temë për të cilën mund të krijonit një hartë. Harta juaj do të kishte simbole për aktorët kryesorë, si p.sh: grupet e militarizuara, grupet e viktimave, organizata vendore të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare, kisha, forcat e armatosura, policia, grupet kriminale dhe ndofta gazeta vendore, radioja vendore, shkollat, grupet rinore, grupet e nënave

dhe grupet e krijuara nga vetë lagjet për sigurinë e tyre. Mund të përdorni shigjeta dhe simbole të tjera për të treguar marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme dhe pastaj të përpiloni një plan pune ku të përfshini sa më shumë aktorë të tillë të mundni. Një ushtrim mund të ishte që grupet e vogla të krijonin një hartë të marrëdhënieve midis aktorëve në një tabak të madh letre dhe pastaj t’ua tregojnë të gjithë pjesëmarrësve.

Trajtimi i problemit të shtimit të numrit të armëve: Aktorët



nstrumenti nr. 8 – Model ftese për tu bashkuar me një koalicion të ri me fokus angazhimin e grave në reformën e sektorit të sigurisë

Ftesa mund të jetë një email ose një fletëpalosje që e vendosni aty ky shkojnë gratë e komunitetit (për shembull, në një qendër komunitare, tek burimi i ujit/çezma e fshatit, në treg, në shkolla etj.). Përdorni metodën e shpërndarjes së fjalës “gojë më gojë” për takimin që do të organizohet dhe siguroni që një grup personash nga kontaktet tuaja personale të premtojnë se do të vijnë në takim.

A dëshironi një vizion të sigurisë, i cili u jep përparësi komuniteteve?

A mendoni se siguria e vërtetë kërkon angazhimin dhe pjesëmarrjen e shumë individëve, përfshirë edhe gratë?

Atëherë bashkohuni me ne në një takim të grave të interesuara për forcimin e sigurisë në komunitetet tona përmes dialogut dhe angazhimit.

Juve mund t'ju duket se nuk dini ndonjë gjë të madhe për sigurinë, por kjo nuk është e vërtetë! Të gjithë ne kemi ide dhe mendime të rëndësishme se çfarëdo t'i bënte komunitetet tona më të sigurta. Ne sapo kemi filluar të organizohemi dhe të gjithë janë të mirëpritur.

Informacioni për takimin:

Bashkohuni me gra të tjera të interesuara në
(vendosni vendin e takimit)
më datë (vendosni datën).

Në rast se keni pyetje, kontaktoni me:
vendosni emrin dhe mënyrën e kontaktimit).

Instrumenti nr.9 – Model i rendit të ditës për takimin e parë të një koalicioni

- Mirëseardhja dhe shpjegimi përse është organizuar ky takim;
- Një prezantim i shkurtër i vetes nga çdo pjesëmarrës, duke thënë emrin dhe arsyen përse janë këtu sot;
- Kërkoni mendime mbi përparësitë kryesore të sigurisë në komunitet. Çfarë doni të ndryshoni?
- Rrihni mendime se çfarë mund të bëni për të ndryshuar këto gjëra
- Konfirmoni se kush është i interesuar të bashkëpunojë për arritjen e këtyre ndryshimeve dhe sa shpesh do të donit të takoheshit (diskutoni aspektet e logjistikës se ku do të bëhen takimet)
- Konfirmoni se si mund të kontaktohet me të gjithë personat;
- Bëni plane për takimin tjetër.

Instrumenti nr. 10 – Cilat janë pyetjet që duhen adresuar gjatë planifikimit për veprim

- Cili është rezultati final që dëshirojmë të arrijmë?
- Cilat janë ndryshimet konkrete që duhet të ndodhin për ta arritur atë rezultat?
- Kush do t'i mundësojë ato ndryshime?
- Kush tjetër mund të ndihmojë që këto ndryshime të ndodhin dhe kush mund t'i pengojë që ato ndryshime të ndodhin?
- Cilat janë mesazhet kryesore që duam t'u komunikojmë atyre që kanë mundësi ta sjellin ndryshimin?
- Cilat janë llojet e komunikimit dhe veprimtarive që do të ndihmonin për të kontaktuar me ata që janë në gjendje ta realizojnë ndryshimin (takime, trajnime, peticione)?
- A ka data apo raste të rëndësishme për komunikime të posaçme dhe aktivitete apo momente kur nuk është koha e përshtatshme për t'i trajtuar ato?
- Sa kohë dhe para na duhen për buxhetin e aktiviteteve tona? Cilat janë kapacitetet, materialet dhe ekspertiza që na nevojitet?
- Kush nga koalicioni do t'i drejtojë detyrat? Cilat janë afatet përkundrejt të cilave ata mund të angazhohen? A kemi zgjedhur një numër përparësish që të jenë realiste?
- Si do ta monitorojmë nëse po i bëjmë ato gjëra për të cilat jemi angazhuar apo jo, dhe nëse po bëjmë përparim drejt rezultatit tonë përfundimtar?
- Kur dhe si do ta vlerësojmë ndikimin e aktiviteteve tona.

Hasina Safi nga Afganistani flet për mendimet e grave afgane për negociatat për paqe dhe tranzicionin drejt sigurisë gjatë një interviste dhënë për Zërin e Amerikës në Uashington, DC.

Fotografia: Instituti për Siguri Përfshirëse



Instrumenti nr. 11 - Model për një plan veprimi

Emri i koalicionit tuaj
 Plani për Veprim

Data:
 Për tu shqyrtuar më:

Synimi:

Objektivi	Veprimtaria	Afatet	Personat përgjegjës	Partnerët	Burimet	Monitorimi	Vlerësimi
1.	a.						
	b.						
	c.						
2.	a.						
	b.						
	c.						
3.	a.						
	b.						
	c.						
4.	a.						
	b.						
	c.						

Instrumenti nr. 12 – Modeli i një plani veprimi

Siguria për gratë përmes koalicionit për avokaci (SWACO)

(emrat janë ndryshuar për qëllime të mbrojtjes së privacisë)

Objektivi	Taktika/veprimtaria	Hapat e mëtejshëm	Personi bashkërendues	Afati
Rritja e numrit të grave rekrute në forcat e sigurisë	Fushatë me postera ku të shpalosen imazhe të grave në sektorin e sigurisë	Meri do të koordinojë dizajnon e posterave me kontributin e secilit prej anëtarëve; çdo organizatë do të printojë postera	Meri	Maj
	Radiodramatizim	Synoni grupet e prindërve dhe bashkëmoshatarëve; përdorni histori të vajzave që familja dhe komuniteti nuk i linte të hynin në punë në forcat e sigurisë, por ato u përfshinë pavarësisht prej tyre, përdorni kontaktet e Liberia Broadcasting System (LBS) dhe misionit të Kombeve të Bashkuara në Liberi (UNMIL) për transmetim	Xhejni	Gjashtë muaj, mars-shtator
	Derë më derë dhe forumet e komunitetit	Çdo anëtar i SWACO-s do të shkojë derë më derë për mobilizimin e forumeve të komunitetit në komunitetet përkatëse apo në komunitetet ku punon organizata e tyre; 2 forume komuniteti në Monrovia dhe 2 jashtë; koordinoni me personelin e ambasadës amerikane dhe njësinë indiane të policisë ku janë të gjitha femra	Francina	Gjashtë muaj në Monrovia, midis muajve prill-qershor
Ngritja e kapaciteteve të sektorit të sigurisë për angazhimin me gratë e shoqërisë civile dhe anasjelltas	Informim për forcat e armatosura libiane dhe trajnim për policinë nacionale të Liberisë (LNP)	Takim me kontraktorin privat të sigurisë në Dyncorp; identifikoni dhe takohuni me pikën e kontaktit të UNMIL-it për trajnimin e LNP-së	Amelia	Amelia do ta ftojë personin e kontaktit nga Dyncorp-i në takim dhe radhës së SWACO-s deri me datë 1 prill

Objektivi	Taktika/ veprimtaria	Hapat e mëtejshëm	Personi bashkërendues	Afati
	Seminar për ndërtimin e kapaciteteve për të gjithë anëtarët e SWACO-s për sektorin e sigurisë;	Hartimi i prezantimit të SWACO-s mbi: “pse” dhe “si” duhet të përfshihen gratë në sektorin e sigurisë	Rexhina	Gjysma e parë e prillit
	Takim me inspektorin e përgjithshëm të policisë dhe drejtoreshën e njësive indiane të policisë ku të gjitha efektivat janë femra	Shpjegojuni atyre se si mund të marrin pjesë në fushatën e sensibilizimit duke shkuar derë më derë; avokaci për trajnimin për çështjet gjinore për LNP	Francina	1 prill
Siguroni që politikën dhe planifikimin për çështjet e sigurisë reflekton përparësitë e grave	Takohuni një herë në muaj me UNMIL-n, Departamentin Amerikan të Shtetit, Dyncorp-in, LNP, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Imigrimit	nxisni përfshirjen e politikave me bazë gjinore; shihni cilat janë rregullat e lojës; sigurohuni që zbatohet parimi për punësimin e 20 për qind gra në agjencitë e sigurisë; kërkoni që çështja e imigrimit të përfshihet plotësisht në SSR	Xhejni, Marta dhe Elena	Një herë në muaj duke nisur nga muaji prill
	Jepni mendime mbi politikën kombëtare të sigurisë	Kërkoni takim me një grup grash parlamentare dhe përcaktoni rrugën më të përshtatshme për veprim; asistenti personal i Rep Xander do të sigurojë kopje të politikave dhe SWACO do të mblidhet dhe do t'i shqyrtojë ato (gjithashtu do të koordinojë me grupin parlamentare)	Ndihmësi i Rep. Xander	Një kopje e politikave deri më 7 mars, takimi me grupin e grave deri më 7 prill

Instrumenti nr. 13 – Model rendi ditepër një seminar dyditor për planifikimin e veprimeve për krijimin e një koalicioni

Dita 1

09:00–9:45	Fjala e mirëseardhjes dhe prezantimi i pjesëmarrësve <i>Prezantimi i objektivave të seminarit dhe kalimi i programit.</i>
9:45–10:15	Hyrje në procesin e planifikimit të veprimeve <i>Moderatorja do të paraqesë qëllimet e planifikimit të veprimeve. Elementët që do të përfshihen: synimi, objektivat, aktivitetet, burimet, monitorimi dhe vlerësimi etj.</i>
10:15–11:00	Rënia dakord mbi synimin e koalicionit <i>Moderatorja do të prezantojë seancën, pastaj pjesëmarrësit do të ndahen në grupe të vogla (ku të ketë përzierje të personave nga organizata të ndryshme) për të diskutuar mbi synimin kryesor të koalicionit.</i>
11:00–11:15	<i>Pushim për kafe/çaj</i>
11:00–11:45	Rënia dakord mbi synimin e koalicionit (vijon) <i>Çdo grup i vogël do të shkëmbejë ide me të gjithë grupin në tërësi. Moderatorja do të drejtojë diskutimin për t'i ardhur në ndihmë grupit për të identifikuar një synim të përbashkët.</i>
11:45–13:00	Ushtrim në grup për të përcaktuar objektivat prioritare <i>Moderatorja do të bëjë prezantimin e detyrës dhe të ushtrimit. Grupet e vogla do të diskutojnë mbi objektivat që do të kontribuojnë për arritjen e synimit të rënë dakord, votojnë për më të mirat dhe i diskutojnë ato brenda grupit.</i>
13:00–14:00	<i>Dreka</i>
14:00–16:00	Ushtrim në grup për të përcaktuar objektivat prioritare (vijon) <i>Çdo grup i vogël do të shkëmbejë ide me grupin e madh. I gjithë grupi në tërësi do të votojë për idetë më të mira, do t'i diskutojë ato dhe do të vazhdojë të votojë dhe të diskutojë derisa të bihet dakord mbi objektivat.</i>
16:00–16:20	Konkluzionet për Ditën 1 <i>Përmbledhje e shkurtër e asaj që u arrit, vështrim mbi programin e ditës së dytë, konfirmohet orari për fillimin e punës të nesërmen, etj.</i>

Dita 2

09:00–9:15	Fjala e mirëseardhjes dhe panoramë e përgjithshme e programit të punës për Ditën 2
9:15–11:00	Si do të organizohet koalicioni <i>Diskutim i drejtuar nga moderatorja mbi çështjet e organizimit dhe drejtimit të koalicionit, përfshirë anëtarësimin, strukturën organizative, vendim-marjen, komunikimin, intervalin e shqyrtimit të planit të veprimit etj.</i>
11:00–11:15	<i>Pushim për kafe/çaj</i>

Dita 2 (vijon)

11:15–13:00 **Rënia dakord mbi aktivitetet e koalicionit për 12 muajt e ardhshëm.**
Pjesëmarrësit do të ndahen në grupe të vogla dhe do të propozojnë veprimtari për secilin prej objektivave të rëna dakord nga koalicioni, dhe do të fillojnë të plotësojnë skemën e planit të veprimit me veprimtari, afate dhe përgjegjësi.

13:00–14:00 **Dreka**

14:00–16:00 **Rënia dakord mbi aktivitetet e koalicionit për 12 muajt në vijim (vazhdon)**
Duke rrahur ide si një grup i tërë, koalicioni do të bjerë dakord se tek cilat aktivitete të mundshme do të përqendrohet. për këto aktivitete, grupi do të plotësojë planin e veprimit: afatet, përgjegjësitë, partnerët, burimet, dhe mënyrën sesi do të monitorohen dhe vlerësohen veprimtaritë. Koalicioni do të konfirmojë hapat që do të ndërmerren në të ardhmen e afërt.

16:00–16:20 **Konkluzionet dhe mbyllja**

Instrumenti nr. 14 – Ushtrim në grup për përcaktimin e prioriteteve

- Shtrojini pyetjet qartë. Për shembull “Çfarë duhet të bëjmë për të arritur synimin tonë?” ose “Cilat janë aktivitetet që duhet të organizojmë për realizimin e objektivit X?”
- Nëse grupi ka më shumë se gjashtë vetë, ndahuni në grupe më të vogla nga tre në gjashtë persona.
- Në çdo grup të vogël vendosni një fletë letre të madhe dhe ngarkoni një person të shkruajë gjërat që thonë të tjerët.
- Çdo grup i vogël do të rrahë ide për t’iu përgjigjur pyetjes së bërë (brainstorming). Kjo do të thotë që gjithsecili do të japë idetë e veta – pa bërë diskutime apo kritika të tyre. Inkurajohen idetë pazakonta. Sa më shumë ide, aq më mirë! Të gjitha idetë hidhen në letër (pak rreshta për secilin).
- Secili prej anëtarëve në grup merr nga tri pulla/letra ngjitëse. Pullat ngjitëse vendosen tek letra, në krah të idesë që u duket më e mira.
- Idetë më të pëlqyera diskutohen nga i gjithë grupi.
- Pas diskutimit, grupi “voton” sërish për idetë që parapëlqejnë, duke përdorur pullat ngjitëse.
- Idetë më të pëlqyera i paraqiten të gjithë grupit (nëse ka një të tillë).
- Ky proces votimi dhe diskutimi mund të vazhdojë derisa grupi të ketë një numër të menaxhueshëm idesh për t’i përkthyer në një plan veprimi.

Instrumenti nr. 15 – Fletë pune për hartimin e rekomandimeve

Grafiku i mëposhtëm ofron ide për mënyrat sesi duhet të hartohen rekomandime specifike dhe të zbatueshme. Filloni në krye dhe shkoni deri në fund të grafikut.



Instrumenti nr. 16 – Shembuj rekomandimesh

Rekomandime të dobëta (që nuk janë specifike, nuk janë të qarta)

Rekomandime të mira (specifike, me afate kohore, dhe të zbatueshme)

Punonjësit e sigurisë kanë nevojë për më shumë trajnim për të drejtat e grave

Akademia kombëtare e policisë duhet të hartojë dhe zhvillojë një kurs të detyrueshëm për të drejtat e grave për të gjithë rekrutët e rinj brenda vitit që vjen.

Politikat e sigurisë duhet të përfshijnë aspektet gjinore.

Këshilli kombëtar i sigurisë duhet të kërkojë konsulta me gratë e shoqërisë civile, në çdo krahinë, një herë në vit për të marrë informacion për përpilimin e Strategjisë së re për sigurinë kombëtare.
Konsultimet duhet të përfshijnë të paktën 50 gra, me një kohëzgjatje minimale prej tre orësh

Forcat e armatosura duhet të kenë një numër më të madh grash dhe vajzash si pjesë e personelit të tyre

Qeveria duhet të prezantojë mekanizma për rritjen e pjesëmarrjes së grave në institucionet e sigurisë, ndër të cilat:

- një kuotë prej 30 për qind të rekruteve të reja të jenë gra;
- përkujdesje për fëmijët; dhe
- shërbime të zhvillimit profesional, me qëllim inkurajimin e promovimit të grave në poste të nivelit të lartë.

Shembuj konkretë rekomandimesh nga jeta e përditshme për aktorët e sektorit të sigurisë, të hartuara nga gratë e shoqërisë civile:

- Rrjeti i Grave Afgane: *Siguria e grave dhe tranzicioni në Afganistan: Matja e suksesit të tranzicionit duke garantuar një mbrojtje afat-gjatë për sigurinë e grave*, Kabul, maj 2012, <http://www.inclusivesecurity.org/wp-content/uploads/2012/09/Position-Paper-Impact-of-Transition-on-womens-security-English.pdf>.
- Instituti për Siguri Përfshirëse, *Rekomandimet e Amn-o-Nisa: Koalicioni i grave pakistaneze kundër ekstremizmit*, Uashington, D.C., shtator 2011, <http://www.inclusivesecurity.org/wp-content/uploads/2012/09/recommandations-for-PWCAE-FINAL.pdf>.

Instrumenti nr. 17 – Model për rekomandimet

Ky model mund t'ju vijë në ndihmë gjatë strukturimit dhe paraqitjes së rekomandimeve për SSR-në. Ai përqendrohet tek roli drejtues dhe pjesëmarrja e grave. Përdoreni siç është ose përshtateni për të krijuar një model që i përshtatet më mirë koalicionit tuaj. Gjithmonë mbani parasysh të përfshini aty një emër dhe informacion kontakti (email ose numër telefoni) për të vazhduar dialogun.

Rekomandime për përmirësimin e sigurisë

Rekomandimet e mëposhtme u hartuan nga [VENDOSNI EMRIN E KOALICIONIT TUAJ], një koalicion i grave që dëshirojnë të ndërtojnë një sektor sigurie më efektiv, në [VENDOSNI VENDIN] me datë [VENDOSNI DATËN].

[Vendosnitemën e posaçme të sigurisë]

P.SH REKOMANDIME PËR SHTIMIN E PËRDORIMIT DHE EFEKTIVITETIT TË
PUNËS POLICORE NË KOMUNITET

PËR TË GARANTUAR QË POLICIA TRAJNOHET SIÇ DUHET,
MINISTRIA E BRENDSHME DUHET:

- 1.
- 2.
- 3.

PËR TË SIGURUAR QË TË KETË FINANCIME TË MJAFTUESHME, PARLAMENTI DUHET:

- 1.
- 2.
- 3.

PËR TË NXITUR PJESËMARRJEN E POPULLATËS NË RUAJTJEN E RENDIT NË KOMUNITET,
AKTORËT E SHOQËRISË CIVILE DUHET:

- 1.
- 2.
- 3.

Për më shumë informacion, kontaktoni me: [VENDOSNI EMRIN DHE DETAJET E
KONTAKTIT]

Instrumenti nr. 18 – Model letre drejtuar një zyrtari të lartë të sigurisë për t'i kërkuar takim

[Data]

I nderuar X [Titulli dhe emri i zyrtarit],

Unë jam një banore e [qytetit tuaj] dhe ju jam mirënjohëse për shërbimin e përkushtuar që i ofroni komunitetit tuaj. [vendosni ndonjë informacion tjetër personal që keni për mënyrën nga dhe si e njihni personin, diçka specifike për të cilën e admironi, apo çdo detaj që ju lidh ju me sektorin e sigurisë].

Po ju shkruaj në emër të [organizata juaj e shoqërisë civile] për t'ju kërkuar një takim të shkurtër për të diskutuar mbi disa çështje esenciale të sigurisë me të cilat përballet aktualisht komuniteti ynë. [Organizata e shoqërisë civile] është një koalicion grash drejtuese të përkushtuara për forcimin e sigurisë përmes dialogut midis nëpunësve të sektorit të sigurisë dhe komuniteteve vendore. Gratë mund të japin informacione dhe njohuri thelbësore vendore për rreziqet e sigurisë dhe të ndihmojnë në krijimin e botëkuptimit të familjeve dhe rinisë, që janë me rëndësi të jashtëzakonshme për ruajtjen e rendit dhe ligjit.

Ne jemi mjaft të interesuara të bashkëpunojmë me agjencinë tuaj në mënyrë që t'ju ndihmojmë për garantimin e sigurisë së vërtetë për të gjithë. Anëtarët e koalicionit tonë kanë ide dhe zgjidhje praktike për përmirësimin e reagimit tonë ndaj çështjes së [çështja e rëndësishme e sigurisë], një temë që kam bindjen se përbën shqetësim të madh për ju dhe agjencinë tuaj. [Vini këtu mënyrat konkrete se si mund të ndihmojnë në trajtimin e këtij problemi gratë e komunitetit tuaj].

A do të ketë mundësi të takohemi [data dhe ora]? Do të kontaktoj më vonë me zyrën tuaj për të diskutuar një orar të përshtatshëm për t'u takuar. Presim të takohemi së shpejti.

Me respekt,

Emri juaj

[Organizata juaj e shoqërisë civile]

Instrumenti nr. 19 – Ide për të bashkëpunuar me median

Si pjesë e punës suaj në bashkëpunim me sektorin e sigurisë, mund të kërkonit mundësi në median e shkruar, në radio ose edhe në televizion. Sugjerimet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë gjatë intervistave me reporterë dhe gazetarë.

Sugjerime për intervistat

- Përcaktoni dhe mos vendosni më shumë se tri mesazhe kryesore që doni të përcillni.
- Mbani parasysh se kur do të publikohen komentet tuaja—a është intervista drejtpërsëdrejti? Apo komentet tuaja do të priten dhe do të publikohen më vonë gjatë ditës, gjatë javës apo gjatë muajit?
- la drejtoni mesazhet tuaja audiencës së synuar.
- Referojuni kompanisë/organizatës suaj me emër (p.sh. Ne në [emrin e organizatës] . . . kemi si politikë që . . . etj.).
- Organizojini pikat që doni të përmendni. përdorni skeda për t'ju kujtuar, nëse keni nevojë, ndonëse është më mirë të mos i përdorni.
- Përdorni gjuhën bisedore dhe të drejtpërdrejtë.
- Flisni hapur, pa dredha, dhe me vërtetësi. Një e pavërtetë sado e vogël mund të shndërrohet në një problem madhor.
- Shpjegimet më të ndërlikuara duhet të jepen në përmbledhjet me shkrim të çështjes.
- Jepini vetes një moment reflektimi pa krijuar pauza të pakëndshme përmes përsëritjes apo perifrimit të pyetjes përpara se t'i përgjigjeni. Ose mund të përdorni shprehje si: «*Më vjen mirë që e bëtë këtë pyetje. . . Pyetje me vend. . . Audiencia juaj do të dojë të dijë. . .*» etj.
- Ofroni të verifikoni me burimet e duhura ose kryeni punë kërkimore shtesë, nëse është e nevojshme dhe për këtë njoftoni intervistuesin sa më shpejt të jetë e mundur.
- Tregojini reporterit vetëm ato që doni të shihni në shtyp apo të transmetohen në radio apo televizion. Çdo gjë që shprehet është për botim/transmetim dhe jo për përdorim konfidencial.
- Paraprijuni pyetjeve më të vështira dhe praktikoni përgjigjet.
- Flisni me terma pozitive, aktive.

- Në rast se jeni në një koalicion, sigurohuni që të gjithë anëtarët i kuptojnë mesazhet që po i komunikohen shtypit, por përcaktoni një zëdhënës për ta përçarur mesazhin.
- Gjithmonë sigurohuni 100 për qind për faktet që përmendni.
- Sillni me vete një deklaratë për shtyp ku të përmbledhen pikat tuaja kryesore.
- Mbani parasysh që media shpesh nuk është neutrale dhe mund të ketë një agjendë të sajën politike.

Si tu përgjigjemi pyetjeve të vështira

Krijimi i urave lidhëse

- Përgjigjuni pyetjes me sinqeritet dhe shkurt, pastaj në mënyrë logjike kaloni tek mesazhi juaj. Përpara se të bëni kalimin, duhet t'i jepni përgjigje pyetjes. *Shembull: "Po kështu . . .", "më lejoni të shpjegojem . . ." "Situata është . . ." "Faktet tregojnë . . ."*

Vënia në pah

- Theksojini gazetarit ato gjëra që doni që ai t'i nxjerrë në pah, informacionin që doni të publikohet apo transmetohet, duke vendosur një «yll» në bllokun e tyre. *Shembull: «Aspekti më i rëndësishëm është . . .» «Kjo është gjëja më e rëndësishme . . .» «Çështja është . . .» «Nëse duhet të mbani mend vetëm një gjë nga koalicioni i grave . . .» «është shumë e rëndësishme që (lexuesit/shikuesit/dëgjuesit tuaj) të dinë . . .»*

“Karremi”

- Ju mund ta nxisni pyetjen e radhës që doni t'ju bëhet duke e mbyllur përgjigjen tuaj me një «karrem». *Shembull: «dhe kjo është vetëm një nga mundësitë . . .» «Ne kemi bërë diçka që asnjë organizatë tjetër nuk e ka bërë . . .»*

Instrumenti nr. 20 – Model deklaratë për shtyp

DEKLARATË PËR SHTYP

[Emri i organizatës apo koalicionit tuaj]
[Personi i kontaktit dhe informacioni i tij/saj]

[Organizata ose koalicioni] njofton [nismën, veprimtarinë, hulumtimin, lajmin etj.]
(Ose në rast se nuk është lajmërim, vendosni p.sh:

Gratë e shtetit më të ri të botës kërkojnë bashkëpunim të plotë për përcaktimin e
agjendës së sigurisë për Sudanin e Jugut

Simpoziumi për çështjet gjinore në Juba do të kontribuojë për konferencën
ndërkombëtare të sigurisë në Sudanin Jugor)

PËR NJOFTIM TË MENJËHERSHËM:

[qyteti, shteti/provinca, vendi, data]-(organizata) shpallën sot (nismën, veprimtarinë,
hulumtimin, lajmin, etj.). Kjo hyn në fuqi me datë]. (në rast se ka edhe një organizatë
partnere këtu është vendi për ta përfshirë edhe atë]

Paragrafi I:

(Nisma, veprimtaria, hulumtimi, lajmi, etj.) është (përcaktoni për çfarë bën fjalë nisma,
përse është me rëndësi dhe përse është e vetme në llojin e saj. Në rast se është një
nismë, përshkruani synimin e saj kryesor dhe objektivin.)

Paragrafi II:

[Parashtrim i historikut të iniciativës, aktivitetit, punës kërkimore, lajmit etj.]

[Një citim nga drejtuesja e organizatës suaj/organizatori apo ndonjë person tjetër me
peshë]

Paragrafi III:

[gjuhë e përgjithshme për organizatën tuaj dhe organizatat partnere, nëse është e
mundur].

Instrumenti nr. 21 – Struktura e mesazhit: Pika diskutimi për sigurinë

Pikat e mëposhtme mund të jenë të dobishme një sërë kontekstesh, që nga media deri tek takimet e avokacisë. Ato i përmbledhin idetë e ndërlikuara në deklarata të thjeshta dhe të lehta për tu mbajtur mend. Këta janë thjesht shembuj; ju mund të keni shembujt tuaj që mund të jenë më të mirë për kontekste specifike.

- “Në siguri, gratë nuk flasin vetëm për gratë; ato flasin për të gjithë komunitetin, me një zë të ndryshëm, nga një këndvështrim i ndryshëm”.
- “Siguria nuk ka të bëjë vetëm me tanket dhe ushtarët; siguria ka të bëjë me mundësinë për të shkuar në shkollë, për të marrë ndihmë, për të marrë ushqim, për të bërë biznes në treg”.
- “Mungesa e komunikimit midis pjesës civile dhe institucioneve të sektorit të sigurisë është një mundësi e humbur. Angazhimi i shoqërisë civile rrit sigurinë për komunitetet. Për shembull: angazhimi i komunitetit:
 - përmirëson cilësinë e vendimeve përmes më shumë informacioni;
 - ul kostot dhe vonesat përmes komunikimit me pjesëtarët e komunitetit që kanë dijeninë vendore;
 - ndihmon në ndërtimin e konsensusit;
 - e bën më të lehtë zbatimin e vendimeve të sigurisë;
 - shmang konfrontimet; dhe
 - u paraprin shqetësimeve të publikut për ndryshimet përmes rritjes së ndërgjegjësimit të tyre”
- “Të shpenzosh më shumë buxhet për sigurinë nuk do të thotë automatikisht që ka më shumë siguri. Duhet gjithashtu të ekzistojnë personat dhe procedurat e duhura”.
- “Mbikëqyrja civile e forcave të armatosura dhe atyre të sigurisë në nivel vendor është me shumë rëndësi për të siguruar llogaridhënien e tyre përpara komuniteteve. Ne jemi syri dhe veshët në terren”.
- “Argumenti në favor të mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë nuk do të thotë që jam kundër burrave dhe grave në uniformë. Unë dua që ata të kenë mbështetjen e komuniteteve tona dhe të përfitojnë nga dijet që ne mund tu japim atyre”.
- “Ndërkombëtarët thonë se reforma e sektorit tonë të sigurisë duhet të drejtohet nga vetë vendi, por kush është pjesë e saj? Gratë duhet të jenë pjesë e bisedimeve”.

Instrumenti nr. 22 – Si t’u kundërvihemi skeptikëve

Këtu janë disa nga argumentet që jepen rëndom kundër përfshirjes së grave në çështjet e sigurisë dhe përgjigjet që i hedhin poshtë ato:²³

a. “Fillimisht duhet të trajtojmë çështjet e ngutshme të sigurisë, pastaj mund t’i përfshijmë gratë dhe shoqërinë civile.”

Gratë dhe shoqëria civile janë shumë të rëndësishme pikërisht për trajtimin e këtyre shqetësimeve të ngutshme. Ato mund të ndihmojnë në krijimin e reagimeve më të zgjuara, më efikase, duke kursyer edhe para dhe kohë në periudhën afatgjatë. Anashkalimi i informacionit dhe dijeve të tyre tani, mund të ketë pasoja negative më vonë, sepse nuk do të keni një ide të qartë e të plotë se si është gjendja e vërtetë dhe se cilat janë mënyrat që vërtet mund të funksionojnë për ta ndryshuar atë.

b. “Si punonjës i policisë, unë jam këtu të shpëtoj jetë dhe të mbroj vendin tonë. Çfarë provash ka që përfshirja e grave dhe shoqërisë civile na ndihmon ta bëjmë këtë?”

Gratë nga shoqëria civile mund të ofrojnë informacion shumë të rëndësishëm mbi rreziqet ndaj sigurisë në komunitetet e tyre vendore. Ato kanë treguar se kanë ndihmuar në identifikimin e depove të armëve, rrugëve të paligjshme të tregtimit të tyre dhe aktiviteteve rebele. Ato gjithashtu mund të garantojnë që siguria dhe forcat e armatosura të respektohen. Mbikëqyrja civile e sigurisë dhe forcave të armatosura është me rëndësi kritike për garantimin e llogaridhënies të këtyre forcave ndaj komuniteteve.

c. “Ne jemi duke punuar tashmë me gratë dhe shoqërinë civile.”

Takimet rrallë e tek nuk janë të mjaftueshme. Për një bashkëpunim të vërtetë midis shoqërisë civile dhe institucioneve të sektorit të sigurisë duhet të ndërtohen marrëdhënie afatgjata dhe struktura. Siguria forcohet përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm.

d. “Duket sikur këto grupe grash janë vazhdimisht në luftë me njëri-tjetrin. Gratë duhet të organizohen si një trup i vetëm”.

Gratë kanë krijuar grupe, si koalicioni ynë, për të përkufizuar dhe ndarë së bashku përparësitë tona kryesore. Por ju nuk mund të prisni që gratë gjithmonë

të bien dakord për gjithçka. Këtë nuk do ta prisnit as nga burrat, e as ngaçdo grup tjetër ku ka një numër kaq të madh dhe të larmishëm individësh. Kur gratë kanë mendime të ndryshme, kjo është vetëm PËRFITIM për aktorët e sigurisë, të cilëve mund t’ju hyjnë në punë opinionet dhe këndvështrimet e ndryshme.

e. “Ne nuk kemi as buxhetin, dhe as mandatin për ta bërë një gjë të tillë”

Shumë prej zgjidhjeve që propozojmë ne nuk kushtojnë pothuaj asgjë. Zgjidhje të tjera nuk kërkojnë fonde shtese, thjesht ri-shpërndarjetë fondeve ekzistuese. Një diskutim me gratë e shoqërisë civile, vizita nga punonjësit e policisë në vendet ku mblidhen gratë, apo takimet e rregullta në zyrat qendrore nuk kushtojnë edhe aq. Mendojeni kështu: Mosmarrja e informacionit që ju duhet kushton para, sepse programet nuk po i përdorin fondet e tyre në mënyrën më të mirë të mundur.

f. “Në sektorin e sigurisë nuk ka numër të mjaftueshëm grash me përvojë me të cilat mund të flasim”.

Ndonëse ka gra (edhe burra!) të cilat mund të mos e kuptojnë zhargonin e ushtrisë apo procedurat teknike, shumë gra kanë përjetuar konflikte të dhunshme dhe kanë drejtuar komunitetet e tyre gjatë luftës. Gratë e kuptojnë mirë kuptimin e dhunës dhe ndikimin e saj në jetën e njerëzve të zakonshëm, si edhe kanë ide mbi përparësitë e aktorëve të sigurisë për nxitjen e sigurisë.

g. “Gratë në këtë vend nuk duhet të punojnë në polici, etj.”

Provoni t’ua thoni këtë grave që duan të jenë pjesë e forcave të policisë! Po të bëhet siç duhet, pjesëmarrja e tyre mund të pranohet edhe nga shoqëria. Për shembull, gratë duhet të kenë uniformat e tyre dhe mjedise të veçanta. Shumë vende me zakone të forta sociale për rolet gjinore kanë gra të punësuar në forcat e sigurisë; për shembull disa qytete në Indi kanë një kuotë prej 30 për qind për punësimin e grave si punonjëse të policisë.²⁴

Instrumenti nr. 23 – Model rendi për një trajnim dy ditor për çështjet gjinore dhe reformën e sektorit të sigurisë

Ky është programi për trajnimin mbi çështjet gjinore dhe SSR për përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe komitetet e sigurisë në krahina dhe rrethe (PROS ECS & DIS ECS) në Sierra Leone, janar 2012.

Trajnimi u organizua nga Ministria për Çështjet Sociale, Gjinore dhe ato të Fëmijëve në Sierra Leone (MSWGCA), nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe DCAF-i.

Dita 1

Ora	Seancë
8:30–9:00	Mbërritja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve
9:00–10:00	Seanca e hapjes <i>Fjala e hapjes dhe mirëseardhjes</i> <i>Fjala e rastit nga Sekretari i Krahinës</i>
10:00–10:30	Pamje e përgjithshme dhe objektivat e trajnimit
10:30–11:00	Prezantime dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve
11:00–11:20	<i>Pushim për kafe/çaj</i>
11:20–13:00	Seanca 1: Gjinia dhe SSR <i>Kjo seancë nis me një prezantim të koncepteve gjinore dhe SSR-së dhe pikat e ndryshme hyrëse për integrimin e çështjeve gjinore në sektorin e sigurisë.</i> <i>Kjo pasohet nga diskutimet në grup mbi përfaqësimin e grave të komunitetit dhe pjesëmarrjen në sektorin e sigurisë, si dhe mundësitë dhe pengesat kryesore për përfshirjen e mëtejshme të grave të komunitetit në sektorin e sigurisë.</i>
13:00–14:00	Dreka
14:00–14:30	Seanca 2: Kuadri ligjor dhe normativ <i>Kjo seancë do të rrisë të kuptuarit dhe ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve për instrumentet e ndryshme ligjore dhe të politikave që kanë të bëjnë me aspektet gjinore dhe ato të sigurisë dhe rëndësia që kanë këto instrumente si mjete për avokacinë dhe përfshirjen.</i>
14:30–15:30	Seanca 3: Arkitektura e sigurisë në Sierra Leone <i>Kjo seancë do të përqendrohet tek kuptimi i arkitekturës kombëtare të sigurisë dhe pikat specifike të hyrjes për përfshirjen e grave të komunitetit në proces</i>

Dita 1 (vazhdim)

15:30–15:45 *Pushim për kafe/çaj*

15:45–17:15 Seanca 4: Si të garantojmë praktikisht integrimin e aspektit gjinor në SSR
Kjo seancë do tu paraqesë pjesëmarrësve strategji për integrimin në praktikë të aspektit gjinor në SSR, me ushtrim diskutimesh në grup mbi zbatimin e rekomandimeve kryesore gjinore për SSR-në.

17:15–17:30 **Konkluzionet dhe mbyllja**

Dita 2

Ora	Seancë
8:30–9:00	Mbërritja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve
9:00–9:45	Përmbledhje e ditës së parë
9:45–10:15	<i>Pushim për kafe/çaj</i>
10:15–11:15	Seanca 2: Roli i shoqërisë civile në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë <i>Kjo seancë do të theksojë rolin e shoqërisë civile në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë.</i>
11:15–12:00	Seanca 3: Identifikimi dhe adresimi i nevojave të ndryshme të sigurisë <i>Në këtë seancë do të bëhen diskutime në grup për identifikimin e nevojave të ndryshme të sigurisë dhe interesave të grave dhe burrave në komunitetet përkatëse; reagimi dhe kapacitetet e institucioneve shtetërore për të adresuar siç duhet dhunën me bazë gjinore dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut; dhe mundësi të ndryshme përmes të cilave shoqëria civile mund të ndihmojë në parandalimin dhe reagimin ndaj rreziqeve të dhunës me bazë gjinore.</i>
12:00–13:30	<i>Dreka</i>
13:30–14:00	Identifikimi dhe trajtimi i nevojave të ndryshme të sigurisë (vazhdim)
14:00–15:00	Seanca 4: Integrimi i aspekteve gjinore në PROSECS & DISECS <i>Në këtë seancë do të përfshihet një diskutim në grup për hartimin e planeve të veprimit për përfshirjen e aspekteve gjinore.</i>
15:00–15:30	<i>Pushim për kafe/çaj</i>
15:30–16:00	Vlerësimi dhe vërejtjet përmbyllëse

Shënime

- 1 Organizata Botërore e Shëndetësisë, “Armët e vogla dhe shëndeti global: Kontributi i OBSH-së në konferencën e OKB-së për tregtinë e paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta, 9–20 korrik, 2001” (OBSH: 2001), 3, http://whqlibdoc.who.int/hq/2001/WHO_NMH_VIP_01.1.pdf.
- 2 Claudia Garcia-Morena, *et al.*, OBSH *Studim me disa vende mbi shëndetin e grave dhe dhunën ndaj gruas në familje* (Organizata Botërore e Shëndetësisë: 2005), xi, http://www.who.int/gender/violence/who_multicountry_study/introduction-Chapter1-Chapter2.pdf.
- 3 Kompakti Global i Kombeve të Bashkuara, *Një panoramë e grave në mbarë botën: Fakte dhe shifra* (OK: 5 mars 2009), http://www.unglobalcompact.org/docs/issues_doc/human_rights/Meetings_x_events/05Mar2009_PPT_Snapshot_Facts_and_Figures.pdf.
- 4 Eirin Mobekk, “Gjinia, gratë dhe reforma e sektorit të sigurisë”, *International Peacekeeping*, vëllimi. 17, nr. 2 (2010): 278–291.
- 5 Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq: *Trajtimi i nevojave të grave të prekura nga konflikti i armatosur* (Kryqi i kuq: 2 mars 2004), http://www.icrc.org/eng/assets/files/other/icrc_002_0840_women_guidance.pdf.
- 6 Stephanie Chaban, Reema Daraghmeh, dhe Garance Stettler, *Gratë palestineze dhe siguria: Përse gratë dhe vajzat palestineze nuk ndjehen të sigurta* (DCAF dhe AECID: 2010).
- 7 Këtu termi “forcat paraushtarake” përdoret në kuptimin e forcave të sigurisë shtetërore të ndara nga ushtria dhe policia, të tilla si: shërbimet doganore apo gardianët e burgjeve. Në disa vende, ky term përdoret me kuptimin e forcave “të paligjshme”, si për shembull një grup i armatosur rebel.
- 8 Sanam Naraghi Anderlini dhe Camille Conaway, *Negocimi i tranzicionit drejt demokracisë dhe reforma e sektorit të sigurisë: Kontributi vital i grave të Afrikës së Jugut* (Uashington, D.C.: Nisma për Siguri Përfshirëse (tani e quajtur Instituti për Siguri Përfshirëse), 2004).
- 9 Bandana Rana, në komentet me shkrim të autores, 13 gusht 2012.
- 10 Për më shumë informacion, lexoni tek www.marwopnet.org
- 11 Shihni <http://www.gaps-uk.org/APG.php> për më shumë informacion.
- 12 Ellen Johnson Sirleaf dhe Elizabeth Rehn, *Lufta dhe paqja e grave: vlerësimi i ekspertëve të pavarur* (UNIFEM: 2002), http://www.unifem.org/attachments/products/217_chapter05.pdf.
- 13 Megan Bastick, “Integrimi i çështjeve gjinore në reformën post-konfliktuale të sektorit të sigurisë,” *Vjetari SIPRI 2008: Armatimet, çarmatimi dhe siguria ndërkombëtare* (Oxford: Oxford University Press, 2008), 163.
- 14 Laura Bacon, “Ndërtimi i një shërbimi publik përfshirës në rang kombëtar: Reforma e aspekteve gjinore në Liberi: 2005-2011,” Risi për shoqëri të suksesshme (Universiteti i Princeton-it: 15 prill 2012), http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy_note/PN_id191/Policy_Note_ID191.pdf.
- 15 Qendra kombëtare për gratë dhe policinë, *Rekrutimi dhe mbajtja e grave: Udhëzues vetë-vlerësimi për organet e rendit* (National Center for Women and Policing: 2001), 22, <http://www.ncjrs.gov/pdffiles1/bja/185235.pdf>.
- 16 Aleanca “Altus Global Alliance”, një koalicion organizatash të shoqërisë civile organizon “Javën Globale të Vizitorëve në Komisaritet e

- Policisë”. Në vitin 2011, 4755 persona vizituan 1044 komisariate policie në njëzet vende për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të policisë. Banorët vendas përdorën një protokoll dhe sistem pikëzimi të njëjtë, të quajtur «Paketa e javës së vizitës në komisariatin e policisë» (përfshirë në listën tek Burimet Shtesë) të hartuar nga Altus-i, e cili u përkthye në gjuhët vendore. Për më shumë informacioni, shihni <http://www.altus.org>. Një skemë tjetër që përdoret në Mbretërinë e Bashkuar bën të mundur që pjesëtarët e komunitetit vendor të inspektojnë komisaritet e policisë. Shihni *Aspektet gjinore dhe SSR-ja: shembuj nga terreni, nga DCAF-i* 82, <http://www.dcaf.ch/Publications/gender-and-security-Sector-Reform-examples-from-the-Ground>.
- 17 Shihni MaryEllsberg dhe Lori Heise, *Punakërkimore për dhunën ndaj grave: Udhëzues praktik për hulumtuesit dhe aktivistët* (Uashington, D.C.: Organizata Botërore e Shëndetësisë, PATH, 2005).
 - 18 Eden Cole, Kerstin Eppert dhe Katrin Kinzelbach, *Mbikëqyrja publike e sektorit të sigurisë: Manual për organizatat e shoqërisë civile* (DCAF dhe UNDP: 2008), 68, <http://www.dcaf.ch/publications/kms/details.cfm?lng=en&id=95396&nav1=5>.
 - 19 DCAF-i ka hartuar një listë të shoqatave me personel femëror në sektorin e sigurisë, ku mund të jepen detaje të kontakteve të këtyre shoqatave në vendin tuaj. Ruth Montgomery, *Inventar i shoqatave me personel femëror i rishikuar për ligjërimin “Shoqatat me personel femëror në sektorin e sigurisë: Agjente të ndryshimit?”* (Gjenevë: DCAF, 2011), <http://www.dcaf.ch/Publications/Inventory-of-Female-Staff-Associations-Reviewed-for-the-Occasional-paper-Female-Staff-Associations-in-the-security-Sector-Agents-of-Change>.
 - 20 Të dhënat e kontakteve gjenden në faqet e tyre të internetit: <http://www.unwomen.org/about-us/contact-us/officesworldwide/#liaisonoffices/> dhe <http://www.undp.org/content/undp/en/home/operations/contact-us.html>.
 - 21 Ushtria e Shteteve të Bashkuara “Sierra Leone dhe Gjenerale Kabia: Një zë progresi për gratë ushtarake në Afrikë” www.army.mil, 17 maj 2010. http://www.army.mil/article/39230/Sierra_Leone_and_Brig_Gen_Kabia_A_progressive_voice_for_African_military_gratë/.
 - 22 Komisioni Huairou, *Manuali burimor për dialogun vendor: Udhëzues për angazhimin e grave të bazës me pushtetin vendor dhe vendim-marrësit* (Nju Jork: 2011), 107, <http://www.huairou.org/locallocal-l2l-dialogue-resource-manual>.
 - 23 Kjo listë u frymëzua nga “Deklarata e grupit ekspert të punës së shoqërisë civile në SHBA për planin kombëtar të veprimit për gratë, paqen dhe sigurinë” 28 nëntor, 2011, http://www.usip.org/files/gender/U_S_%20Civil%20Society%20Working%20Group%20Expert%20Statement_MASTER_COPY.pdf.
 - 24 Ajai Areevatsan “Numri i punonjëseve femra të policisë ka gjasa të rritet” *The Hindu*, 15 shkurt 2012, <http://www.thehindu.com/news/cities/chennai/article2893875.ece>.

Shkurtesa

BCSP	<i>Qendra për Politikat e Sigurisë, Beograd</i>
CEDAW	<i>Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave</i>
CSO	<i>Organizatë e Shoqërisë Civile</i>
DCAF	<i>Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura në Gjenevë</i>
DDR	<i>Çarmatim, Çmobilizim dhe Ri-integrim</i>
RDK	<i>Republika Demokratike e Kongos</i>
ECOWAS	<i>Komuniteti Ekonomik i Shteteve të Afrikës Perëndimore</i>
BE	<i>Bashkimi Evropian</i>
EUPOL	<i>Misioni Policor i Bashkimit Evropian</i>
MARWOPNET	<i>Rrjeti i Paqes i Grave të Bashkimit Mano River</i>
NATO	<i>Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior</i>
OIQ	<i>Organizatë Jo-Qeveritare</i>
OSBE	<i>Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë</i>
SSR	<i>Reforma e Sektorit të Sigurisë</i>
SWACO	<i>Siguria për Gratë Përmes Koalicionit të Avokacisë</i>
OKB	<i>Organizata e kombeve të bashkuara</i>
PNUD	<i>Programi për Zhvillim i Kombeve të bashkuara</i>
UNSC	<i>Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara</i>
UNSCR	<i>Rezoluta e Këshillit të Sigurisë së OKB-së</i>
VLW	<i>Zëri i Grave Libiane</i>
WIPNET	<i>Programi i Grave për Ndërtimin e Paqes i Rrjetit të Afrikës Perëndimore për Ndërtimin e Paqes</i>
WIPSEN	<i>Rrjeti i Grave për Paqe dhe Siguri—Afrikë</i>

Burimet shtesë

Të përgjithshme

Bastick, Megan. Udhëzues i vetëvlerësimit gjinor për policinë, forcat e armatosura dhe sektorin e drejtësisë. Gjenevë: DCAF, 2011.

<http://www.dcaf.ch/Publications/gender-Self-Assessment-Guidelines-for-the-Police-Armed-Forces-dhe-Justice-Sector>.

Bastick, Megan dhe Kristin Valasek, red. *Manuali për Aspektet gjinore dhe reformën e sektorit të sigurisë*. Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UNINSTRAW,

2010. <http://www.dcaf.ch/Publications/gender-security-Sector-Reform-Toolkit>.

Cole, Eden, Kerstin Eppert, dhe Katrin Kinzelbach. *Mbikëqyrja publike e sektorit të sigurisë: Manual për organizatat e shoqërisë civile*. DCAF dhe PNUD: 2008. <http://www.dcaf.ch/Publications/Public-supervision-of-the-security-Sector>.

DCAF. *Paketa e burimeve për trajnimin mbi aspektet gjinore dhe SSR*. <http://www.gssrtrajning.ch/>.

International Alert and Women Waging Peace (tani Instituti për Siguri Përfshirëse). *Siguria përfshirëse, Paqe e qëndrueshme: Manual për avokaci dhe veprim*. Uashington D.C.: 2004. <http://www.international-alert.org/publications/pub.php?p=41>.

Instituti për Siguri Përfshirëse. *Siguria përfshirëse: Një kurrikulum për gratë që luftojnë për paqe*. Uashington D.C.: 2009. <http://www.inclusivesecurity.org/explore-burimet/training-services/curriculum/>.

Komisioni Huairou. *Manuali burimor për dialog vendor: Udhëzues për angazhimin e drejtuar nga gratë e bazës për bashkëpunim me pushtetin vendor dhe vendim-marrjen*. Nju Jork: 2011. <http://www.huairou.org/local-local-l2l-dialogueresource-manual>.

O'Leary, Renagh dhe Kalpana Viswanath. *Ndërtimi i qyteteve të qeta dhe të sigurta për gratë: Udhëzues për gratë*. Nju Delhi: Jagori, 2011. <http://jagori.org/building-safe-and-inclusive-cities-for-women-a-practical-Guidelines/>.

Toiko Tonisson, Kleppe. "Trajnimi mbi aspektet gjinore për personelin e sektorit të sigurisë: Mësimet e mësuara dhe praktikat e shëndosha" Manuali për *aspektet gjinore dhe reformën në sektorin e sigurisë*. Redaktuar nga Megan Bastick dhe Kristin Valasek. Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UNINSTRAW, 2008.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-HABITAT). *Vlerësim global për sigurinë e grave*. Nairobi: UN-HABITAT, 2008. http://www.unhabitat.org/downloads/docs/7380_832_AssesmentFinal.pdf.

Qendra virtuale e dijeve e OKB-së për dhënien fund dhunës ndaj grave dhe vajzave. <http://www.endvawnow.org/en/modules/view/13-security.html>.

Willoughby, William, Radhika Behuria, dhe Nicola Williams, red. *Këndvështrimi i grave mbi paqen dhe sigurinë*. N-Peace, 2012.

http://www.n-peace.net/sites/default/files/sites/default/files/uploads/user71/WPS_casestudies.pdf

Teknikat kërkimore

Paketa “Java e vizitorëve në komisariatet e policisë”, hartuar nga Altus. www.altus.org/pdf/kit_en.pdf.

Amnesty International dhe Këshilli për Zhvillimin e Kërkimeve Socio-shkencore në Afrikë. *Monitorimi dhe raportimi i shkeljeve të drejtave të njeriut në Afrikë: Manual për aktivistët e komunitetit. Britani e Madhe*: Amnesty International, 2002. http://www.hrea.org/erc/Library/display_doc.php?url=http%3A%2F%2Fwww.hrea.org%2Ferc%2FLibrary%2Fkomunitethan_dbook-en.pdf&external=N.

Bennett, Gavin dhe Nasreen Jessani. *Manual pune për vënien në jetë të njohurive: Hendeku Di-Bëj: Material burimor për studiuesit*. Sage, Indi: IDRC, 2011. <http://publicwebsite.idrc.ca/EN/burimet/Publications/Pages/IDRCBookDetails.aspx?PublicationID=851>.

Cole, Eden, Kerstin Eppert, dhe Katrin Kinzelbach. *Mbikëqyrja publike e sektorit të sigurisë: Manual për organizatat e shoqërisë civile*. DCAF dhe PNUD: 2008, 53–73. <http://www.dcaf.ch/Publications/Public-supervision-of-the-security-Sector>.

Ellsberg, M. dhe L. Heise. *Puna kërkimore për dhunën kundër grave: Udhëzues praktik për hulumtuesit dhe aktivistë*. Uashington, D.C.: Organizata Botërore e Shëndetësisë, PATH, 2005.

Kumar, Krishna. *Organizimi i mini-anketave në vendet në zhvillim*. USAID, 2006. http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADG566.pdf.

OMNI. *Manual për organizimin e grupeve të fokusit*. n.d. <http://www.omni.org/docs/FocusGroupToolkit.pdf>.

Singh, Janmejay dhe Paramesh Shah. *Community Score Card Process: Shënime mbi metodikën e përgjithshme dhe zbatimin*. Banka Botërore, pa datë, <http://sitesources.worldbank.org/INTPCEN/G/1143333-1116505690049/20509286/comscorecardsnote.pdf>.

Start, Daniel dhe Ingie Hovland. *Instrumente për ndikimet e politikave: Manual për hulumtuesit*. Londër: Overseas Development Institute, 2004. <http://www.odi.org.uk/resources/details.asp?id=156&title=tools-policy-impact-handbookresearchers>.

Tandon Mehrotra, Surabhi. *Manual auditimi për sigurinë e grave me të ardhura të ulëta në zonat urbane: fokusi tek shërbimet esenciale*. Nju Deli: Jagori, 2010. <http://jagori.org/a-handbook-on-womens-safety-audits-in-low-incomeurban-neighbourhoods-a-focus-on-essential-services/>.

Universiteti i Kansasit. *Manual pune për komunitetin*. <http://ctb.ku.edu/en/tablecontents/index.aspx>.

USAID Qendra për zhvillimin dhe vlerësimin e informacionit. *Ide për monitorimin dhe vlerësimin e performancës: organizimi i intervistave me persona kyç; përdorimi i metodave të vlerësimit të shpejtë; organizimi i intervistave me grupet e fokusit*. Uashington, D.C.: USAID, 1996.

Banka Botërore. “Anketimet me anë të skedave të vlerësimit të qytetarëve – Një shënim për konceptin dhe metodologjinë.” *Social Development Note*, nr. 91 (shkurt 2004). <http://siteburimet.worldbank.org/INTPCEN/G/1143380-1116506267488/20511066/reportcardnote.pdf>.

reportcardnote.pdf.

Siguria për organizatat e grave dhe aktivistët

Barry, Jane. *Siguria e integruar: Manuali*. Kvinna till Kvinna, 2011. <http://www.integratedsiguriamanual.org>.

Eguren, Enrique. *Front Line*, 2005. http://www.peacebrigades.org.uk/fileadmin/user_files/groups/uk/files/Publications/Frontline_Manual_pdf.pdf.

Macpherson, Robert dhe Bennett Pafford. *Manual i sigurisë dhe i të qenit i sigurtë*. Care International, 2004. http://ngolearning.org/courses/availablecourses/CARE%20Safety%20Course/Shared%20Documents/English_CARE_International_Safety_dhe_security_Handbook.pdf.

org/courses/availablecourses/CARE%20Safety%20Course/Shared%20Documents/English_CARE_International_Safety_dhe_security_Handbook.pdf.

Organizata që botojnë hulumtime mbi sektorin e sigurisë, reformën, dhe qeverisjen e sektorit të sigurisë

ACCORD, www.accord.org.za

Rrjeti Afrikan i Sektorit të Sigurisë, www.africansecuritynetwork.org

Amnesty International, www.amnesty.org

Nisma e Reformës Arabe, www.arab-reform.net

Carnegie Endowment for International Peace, www.carnegieendowment.org

Conciliation burimet, www.c-r.org

DCAF, www.dcaf.ch

Facultad Latinoamericana de Ciencias Sociales (FLACSO-Chile), www.flacso.org

The Global Facilitation Network for Security Reform, www.ssrnetwork.net

Human Rights Watch, www.hrw.org

Instituti për Siguri Përfshirëse, www.inclusivesecurity.org

Instituti për studime të sigurisë, www.iss.co.za

Institute për raportimin mbi luftën dhe paqen, iwpr.net/report-news

International Alert, www.international-alert.org/ourwork/themes/security

International Crisis Group, www.crisisgroup.org

Kvinna Till Kvinna, www.kvinnatillkvinna.se/en/siguria

The North-South Institute, www.nsi-ins.ca

Peacewomen Project (Lidhja ndërkombëtare e grave për paqe dhe liri), www.peacewomen.org

PRIO, www.prio.no/

Saferworld, www.saferworld.org.uk

Qendra e burimeve për reformën e sektorit të sigurisë www.ssrresourcecentre.org

SIPRI, www.sipri.org

Small arms survey, www.smallarmssurvey.org

Departamenti i OKB-së për operacionet paqeruajtëse, www.un.org/en/peacekeeping/issues/securitya.shtml

PNUD, www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage.html

UN Women, www.unifem.org/gender_issues/women_war_peace/siguria_sector_reform.php

Instituti për paqen në SHBA, www.usip.org/programs/centers/security-sector-governance-initiative

Shembuj organizatash ndërkombëtare të përfshira në reformën e sektorit të sigurisë

Bashkimi Afrikan

Bashkimi Evropian (BE)

Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Kombet e Bashkuara (OKB), shpesh Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD), Departamenti amerikan për operacionet paqeruajtëse (DPKO), zyra e OKB-së për Drogat dhe Krimin ose UN Women

Banka Botërore

Shembuj të qeverive që ofrojnë mbështetje ndërkombëtare për reformën e sektorit të sigurisë

Agjencia australiane për zhvillim ndërkombëtar (AusAID);

Njësia belge e punëve të jashtme, tregtisë së jashtme dhe bashkëpunimit për zhvillim;

Departamenti kanadez i punëve të jashtme dhe tregtisë ndërkombëtare dhe Agjencia Ndërkombëtare e zhvillimit (DFAIT, CIDA);

Zyra gjermane për bashkëpunimin për zhvillim (GIZ)

Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës

Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë dhe Agjencia norvegjeze për bashkëpunimin për zhvillim (NORAD)

Agjencia ndërkombëtare suedeze për zhvillim ndërkombëtar (SIDA)

Departamenti për zhvillim ndërkombëtar i Britanisë së Madhe (DFID)

Agjencia e SHBA për zhvillim ndërkombëtar (USAID)

